

DITURIA ISLA ME

REVISTË MUJORE-ESTIVARE SHKENCËRE E KULTURORE • Nr. 420 • NËNTOR 2025



MUSLIMANI AKTIV
NË SHOQËRI

ATDHEU, NDËRMJET NDJENJËS
DHE PËRGJEGJËSISË

PAVARËSIA, GURI KILOMETRIK
NË HISTORINË E SHQIPTARËVE

Siria njih pavarësinë e Kosovës: një kapitull i ri në diplomacinë ndërkombëtare të vendit



Më 29 tetor 2025, gjatë një takimi historik në Riad ndërmjet presidentes së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, princit të kurorës së Arabisë Saudite, Muhammed bin Salman Al Saud, presidentit të Sirisë, Ahmed al-Sharaa, dhe Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, u njoftua se Siria ka njohur zyrtarisht pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Ky vendim u bë me ndërmjetësimin dhe mbështetjen e princit saudit, duke shënuar një hap të rëndësishëm në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës.

Presidenti sirian Ahmed al-Sharaa, i cili mori drejtimin e vendit pas rrëzimit të Bashar al-Assadit në dhjetor 2024, shprehu gatishmërinë për të ndërtuar marrëdhënie diplomatike dhe bashkëpunim ekonomik, arsimor dhe kulturor me Kosovën. Ndërkohë, Siria, pas ndryshimeve politike të fundit, po synon të rindërtojë marrëdhëniet me botën perëndimore dhe vendet mike të rajonit.

Presidentja Osmani vlerësoi rolin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në këtë proces, duke theksuar se njohja e Sirisë përbën një fitore të rëndësishme për diplomacinë kosovare dhe një dëshmi të mbështetjes së fuqishme që Kosova gëzon në Lindjen e Mesme.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, përshëndeti këtë zhvillim, duke falënderuar përpjekjet e presidentes Osmani dhe mbështetjen e Arabisë Saudite. Me këtë njohje, Siria bëhet shteti i tretë që njih pavarësinë e Kosovës gjatë vitit 2025, pas Kenias dhe Sudanit.

Deri më sot, pavarësia e Kosovës është njohur nga 120 shtete të botës, duke forcuar më tej pozicionin e saj në arenën ndërkombëtare.

EDITORIAL

- 4 Atdhedashuria – përtej sajësive ideologjike

REPORTAZH

- 5 Myftiu Tërnava pjesë e delegacionit presidencial të Kosovës në Arabinë Saudite

FETARE

- 7 Dashuria ndaj atdheut – përkushtim i vazhdueshëm
Mr. Vedat Shabani
- 10 Atdheu ndërmjet ndjenjës dhe përgjegjësisë
Myrvete Allmeta
- 13 Myslimani aktiv në shoqëri
Fitim Flugaj
- 17 Tabiinët – hallka e dytë e ndërtimit të shkollës juridike hanefite
Dr. Muhamed Stublla
- 22 Leximi i Kuranit gjatë namazit duke shikuar në Mus'haf dhe dua gjatë sexhdes
Myfti Ebrahim Desai

FAMILJE & EDUKIM

- 23 Edukimi familjar si garancë për formimin e brezave të ardhshëm
Florentina Tërmkollli

KULTURË

- 25 Zhvillimet kulturore në Kosovë para viteve '90 dhe kontrolli i regjimit të Tiranës
Xhafer Sadiku



- 29 Alfabeti "Bashkimi" dhe Kongresi i Manastirit
Dr. Azmir Jusufi
- 31 Drama shqiptare "Besa" e Shemsedin Sami bej Frashërit
George W. Gawrych
- 35 Kultura islame në Perëndim – mundësitë dhe sfidat
- 38 Trajtime gjuhësore në "Reflektime Kuranore"
Granit Sadiku
- 43 Vepër studimore për Asim ef. Luzhën
Nuridin Ahmeti

HISTORI DHE CIVILIZIM


- 46 Pavarësia – guri kilometrik në historinë e shqiptarëve
Nuredin Nazarko
- 48 Krimet dhe masakrat serbe pas shuarjes së kryengritjes së shtatorit 1913
Qerim Lita
- 52 Manipulimet ideologjike rreth rrënjëve të shqiptarëve – reflektim i shkurtër
Dr. Agron M. Rexhepi

REPORTAZH

- 54 U mbajt Konferenca "The Role of Muslim Scholars and Intellectuals in Europe – Roli i studiuesve dhe intelektualëve myslimanë në Evropë"

AKTIVITETE

- 56 Myftiu Tërnava u prit në takim nga presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani – Sadriu



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 420 • viti 39 • Nëntor 2025
• Xhumadel Ula 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnava,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



“...Kështu, Allahu sqaron shembullin e të së vërtetës dhe të pavërtetës. Për sa i përket shkumës, ajo hidhet si e pavlerë, ndërsa ajo që u sjell dobi njerëzve, ajo mbetet në tokë. Kësisoj Allahu i sjell shembujt...”

(Err Rrad, 17)

Atdhedashuria – përtej sajësive ideologjike

Në pellgun historiografik shqiptar, shquhen përpjekje kolosale të atdhedashësve të mëdhenj: intelektualë të ndritur, prijës fetarë islamë dhe jo vetëm, pastaj edhe rilindës dhe mendimtarë, të gjithë të bashkuar në një mision të shenjtë – të ngulisin dashurinë për atdheun thellë në zemrat e popullit tonë. Prijësit fetarë, me ndërgjegje të pastër dhe vizion të lartë, e injektuan këtë ndjenjë të shenjtë pa lënë asnjë vend për urrejtjen ndaj tjetrit, dhe duke e shndërruar dashurinë për vendin në një flakë që ndriçon shpirtin, ndërton karakterin dhe forcon identitetin kombëtar. Gjatë predikimit fetar, këta prijës s’patën kurrë kompleksin që të proklamoni binomin fe-atdhe si shtyllë të diskursit islam në trojet tona dhe njëherësh si një platformë të veprimtarisë së tyre nëpër mejtepe, xhami, medrese, e kudo gjetiu. Hafëz Ali Korqa, krejt troç e thoshte: “Feja dhe atdheu janë dy amanete që njeriu i ndershëm s’mundet t’i ndajë: pa njërën humbet morali, pa tjetrin humbet nderi.” (A. Korça, “Feja dhe Atdheu,” Zani i Naltë, nr. 6, Tiranë, 1937). Ata pra, u treguan të zellshëm në këtë detyrë, sepse e morën si amanet hyjnor, andaj s’pritej që do ta nëpërkëmbnin atë ndonjëherë.

Mirëpo, kjo atdhedashuri e çiltër, nuk u injektua njëjtë as në format e as në qëllim, nga ata që hapësirën shqiptare tentuan ta mbulojnë me hijen ideologjike marksiste-leniniste, e me gjasë as nga këta që sot, atdhedashurinë e përvijojnë si projekt të kulluar antagonist me Islamin.

Po të lexohej me pak kujdes ideologjia enveriste, vihet re qartazi që shqiptarit i kërkohej të shndërrohej në një qenie të re, të ribërë e të riformatuar nga fillimi, një sajësë krejt ndryshe nga çfarë ai pati qenë deri atëherë. Duket paradoksale, veçse edhe sot, ngjashëm, kemi tentativa që dashuria ndaj atdheut të disenjohej në një format të ri, që pikënisje të vetë ka arratisjen nga feja. “Ftesën e përzemërt” për braktisjen e Islamit e bëjnë me pretekstin se pranimi i tij nga ne, ishte çasti më i skëterrshëm në historinë tonë, andaj ecjen tonë përpara patjetër duhet korrigjuar. Për këtë qëllim lëshohen komunikata e lexohen “manifeste”, dhe në sinkron të çuditshëm godasin pamëshirshëm gjithnjë dhe vetëm këtë pikë.

Kërkesa është që t’ia japim lamtumirën kësaj feje, profeti i së cilës, për mërinë e tyre, na thoshte: “Kush vdes duke mbrojtur pasurinë, nderin ose shtëpinë e tij, është dëshmor.” (Tirmidhiu, 1421; Ebu Davudi, 4772). E, t’ua kërkosh njerëzve që ata të braktisin fenë që ua bënë detyrë sakrificën për atdhe, dhe atë që vdes në këtë rrugë e gradon me gradën e dëshmorit, është njësoj sikur në emër të moralit, t’ia kërkosh fëmijës në shkollë mosdëgjimin ndaj prindit në shtëpi, i cili përherë ua kalitë atyre virtytet morale në shpirt, dhe pa asnjë interes. E po, më së miri e tha A. Lincoln: “Mund t’i mashtrosh disa njerëz përherë dhe shumë njerëz ndonjëherë, por kurrë nuk mund t’i mashtrosh të gjithë njerëzit, e përherë.” Propaganda ka efekt shurdhues, e ndonjëherë edhe merr rolin dominant në ndonjë vend, veçse ajo nuk i mbijeton dot ndërgjegjes së zgjuar njerëzore dhe të vërtetave të patundshme të historisë. Duke qenë e brishtë, lehtësisht edhe shembet. Saktësisht siç tha Allahu: “...Kështu, Allahu sqaron shembullin e të së vërtetës dhe të pavërtetës. Për sa i përket shkumës, ajo hidhet si e pavlerë, ndërsa ajo që u sjell dobi njerëzve, ajo mbetet në tokë. Kësisoj Allahu i sjell shembujt...” (Err Rrad, 17).

Nuk është çudi, dikujt edhe mund t’i duhet tjetërsimi e tëhuajësimi ynë, që pastaj shpirti i njeriut ‘të ri’ të jetë i gatshëm të përthithë “frymën e re” të injektuar në gjenin e kulluar shqiptar, dhe atë nën tutelën e tyre ideologjike. Na duan të ndryshëm nga koka e gjer te këmbët, që të bëhemi vetëm një pasqyrë e deformuar e ambicies së tjetrit, një krijesë e konstruksioneve të tyre, që mohon natyrën dhe identitetin tonë të vërtetë.

Shqiptarët, në rrugëtimin e gjatë me Islamin, mbi gjashtë shekullor, patën kohën e mjaftueshme që të shoshitin idetë dhe manifestet e tilla që klithnin prorre, dhe ua dhanë gjithnjë përgjigjen e duhur tellallëve të tillë. Një përgjigje të tillë e artikuloi mendjendrituri me gjen të kulluar atdhedashës, Mit’hat Frashëri kur tha: “Dashuria për atdheun nuk është me fjalë, me britma e me betime, por me punë, me mundim, me sakrificë e me ndershmëri.” (Mid’hat Frashëri, “Plagët tona”, f. 47, Toena, Tiranë 1999). Ato tiparet e para që u demaskuan nga lapsi frashërian, po ua lejmë atyre që edhe u kanë hije, ndërsa shqiptarëve që ruajnë bashkë fenë e atdheun, u mbesin t’i ruajnë ato që i kanë ruajtur gjithnjë, pra ato të fundit.

Mr. Driton Arifi

Reportazh nga vizita e Myftiut Naim ef. Tërnava në Arabinë Saudite

Myftiu Tërnava pjesë e delegacionit presidencial të Kosovës në Arabinë Saudite

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, nga data 27 deri më 31 tetor, qëndroi për vizitë në Riad të Arabisë Saudite. Gjatë kësaj vizite, së bashku me presidenten e vendit, znj. Vjosa Osmani, realizuan një sërë takimesh me rëndësi.

PRITJA NGA PRINCI I KURORËS SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, MUHAMED BIN SELMAN

Më 27 tetor 2025, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e shoqëruar edhe nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, u pritën në takim nga Princi i Kurorës së Mbretërisë së Arabisë Saudite, Muhamed bin Selman.

Gjatë takimit, Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e thellë për miqësinë dhe mbështetjen e palëkundur që Mbretëria e Arabisë Saudite i ka dhënë popullit dhe shtetit të Kosovës ndër vite.

Duke theksuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ekonomik dhe hapjes së kapitujve të rinj në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, presidentja Osmani kërkoi lehtësimin

e lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës përmes mundësisë së aplikimit për viza elektronike, një nismë që u mirëprit nga Princi i Kurorës.

Në takim u theksua përkushtimi i përbashkët i të dy shteteve për paqe, stabilitet dhe bashkëpunim rajonal e global, si dhe gatishmëria për t'i thelluar më tej marrëdhëniet dypalëshe nëpërmjet marrëveshjeve të reja dhe zgjerimit të horizonteve të bashkëpunimit në fusha me interes të ndërsjellë.

Presidentja Osmani shprehu gatishmërinë për të zgjeruar bashkëpunimin me Arabinë Saudite në fushat e energjisë së rinovueshme, turizmit, bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, arsimit, inovacionit digjital dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke hapur kapituj të rinj në marrëdhëniet në mes dy vendeve.



TAKIMI ME PRINCIN E KURORËS SË MBRETËRISË HASHMITE TË JORDANISË, HUSEIN BIN ABDULLAH AL HASHIMI

Gjatë qëndrimit në Riad të Arabisë Saudite, më 28 tetor 2025, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e shoqëruar edhe nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, janë pritur në takim nga Princi i Kurorës së Mbretërisë Hashemite të Jordanisë, Husein bin Abdullah al Hashimi.

Gjatë takimit, u konfirmua gatishmëria për thellimin e partneritetit, si dhe u diskutua për mënyrat për të hapur kapituj të rinj bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët, përfshirë mbrojtjen, tregtinë dhe teknologjinë e informacionit (ICT).



TAKIMI ME PRESIDENTIN E MAURITANISË, MUHAMED OULD CHEIKH EL GHAZOUANI

Delegacioni nga Kosova, më 28 tetor 2025, zhvilloi një takim me presidentin e Mauritaniës, Mohamed Ould Cheikh El Ghazouani.

Gjatë atij takimi u bisedua për forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet Kosovës dhe Mauritaniës, gatishmërinë për të punuar së bashku në nivel ndërkombëtar, si dhe për angazhimin tonë të ndërsjellë në thellimin e bashkëpunimit bilateral.



TAKIMI ME PRESIDENTIN E SIRISË, AHMED AL SHARAA

Po ashtu, gjatë qëndrimit në Riad të Arabisë Saudite, më 29 tetor 2025, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e shoqëruar edhe nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, zhvilluan një takim të rëndësishëm trilateral me Princin e Kurorës së Mbretërisë së Arabisë Saudite, Muhamed bin Selman dhe presidentin e Sirisë, Ahmed al Sharaa. Gjatë këtij takimi presidenti i Sirisë, Ahmed al Sharaa, deklaroi se shteti i Sirisë, e njeh pavarësinë e shtetit të Kosovës, duke shprehur kështu gatishmërinë e tij dhe të shtetit që ai drejton për një bashkëpunim ndërmjet dy vendeve.

Njohja e shtetit të Kosovës nga shteti i Sirisë ka një rëndësi të veçantë për Kosovën në këto momente.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, shoqërohej nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.

(Përgatiti: Bajram Zeqiri)



Dashuria ndaj atdheut – përkushtim i vazhdueshëm

Mr. Vedat Shabani

Të flasësh për atdheun dhe ta duash atë nuk do të thotë të flasësh për racizëm, fanatizëm apo nacionalizëm. Jo, por, do të thotë të flasësh për jetën, ndërtimin, rilindjen dhe thellimin e vlerave dhe parimeve edukative e arsimore.

Atdheu është vendi ku kemi lindur dhe jetojmë ne, dhe ku kanë jetuar të parët tanë, vendi ku banon prej kohësh një popull a një komb, vendi ku lind e zhvillohet diçka për herë të parë. Pra, njeriu si krijesë e Allahut xh.sh., u krijua nga dheu mbi të cilin ai do të jetojë dhe ai është vendqëndrimi i tij në këtë botë.¹

DASHURIA NDAJ ATDHEUT NGA KËNDVËSHTRIMI FETAR

Dashuria për atdheun dhe përkatësia ndaj një kombi dhe vendi është instiktive, një natyrë që Zoti xh.sh. e ka ngulitur në shpirtrat e njerëzve. Kur një person lind dhe rritet në një tokë, pi ujin e saj, thith ajrin e saj dhe jeton midis njerëzve të saj, natyra e tij e lidh atë me të, kështu që ai e do atë dhe është besnik ndaj saj. Për t'i lënduar ndjenjat e një personi, mjafton që t'i thuash atij se ti nuk ke atdhe.

Në Kurani famëlartë, dashuria ndaj tokës-atdheut, është e shoqëruar me dashurinë ndaj vetvetes. Kurani ka shkuar deri në atë masë sa që dëbimin nga atdheu e ka vënë në një nivel me vrasjen. Zoti i Plotfuqishëm thotë: “Sikur Ne t'i urdhëronim ata: “Vritni veten!” ose: “Lini shtëpitë tuaja!”, pak prej tyre do ta bënë këtë...” (En Nisa, 66).

Ndërsa, në një vend tjetër në Kuran, dashuria ndaj tokës-atdheut, lidhet me vetë fenë. Zoti i Plotfuqishëm thotë: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (El Mumtehine, 8).

Po të mos ishte vlara e madhe që ka atdheu për njerëzit në përgjithësi, atëherë të dërguarit nuk do të kërcënoheshin me dëbim prej tij. Lidhur me këtë Zoti i Plotfuqishëm thotë: “Mohuesit u thanë të dërguarve të tyre: “Ne do t’ju dëbojmë nga vendi ynë ose do të ktheheni në fenë tonë!” Atëherë, Zoti u shpalli (të dërguarve të Vet): “Ne do t’i zhdukim keqbërësit.” (Ibrahim, 13).



Dashuria për atdheun dhe përkatësia ndaj një kombi dhe vendi është instiktive, një natyrë që Zoti xh.sh. e ka ngulitur në shpirtrat e njerëzve. Kur një person lind dhe rritet në një tokë, pi ujin e saj, thith ajrin e saj dhe jeton midis njerëzve të saj, natyra e tij e lidh atë me të, kështu që ai e do atë dhe është besnik ndaj saj.



Jonuz Zejnullahu, dëshmor i kombit (ish-medresant)

Transmetohet nga Enesi r.a., i cili ka thënë: Sa herë që i Dërguari i Allahut kthehej nga një udhëtim dhe shihte rrugët e Medinës, ai e shpejtonte devenë e tij, e nëse ishte mbi ndonjë kafshë, e lëvizte atë më shpejtë. Në një transmetim tjetër thuhet: Sa herë që kthehej nga një udhëtim dhe shihte muret e Medinës, ai e shpejtonte kalin e tij, dhe nëse ishte mbi një kafshë, e lëvizte atë nga dashuria për të.² Ibën Haxheri, në komentimin e këtij hadithi, ka thënë: “Ky hadith tregon vlerën e Medinës dhe lejueshmërinë e dashurisë për atdheun dhe mallëngjimin për të.”³

Pejgamberi a.s. e donte shumë atdheun e tij, Mekën, por ai u sprovua rëndë duke u dëbuar prej saj. Abdullah ibën Adij el Zuhriu, tregon se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s., të thoshte, ndërsa qëndronte në tregun e Mekës në El Hazvah: “Për Allahun, ti je toka më e mirë e Allahut dhe toka më e dashur për Allahun. Sikur të mos isha dëbuar prej teje, nuk do të kisha ikur.”⁴

Imam Dhehebiu, kur numëronte gjërat të cilat Pejgamberi a.s. i donte, përmende këto: “Ai e donte Aishen r.a., e donte babanë e saj, e donte Usamen, i donte dy nipërit e tij, i donte ëmbëlsirat dhe mjaltin, e donte malin Uhud dhe e donte atdheun e tij.”⁵

Kështu e mbajti në zemrën e tij të pastër, shëmbëlltyra jonë, Muhamedi a.s., dashurinë e sinqertë për atdheun e tij.

Imam Dhehebiu, kur numëronte gjërat të cilat Pejgamberi a.s. i donte, përmende këto: “Ai e donte Aishen r.a., e donte babanë e saj, e donte Usamen, i donte dy nipërit e tij, i donte ëmbëlsirat dhe mjaltin, e donte malin Uhud dhe e donte atdheun e tij.”

Bazuar në ajetet dhe hadithet e lartpërmendura, mund të konkludojmë se feja islame e ka bërë obligim dashurinë ndaj atdheut, e ka bërë obligim ruajtjen dhe sigurimin e vatanit, ashtu që e ka ligjësuar luftën për ta mbrojtur atdheun atëherë kur të sulmohet nga dikush, dhe nëse në atë rast bie dëshmor, ai e ka gradën e lartë të Zotit i Madhërishëm dhe shpërblehet me Xhenet.

NDIKIMI FETAR TE POPULLI SHQIPTAR NË PËRKUSHTIMIN NDAJ ATDHEUT

Duke u nisur nga ajetet kuranore dhe hadithet të Pejgamberit a.s., edhe populli ynë që herët kanë qenë të ndërgjegjësuar për atdheun, e kanë pasur të qartë përkatësinë e tyre etnike, e kanë shfaqur atë me dashuri dhe krenari si dimensionin kryesor të shpirtit të tyre, e kanë ndierë me dhembje, i janë përkushtuar me dëshirë, kanë jetuar dhe kanë luftuar me idealin e atdheut në gji. Shumë gjenerata janë flijuar për këtë atdhe, për të arritur aty ku sot ne kemi arritur, që ta gëzojmë lirinë e vendit tonë.

Dashuria ndaj atdheut nuk është vetëm fjalë goje, apo vargje të shënuara në libra, porse ajo duhet të zërthehet në praktikë. Dashuria ndaj atdheut, përpos që kërkon që ta duam shumë, kërkon edhe sakrificë për të, kontribut të vazhdueshëm për t'i sjellë atij çdo të mirë dhe të largojmë çdo të keqe prej tij.

Dashuria ndaj atdheut nënkupton që interesi i shtetit, pra i atdheut dhe i shoqërisë të jetë parësor dhe mbi interesat personale.

Dashuria ndaj atdheut është e lindur te njeriu. Ajo është dhunti e Zotit që është e qëndisur në shpirtin dhe zemrën e tij. Kah do që të shkosh përsëri malli për atdheun nuk shuhet asnjëherë.

Çdo njeri duhet ta dojë vendin e vet dhe e ka për detyrë t'i dal zot atij në rast rreziku. Pra, besimtari i mirë është edhe atdhetar i mirë. Së këndejmi, nuk është rastësi që pikërisht nga radhët e ulemasë-dijetarëve shqiptarë myslimanë, kanë dalë atdhetarë të njohur dhe të përkushtuar ndaj atdheut, siç ishin: Haxhi Ymer Prizreni, Haxhi Zeka, Hoxhë Voka, Imam Vehbi Dibra, Hoxhë Kadri Prishtina, Mulla Idriz Gjilani, e sa e sa të tjerë, që nuk kursyen asgjë për liri. Nuk është rastësi që shumë organizata dhe institucione fetare kanë qenë vatra të organizimit të shqiptarëve në luftën për çlirimin kombëtar. Këtë rrugë dhe praktikë e ndoqën edhe ulemaja jonë e mëvonshme dhe prijësit tanë të shquar. Këtë rrugë e ndoqën edhe nxënësit dhe studentët tanë, të cilët, së bashku me strukturat e tjera të shoqërisë sonë, kontribuan fuqishëm për lirinë dhe pavarësinë e vendit, si dhe për ndërtimin e shtetit dhe konsolidimin e tij. Motoja, “me fe dhe komb”, apo, “me komb dhe fe” ishte dhe mbeti përkushtimi i tyre i paluhatshëm në rrugën e përhapjes së Islamit, por edhe në mbrojtje të të drejtave kombëtare kundër pushtuesve. Kontributi i hoxhallarëve për vatan nuk u ndal kurrë, por ai vazhdoi deri në luftën tonë çlirimtare ku, vetëm në këtë të fundit, në vijat e para të frontit u vranë 36 hoxhallarë.⁶

- Ta duash atdheun do të thotë t'i përmbushësh përgjegjësitë tua, ta ruash besimin e tij dhe ta përmbushësh atë ndaj popullit tënd.
- Ta duash atdheun do të thotë ta mbrosh atë, ta mbrosh shenjtërinë e tij dhe qytetarët e tij.
- Ta duash atdheun do të thotë ta ruash rendin e tij dhe ta reformosh popullin e tij, jo t'i korruptosh ata.
- Ta duash atdheun do të thotë ta respektosh të moshuarit, të jesh i sjellshëm me të rinjtë, të respektosh fqinjët, të mbash rendin dhe pastërtinë në rrugë dhe të mos ngacmosh askënd.
- Ta duash atdheun do të thotë të jesh i kujdesshëm për të gjitha pasuritë e tij dhe t'i trajtosh ato si vlerë e përbashkët e tërë popullit.
- Ta duash atdheun nuk është vetëm për një ditë në vit, ose për një fotografi apo një flamur, por përkundrazi ta duash atdheun çdo ditë dhe në çdo kohë.

Atdheu kërkon prind të mirë, i cili edukon fëmijët e tij në frymë të shëndoshë dhe në rrugë të drejtë. Kërkon mësues të mirë, të cilët i edukojnë dhe i mësojnë nxënësit në formën më të mirë të mundshme, kërkon punëtorë administrate, që iu kryejnë shërbime qytetarëve me ndërgjegje të plotë. Kërkon hoxhallarë, të cilët punojnë natë dhe ditë për vetëdijesimin e shoqërisë, që i lidhin njerëzit me fenë dhe atdheun e tyre, duke u shpjeguar atyre rëndësinë e atdheut, ruajtjen e tij dhe kultivimin e vlerave. Kërkon politikanë, që nuk e marrin



Fadil Rashiti, dëshmor i kombit (ish-medresant)

postin për tjetër pos që t'u shërbejë popullit të tyre. Kërkon tregtarë dhe biznesmenë të mirë, të cilët synojnë ta përparojnë vendin dhe ta zhvillojnë ekonominë. Kërkon gazetarë të mirë, të cilët mbrojnë vlerat e popullit dhe i përhapin ato. Kërkon policë dhe ushtarë të mirë, që mbrojnë vatanin me dinjitet nga çdo e ligë e mundshme. Kërkon bujq, që punojnë tokën mirë dhe me vullnet. Pra, kërkon një sensibilizim gjithëpopullor të çdo individi. Dashuria ndaj atdheut nënkupton që interesi i shtetit, pra i atdheut dhe i shoqërisë, të jetë parësor dhe mbi interesat personale.

Mbrojtja e atdheut me pasuri dhe me trup është parim i fesë, dhe llogaritet kontribut i shenjtë, i cili gradohet lart dhe shpërblehet shumë nga Zoti xh.sh.. Nga ana tjetër, sipas mësimave të Islamit, tradhtia ndaj atdheut është ndër mëkatet më të mëdha. Ata që nuk e duan atdheun e tyre, ata që punojnë për të keqen e popullit dhe të vatanit të vet ata nuk i do as Zoti Fuqiplotë.⁷

Si përfundim, i lutem Zotit xh.sh. që ta mbrojë vendin tonë nga çdo e keqe, fatkeqësi, konflikt dhe dëm. Lutemi që t'i udhëzojë prijësit tanë që të punojnë për të mirën e vendit. Të vendosë siguri dhe mbrojtje në vendin tonë, dhe të na kursejë nga përçarjet, konfliktet, mosmarrëveshjet, korrupsioni dhe dukuritë negative.

1 Paqarizi, Sead, “Detyrat e besimtarit ndaj atdheut”, Dituria Islame, Janar&shkurt, 2023, 11. Fe&Shkencë

2 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 1802

3 Ibën Haxheri, “Fet’hul Bari sherhu Sahihul Buhari”, 3/621.

4 Transmetojnë Imam Ahmedi, hadithi nr. 18715, Tirmidhiu, hadithi nr. 3925, Ibën Maxheh, hadithi nr. 3108, etj.

5 Ebu Abdullah Shemsuddin edh Dhehebij, “Sijeru A’lami Nubela”, 15/394.

6 Tërshani, Isa, “Atdhedashuria si kërkesë fetaro-islame”, Dituria Islame, Nëntor, 2023, 7.

7 Po aty.

Atdheu ndërmjet ndjenjës dhe përgjegjësisë

Myrvete Allmeta

“Ah sa vend i mirë dhe sa i dashur je për mua! Po të mos ishte që populli im më dëboi prej teje, unë nuk do të kisha banuar askund tjetër veç teje.”

- Pejgamberi
Muhamed a.s.,
në lamtumirën e
tij ndaj Mekës

Atdheu ngjizet me dashurinë që në lindje, dhe çdo krijesë e gjallë që frymon e do vendin e lindjes: zogjtë e duan qiellin, ajrin dhe nuk mund të jetojnë ndryshe pos në qiell, peshqit e duan ujin dhe pa ujë nuk mund të jetojnë, kafshët i duan zgavrat, strofullat e tyre, sepse ato përbëjnë atdheun e tyre.

Njeriu nuk e kupton vlerën e mëmëdheut veçse kur e kalon detin, atëherë kur emigron, atëherë e merr malli për gurin që ia ka çarë këmbën. Tek atëherë ai thotë: “Dua të kthehem në vendin tim, pasi atje balta më duket më e ëmbël se mjalti.” Duhet ta provosh athtësinë e mërgimit qoftë edhe një ditë të

vetme, që ta kuptosh se nuk ka vend më të bukur në botë sesa vatani ynë, dhe se nuk ka njerëz më të mirë se shqiptarët. Kur je brenda-përbrenda, nuk ia di vlerën as tokës dhe as vëllait tënd. Por te mërgimtari... Ah! Vatani në mendjen e një mërgimtari nuk ndahet. Me të gdhahet, me të ngryset.

Vallahi, bahçet më të bukura të dynjasë kurrë nuk më janë dukur më të hijshme se livadhet, lëndinat, pse jo edhe ferrat e vendit tim. Dallëndyshet duket se kanë tjetër cicërimë në vatanin tim.

Edhe dielli shkëlqen më shumë dhe hëna duket me më shumë nur dhe hare në vatan.



Shume prej rilindësve trupin e kishin në Stamboll, por shpirtin dhe mendjen e kishin tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë, tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e mërë.¹

Shejh Muhamed el Gazali, Zoti e mëshiroftë, ka thënë: “Njerëzit e duan tokën e tyre, pavarësisht si është ajo, qoftë edhe shkretëtirë. Kjo dashuri është një instinkt i rrënjësuar që e bën të gjejë ngushëllim duke qëndruar në të, t’i mungojë kur është larg, si dhe ta mbrojë nëse sulmohet dhe luftohet.”²

Më i miri i njerëzimit, Pejgamberi ynë Muhamedi a.s., në natën e emigrimit të tij për në Medinë, kur arriti në periferi të Mekës, qëndroi duke i dhënë lamtumirën tokës dhe shtëpive të saj, duke iu drejtuar asaj me fjalë që zbulojnë një dashuri të thellë dhe një lidhje të forte me shtëpitë e familjes dhe miqve të tij, vendin e fëmijërisë, atje ku ishte rritur, dhe tokën e shenjtë të Zotit, duke thënë: “Ah sa vend i mirë dhe sa i dashur je për mua! Po të mos ishte që populli im më dëboi prej teje, unë nuk do të kisha banuar askund tjetër veç teje.”³

Thënë ndryshe, dashuria për atdheun është pjesë e besimit, pasi është një nga veprimet e Pejgamberit tonë a.s.. Por, vatanin e do besimtari dhe jobesimtari, e do ai që e njehson Allahun, por edhe ai që i bën shok Atij. P.sh.: Gjergj Fishta, (1871-1940) ishte at françeskan, por ai njihet si atdhetar dhe veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare. Ai, nga mërgimi, i drejtohet atdheut me vargje tepër mallëngjyese:

*Veç se ty të shoh un nandër,
Veç se ty, cuet, t’kam n’mendim,
Ndër t’vështira ti m’je qandërr,
Për ty i lehtë m’vjen çdo ndëshkim.*⁴

Pra, kjo dashuri është instinktive. Këtë e pohon shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, kur thotë: “Dashuria për atdheun është si dashuria për veten, pasurinë etj.. E gjithë kjo ndodh instinktivisht te njerëzit. Dashuria për të nuk është e lavdërueshme, as nuk është një kusht besimi. Nuk ka ndryshim në këtë midis besimtarëve dhe jobesimtarëve.”⁵

Por, dashuria për atdheun, vallë a duhet të mbetet vetëm te ndjenja? Jo! Ajo duhet të përkthehet në vepra. Dashuria e atdheut nuk tregohet veç duke formuar me gishtërinj krahët e shqipes, e duke vënë plisin në kokë, e duke kënduar këngë

Dashuria e atdheut nuk tregohet veç duke formuar me gishtërinj krahët e shqipes, e duke vënë plisin në kokë, e duke kënduar këngë patriotike, e duke i folur nga ana tjetër gjuhë të huaj fëmijës, e duke e lënë në harresë shqipen, pasi është gjuhë e rëndë.

patriotike, e duke i folur nga ana tjetër gjuhë të huaj fëmijës, e duke e lënë në harresë shqipen, pasi është gjuhë e rëndë.

Jo! Jo! Dashuria e atdheut fillon që te mësimi i abetares, mos hedhja e facoletës nga dritarja e makinës, mos pështymja në tokë, mos djegia e mbeturinave në mes të mëhallës, mos thyerja e shisheve të birrës në breg të detit pas dehjes etj..

Atdheun tonë e duam më shumë duke mos u arratisur prej vendit dhe lënë atë të shpopulluar.

E nëse kemi emigruar për disa vite, kokën duhet ta mbajmë pas për nga dheu ynë, dhe atë dije dhe eksperiencë që e kemi përfituar jashtë shtetit të vijmë dhe ta përcjellim edhe në atdhe.

Atdheun e duam më shumë kur të kthehen intelektualët, truri i vendit. Është për të ardhur keq që vendi ynë është renditur i teti në botë për sa i takon nivelit më lartë të emigracionit të popullsisë së arsimuar, i njohur si fenomeni “Brain Drain”, apo emigrimi i trurit në raport me popullsinë.⁶

Por që “emoragjia e trurit” të ndalet, lipset që të hiqen presionet politike, ekonomike dhe mjedisore karshi intelektualëve. Emigrimi nuk mund të eliminohet totalisht, pasi edhe zogjtë shkojnë atje ku ka më shumë ushqim. Ne nuk mund të pretendojmë se do të arrijmë sa hap e mbyll sytë prosperitetin e vendeve me të ardhura të larta, të cilat zakonisht ofrojnë mundësi të mira ekonomike dhe stabilitet politik, të pakrahasueshëm me vendin tonë, por nëse ne posedojmë dëshirën e mirë, me

punë dhe sinqeritet, nuk do të mbetemi në vend numëro, por do të avancojmë dhe atdheu ynë nuk do jetë një “tmerr” për të rinjtë intelektualë, por një çerdhe e ngrohtë që i mirëpret bijtë e vet, ua siguron atyre çfarë u lipset, dhe si rrjedhim do të tkurret emigrimi.

Por edhe bujku, muratori, punëtori i thjeshtë le të vijnë dhe ta ndërtojnë vendin e vet, t’i mbjellim arat dhe fushat tona, e jo t’i lëmë djerr këto toka pjellore. Tregtari që ka formuar tregti në Perëndim dhe ka vënë shuma të mëdha mënjane, le të kontribuojë duke hapur një kopsht apo një çerdhe pranë pallatit, të mbjellë ca pemë dhe të vendosë ca lodra që të lodrojnë fëmijët! Nëse ka shumë kapital, të ndërtojë dhe ndonjë fabrikë, punishte etj., që të punojnë të rinjtë dhe të angazhohen e mos t’i kenë sytë nga deti për të shtegtuar nga vendi i tyre.



Atdheu ecën përpara kur të ndalet korrupsioni dhe burokracia në të gjitha instancat e vendit. Është për të ardhur keq kur shoh pensionistin e gjorë që i zgjat dy mijë lekëshin peshqesh (ryshfet) arkëtares, pasi po nuk ia dha, herës tjetër ia vonon pensionin; instruktori që të japë patentën, duhet të marrë nga 150 mijë lekë të vjetra ryshfet, që t'ia dorëzojë kartonin në dorë personit.

Dhe ne vetë si besimtarë kur ndeshim probleme në dokumentacione të ndryshme, gjejmë rrugë të shkurtër ryshfetin, duke ditur se Pejgamberi a.s. e ka dënuar këtë veprim: “Si ai që e jep, ashtu dhe ai që e merr ryshfetin, të dy janë në zjarr.”⁷

Nëse e duam atdheun, lipset që t'u japim dorë udhëheqësve shpirtërorë, pasi vrasjet dhe krimet, po ndodhin ngase njerëzit janë bosh shpirtërisht. Pas çdo krimi fshihet një mosinformim, një neglizhencë në edukim. Nëse nuk u vlerësohet puna, atëherë këta udhëheqës shpirtërorë nuk

kanë kohë as mundësi për të mbjellë te të mëdhenjtë dhe të vegjlit. Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kije frikë Allahun kudo që të jesh, veprën e keqe pasoje me të mirë, sepse ajo do ta shlyejë atë dhe me njerëzit sillu me moral të mirë.”⁸

Individi, i madh apo i vogël qoftë, nuk do ta ketë ndjenjën e mbikëqyrjes, sepse udhëheqësit shpirtërorë nuk kanë mundur t'i tregojnë se Allahu e sheh dhe dëgjon atë kudo që të shkojë, qoftë dhe në errësirat më të dendura, qoftë dhe në vendet më të largëta, madje dhe në labirintet më të fshehta. Nëse asnjë krijesë e gjallë nuk e sheh, ai nuk i shpëton dot mbikëqyrjes së Allahut, i Cili është i Gjallë. Nuk e merr Atë as kotja dhe as gjumi.

Atdheu avancon kur investohet te mjeku, inxhinieri etj.. Inxhinieri, po nuk u vlerësua me rrogën që i takon, mos të çuditemi kur të ndërtojë themele pallatesh dhe ndërtesash, që rrëzohen në tokë me një lëkundje të lehtë tërmeti. Gjyqtari, po nuk mori vlerësimin monetar që meriton, do të detyrohet të bjerë pre e gjykimit të së padrejtës në vend të së drejtës. Intelktuali, po që me kokë në dorë gjithë kohës, po nuk pati siguri, atëherë do të zgjedhë rrugën e shkurtër, ikjen nga vendi.

Gjithashtu, të vihet dorë në arsim, pasi mësuesi e ka në duar brezin e ri. Jo të ndërtohen tri shkolla për tre nxënës në katund, kur dihet që katundi është boshatisur, por të ofrohet pagë e mirë për mësuesit e shkollave që janë plot me nxënës, qofshin ata nëpër qytete apo fshatra, në mënyrë që edukatorët dhe mësuesit ta bëjnë me dëshirë e zell punën e tyre.

Të investohet te familja, e më saktë te nëna, pasi nënat janë shkolla. Nëse janë të përgatitura mirë, ato prodhojnë një brez të drejtë me moral të lartë. Nënat janë si kopshtet e lëndinat që, kur ujiten nga shiu, lulëzojnë, përgatisin brezin e ri. Nënat janë mësueset më të mëdha, arrijtjet dhe kontributet e tyre tejkalojnë kohën dhe gjithë horizontet. Janë ta pakapshme ato arritje, të pamatshme.

Por, në fillim dhe në fund nuk duhet t'i mbajmë sytë te politikanët që vejnë dhe vijnë, sot janë, nesër nuk janë. “Me të vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.”⁹

Lipset që ne të kontribuojmë për vendin tonë për të bërë ndryshimin e shumëpritur. Vendi është yni, dhe ne dhe fëmijët tanë, do ta gëzojmë dhe trashëgojmë brez pas brezi atë, në dashtë Zoti.

1 Naim Frashëri, “*Bagëti e bujqësi*”.

2 Muhamed el Gazali, “*Ihja 'e ulum ed Din*”

3 Transmeton Tirmidhiu (5/723), nr. 3926.

4 Gjergj Fishta, “*Atdheu*”.

5 *Es Silsiletu Ed Daifah*, nr:36.

6 Albinfoch

7 Transmeton Ebu Davudi, 3580.

8 Transmeton Tirmidhiu.

9 Er Rrad, 11.

Myslimani aktiv në shoqëri

Fitim Flugaj

Myslimani i vërtetë asnjëherë nuk mund të jetë pasiv në shoqërinë ku jeton, sepse ka aq shumë për të dhënë, sa që as vetë ai nuk e di, sidomos në kohën bashkëkohore. Kjo vjen nga fakti se jeta e myslimanit është e programuar sipas programit hyjnor, e bazuar në Kuran dhe Sunet.

Islami është fe e përsosur dhe e vetmja e pranuar tek Allahu. Lidhur me këtë, Allahu thotë: *“Pa dyshim tek Allahu është e pranuar vetëm feja islame...”* (Ali Imran, 19). Prandaj, nuk është për t'u befasuar që kjo fe është shembullore në të gjitha ligjet dhe rregulloret e saj. Nuk do të gjejmë kurrë diçka të ngjashme me të, si në qëndrueshmërinë e sistemeve dhe legjislacionit të tij, as në koherencën e mësimave të tij.

Sistemi shoqëror, si një nga sistemet e Islamit, synon të krijojë një shoqëri, që është e integruar në të gjitha aspektet e saj, një shoqëri që arrin kënaqësinë e Zotit të saj dhe meriton lumturi në të dy botët. Kjo do të thotë që shoqëria myslimane duhet të jetë e pastër në të gjitha aspektet e saj, e lirë nga imoraliteti në të gjitha aspektet e saj, e lirë nga bixhozi dhe narkomania, si dhe nga të gjitha të këqijat dhe të ligat. Nëse ndodh ndonjë nga këto, duhet të konsiderohet si një devijim nga norma dhe duhet të luftohet nga të gjithë individët dhe institucionet brenda shoqërisë myslimane.

Shoqëria nuk mund ta arrijë këtë qëllim dhe këtë nivel nëse çdo individ brenda saj nuk e merr seriozisht përgjegjësinë e tij. Prandaj, përgjegjësia ndahet midis sistemeve të shtetit, udhëheqësve të tij, si dhe midis individëve të

Një shoqëri e drejtë ndërtohet kur secili merr përgjegjësinë e tij me ndërgjegje dhe devotshmëri.



shoqërisë, pavarësisht nga pozicionet që kanë dhe cili është statusi i tyre.

Për ta arritur një gjë të tillë, atëherë duhet analizuar si ka mundur që Islami ta realizojë një gjë të tillë, kur dihet nga e kaluara që e ka realizuar dhe ka fuqinë për ta realizuar edhe sot e kësaj dite. Në këtë rast, na paraqitet veprimi dhe nxitësi i veprimit. Veprimi është reforma dhe nxitësi për arritjen e reformës ose reformimit është Kurani famëlartë dhe Suneti i Pejgamberit a.s..

KURANI DHE REFORMIMI

Kurani i nxit individët të përpiqen për reformimin e tyre dhe i ndalon ata të shkaktojnë korrupsion brenda tij (reformimit). Zoti i Plotfuqishëm thotë: *“Dhe bashkëpunoni në drejtësi dhe devotshmëri, por mos bashkëpunoni në mëkat dhe agresion.”* (El Maide, 2). Ai gjithashtu thotë: *“Dhe mos shkaktoni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj.”* (El Araf, 56).

Ai deklaroi se kjo është karakteristika e domosdoshme e besimtarëve: *“Besimtarët dhe besimtare janë aleatë të njëri-tjetrit. Ata urdhërojnë në mirësi dhe ndalojnë nga e keqja, falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ata, Allahu do t'i mëshirojë. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”* (Et Tevbe, 71).

Mirësia ose e mira që urdhërojnë besimtarët dhe besimtare është një term gjithëpërfshirës për gjithçka që kërkohet nga ligji islam, dhe e keqja që ata ndalojnë është gjithçka që ligji i pastër islam ndalon. Kjo përfshin, sigurisht, gjithçka që përmirëson shoqërinë dhe e pastron atë nga çrregullimi. Një gjë e tillë e bën besimtarin mysliman të dallohet me aktivitetin e tij të vazhdueshëm dhe konsekuent gjatë gjithë jetës së tij, drejt përmirësimit të gjendjes së shoqërisë, duke reflektuar nivelin e lartë edukativo-etik-moral dhe zbatues të drejtësisë. E gjithë këtë energji dhe forcë e hasim te besimtarët e sinqertë dhe të devotshëm, për të qenë aktivë dhe në nivel të përgjegjësisë, vetëm e vetëm për ta zbatuar drejtësinë. Zbatimi i drejtësisë e bënë vërtet zëvendës të Zotit në tokë dhe realizues të thënies së Zotit.

Është diçka që transmetohet nëpër breza besimtarësh, si një këshillë që Llukmani ia dha të birit të tij: *“O biri im, fal namazin, urdhëro të mirën, ndalo të keqen dhe ji i durueshëm për atë që të godet. Vërtet, (të gjitha) këto janë nga çështjet (që kërkojnë) vendosmëri.”* (Llukman, 17).

Një besimtar i sinqertë dallohet për aktivitetin e tij të vazhdueshëm, moralin e lartë dhe zbatimin e drejtësisë, duke qenë pasqyrë e fjalës së Zotit

Kurani i dënon ata që janë të tepruar në përpjekjet e tyre për t'u reformuar dhe kërkojnë atë, deri në atë pikë sa populli i tyre u zhduk. Ai thotë: *“Pse nuk kishte midis brezave para jush njerëz me mendje të shëndoshë që ndalonin korrupsionin në tokë?”* (Hud, 116), që do të thotë, a nuk kishte midis tyre njerëz të bindur, fetarë dhe të arsyeshëm që do t'i ndalonin njerëzit e tyre nga korrupsioni në tokë?

Pra, Kurani kërkon nga ne besimtarët që asnjëherë mos të kalojmë në pasivitet dhe mos të ndalemi në luftën kundër korrupsionit, degjenerimit dhe veseve të këqija. Ai kërkon që ne mos të ndalemi në asnjë moment në përpjekjet tona për ta zbatuar drejtësinë në shoqëri dhe për ta luftuar padrejtësinë, kudo që paraqitet në rrethin ku jetojmë dhe punojmë dhe në botën mbarë, gjithnjë kuptohet në suaza të mundësive që kemi: *“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd (në besim të drejtë, në drejtësi, në punë të mira dhe largim nga punët e këqija) me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit”* (En Nahl, 125).

Të gjitha këto që u thanë më lartë përfshihen në kuadër të reformave që sjell Kurani tek individ dhe shoqëria, e që besimtarin mysliman e bëjnë sistematikisht aktiv dhe pjesëmarrës në shoqëri, pa marrë parasysh në çfarë shoqërie jeton. Gjithashtu e bëjnë obligativ që të jetë vazhdimisht në mënyrë sistematike aktiv duke thirrur në drejtësi.

Drejtësia në këtë rast përfshihet brenda rrugës së Zotit, duke përmbledhur besimin e drejtë në Zotin Një, si promotor të zbatimit të të gjitha drejtësive dhe parimeve ligjore të drejtësisë që burojnë nga Kurani dhe Suneti i Pejgamberit a.s.. Allahu i Madhëruar thotë: *“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun...”* (Ali Imran, 110). Gjithashtu në ajetin tjetër Allahu tha: *“Dhe ashtu (siç ju udhëzoam në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush...”* (El Bekare, 143).

Kurani dhe Suneti, ndryshe thënë Islami, e bëjnë që besimtari mysliman të ketë imunitet në dinjitetin dhe identitetin e tij gjatë integriteteve të tij në shoqëri, qofshin

edhe ato shoqëri jo islame. Që jep të kuptohet se kur besimtari dhe besimtarja myslimane integrohet në një X shoqëri, duhet të integrohet bashkë me vlerat islame, të cilat qëndrojnë në pedestalin mbinjerëzor ose mbihuman të vlerave moralo-etike njerëzore. Këtë konkluzë racionale po e mbështesim në faktin se, vlerat islame me bazë janë të ngritura mbi librin e shenjtë Kuranin dhe mbi shëmbëlltyrën e sunetit të Muhamed Mustafasë a.s., prandaj edhe e bëjnë të jetë mbihumane, kur dihet se vlerat njerëzore të bazuara në tradita dhe ide filozofike nga një filozof, sociolog ose moralist janë me të meta të shumta, njashthu siç është me të meta secili njeri dhe secila e shoqëri e secili popull.

Pra, besimtarët mysliman nuk guxojnë të izoloohen nga shoqëria ku ata jetojnë dhe të bëhen pasivë. Ata duhet të jenë aktivë dhe si pishtar ndriçues të integrohen në cilëndo shoqëri, gjithnjë të inspiruar dhe praktikues të parimeve dhe vlerave islame kuranore dhe profetike, të trashëguara nga mësimet dhe shëmbëlltyra e Muhamedit a.s..

SUNETI DHE REFORMIMI

Shumë hadithe gjenden në Sunet, e të cilat pohojnë përgjegjësinë e individit për reformimin e shoqërisë. Më e qarta dhe më e famshmja prej tyre është ajo që Imam Muslimi na shpalos në Sahihun e tij nga Ebu Said el Khudri, i cili ka thënë: “E dëgjova a.s. të thoshte: “Kushdo prej jush që sheh një të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e tij; nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e tij; nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, atëherë me zemrën e tij. Dhe kjo është forma më e dobët e besimit.”¹

Një mysliman përpiket me gjithë fuqinë e tij për ta sprapsur, parandaluar dhe ndryshuar të keqen. Nëse nuk është në gjendje ta eliminojë atë, ai do ta urrejë atë me zemër dhe në zemrën e tij. Edhe pse kjo mund të jetë forma më e dobët e besimit, është megjithatë e nevojshme, sepse urrejtja e së

keqes është hapi i parë në përpjekjen për ta denoncuar dhe luftuar atë sa herë që është e mundur. Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ai e ka përmbushur detyrimin e tij.

Lind pyetja: Pse është individi përgjegjës?; Pse individi është i thirrur ta reformojë shoqërinë ndërsa thirret edhe ta reformojë veten?

KËTU PËRFSHIHEN SHUMË ARSYE:

Mjedisi ku jetojmë ndikon në individin – Shpirti i një individi ose personi bëhet i shëndetshëm ose i pashëndetshëm, dhe besimi i tij bëhet më i fortë ose më i dobët në varësi të gjendjes së shoqërisë ose mjedisit në të cilën jeton ai person. Sa më e pastër dhe më e mirë të jetë një shoqëri, aq më shumë drejtësi dhe pastërti do të përjetojnë zemrat e njerëzve të asaj shoqërie, dhe anasjelltas.

Reforma e shoqërisë është thelbësore – Meqenëse Zoti e krijoi njerëzimin për një qëllim, që është adhurimi i Tij, në kuptimin e tij gjithëpërfshirës, fjalët, veprimet, gjendjet, sjelljet dhe marrëdhëniet e tyre të jashtme dhe të brendshme duhet të jenë në përputhje me këtë qëllim dhe për këtë qëllim, që nëpërmjet tyre të adhurohet Krijuesi i Madhëruar. Një person nuk mund ta formësojë jetën e tij dhe ta mbushë atë me këtë karakter, përveç nëse shoqëria në të cilën jeton është e organizuar dhe e vendosur në një mënyrë që e lehtëson këtë formulim, domethënë, një shoqëri e drejtë islame.

Prandaj, myslimanëve u urdhërohet të emigrojnë nga shoqëritë e jobesimtarëve dhe të mos banojnë atje, ose të banojnë midis politeistëve, ku nuk janë në gjendje t'i praktikojnë ritualet e fesë së tyre. Prandaj, detyra e parë e shtetit mysliman ishte të krijonte këtë shoqëri: “(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë



dhe largojnë prej të keqes. Allahut i takon përfundimi i çështjeve.” (El Haxh, 41).

Shpëtimi nga ndëshkimi kolektiv – Nëse individët dështojnë të përmbushin detyrën e tyre të reformës dhe ta ndalojnë korrupsionin, të gjithë janë në rrezik të ndëshkimit kolektiv, i cili përfshin të gjithë dhe nuk përjashton askënd, madje as të drejtët midis tyre. Zoti i Plotfuqishëm thotë: “*Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, (por edhe të mirët), dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë.*” (El Enfal, 25).

Ibën Abbasi, në një hadithul ether, ka thënë: “Zoti i urdhëroi besimtarët të mos e tolerojnë të keqen midis tyre, që të mos u përhapet ndëshkimi.”

Ibën Kethiri ka thënë: “Zoti i Plotfuqishëm i paralajmëron shërbëtorët e Tij besimtarë për një sprovë, d.m.th., ndodh një sprovë, e cila përfshin keqbërësin dhe të tjerët, dhe nuk kufizohet vetëm tek ata që kryejnë mëkate ose ata që kanë kryer mëkatin, por përkundrazi i përfshin të gjithë.”

Kur e kemi fjalën te shpëtimi, shpëtimi lidhet ngushtë me reformën, jo me drejtësinë, dhe kjo është e njohur mirë nga Kurani, Suneti dhe historia, siç na tregoi Zoti i Plotfuqishëm për fshatin pranë detit, duke thënë: “*E kur braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që pengonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të fortë, ngase ishin të shfrenuar.*” (El Araf, 165).

Në suren Hud, i Plotfuqishmi Allah thotë: “*E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmirë.*” (Hud, 117).

Pejgamberi a.s., kur është pyetur se a do të shkatërrohemi ndërsa ende ka njerëz të mirë mes nesh?, ai a.s., ka thënë: “*Po! Nëse e keqja shtohet.*”² Kjo tregon se prania e njerëzve të drejtë nuk e pengon fatkeqësinë dhe dënimin të zbrësë, përveç nëse ata urdhërojnë drejtësi dhe mirësi dhe ndalojnë korrupsionin dhe të keqen.

Hadithi që e transmeton Numan ibën Beshirit e tregon qartë këtë. Ai a.s., ka thënë: “Shembulli i atij që i përmbahet kufijve të Allahut dhe i atij që i shkel ato është si shembulli i atij që hodhi short për të hipur në një anije. Disa prej tyre morën kuvertën e sipërme dhe disa të tjera kuvertën e poshtme. Kur ata në kuvertën e poshtme donin të mbushnin ujë, duhej të kalonin pranë atyre në kuvertën e sipërme. Ata thanë: “Nëse do të mund të bënim një vrimë në pjesën tonë

Myslimani i vërtetë nuk është kurrë pasiv. Ai është si një burim i pastër uji që freskon shoqërinë, apo si qiriu i Naim Frashërit, që digjet për t'u bërë dritë të tjerëve.

dhe të mos i dëmtonim ata në kuvertën e sipërme, nëse i lënë të bëjnë çfarë të duan, të gjithë do të zhduken. Nëse i marrin për dore, do të shpëtohen dhe të gjithë do të shpëtohen.”³

Vetëm drejtësia individuale, pa punuar drejt reformës, nuk është e mjaftueshme për t'i ruajtur kombet dhe shoqëritë. Kjo është pikërisht ajo që Ebu Bekri r.a. kishte ndërmend t'ua përcjellë njerëzve kur tha: “O njerëz, recitoni këtë ajet: “*O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë...*” (El Maide, 105). E dëgjova të Dërguarin e Allahut a.s., të thoshte: “Nëse njerëzit shohin një zullumqar (shtypës) dhe nuk e marrin për dore, Allahu së shpejti do t'i ndëshkojë të gjithë.”⁴

Ky është misioni i përgjithshëm i individit mysliman. Çdo individ duhet ta ndërmarë këtë detyrë që i është besuar dhe ta kryejë atë në masën më të plotë, nëse dëshiron që shoqëria e tij të jetë e drejtë. Kjo e kënaq Zotin dhe e bën krijimin të lumtur.

S'ka dyshim se Allahu është Dhuruesi i suksesit dhe Udhëzuesi në rrugën e drejtë. Nga myslimani dhe myslimanja kërkohet aktiviteti, puna dhe përpjekja për ta përhapur të vërtetën, për të urdhëruar në punë të mira dhe për të ndaluar nga punët e këqija dhe të neveritshme, duke qenë vetë shembull i lartë në praktikimin e fesë dhe sistemit islam, në mesin dhe rrethin ku ai apo ajo jetojnë.

Përtacia-dembellëku dhe neglizhenca nuk mund të gjejnë vend te personaliteti i myslimanit. Myslimani gjatë gjithë jetës është aktiv dhe i përngjan një burimi të ujit të pashtershëm, që është i pastër dhe i freskët, dhe i cili freskon edhe rrethin ku buron. E nganjëherë duhet të bëhet si qiriu i Naim Frashërit, të digjet dhe t'u bëjë dritë të tjerëve.

1 El Xhevahir el Lulujjeh (315) El Ilam (432). Sherh Muslim nga El Neveviu (2/24, hadithi. 49). Fajd el Kadir (6/169, hadithi 8678). Sherh Muslim nga El Neveviu (2/23, hadithi 78). Sherh Muslim nga El Neveviu (2/18, hadithi 49). Sherh Muslim nga Kadi 'Ijad (1/288, hadithi 49). Sherh el Arbain nga Ibën Dakik el Eid (101). El Bejan ue'l Tarif (3/215, hadith 1540). Sherh el Arba'in el Nevevi nga Ibën Dakik el Eid (102).

2 Sahihu i Buhariut, 3346, pjesa 4, f. 137. Libri i haditheve të profetëve, kapitulli: “Historia e Xhuxhi dhe Maxhuxhit”. Sahihu i Muslimit, 2880, pjesa 8, f. 166. Libri i Mundimeve dhe Shenjave të Orës së Fundit - Kapitulli: “Mundimet që po afrohen dhe hapja e barrierës së Xhuxhi dhe Maxhuxhit.”

3 Është transmetuar nga Buhariu në Sahihun e tij, Libri i Partneriteteve, Kapitulli: “A lejohet të hidhet short në ndarje dhe të kërkohet short në të”, (3/139), nr. (2493).

4 Transmetuar nga Ebu Davudi, El Tirmidhiu, El Nesaiu në El Kubra, Ibën Maxhe dhe Ahmedi - Sunen el Tirmidhi – 2168.

Tabiinët – hallka e dytë e ndërtimit të shkollës juridike hanefite

Dr. Muhamed Stublla

Nga temat e mëparshme, “*Sahabët – hallka e parë në themelimin e medhhebit hanefi*” dhe “*Muhadramët, bashkëthemelues të hallkës së parë të medhhebit hanefi*”, me argumente shkencore, kemi paraqitur fuqinë e haditheve dhe gjithpërfshirjen e tyre në themelimin e medhhebit hanefi. E veçanta e këtyre punimeve qëndron në faktin se sahabët, që përfaqësojnë këtë shkollë, janë ndër ata që ishin më të diturit për jetën dhe veprimtarinë e Muhamedit a.s.. Punimet shkencore kanë treguar se mendimet e tyre përputhen me aspektin shkencor të medhhebit hanefi në rreth 90% të rasteve. Ata konsiderohen themeluesit e mendësisë së medhhebit hanefi. Sahabët janë të nderuar me privilegjin e takimit të tyre me Muhamedin a.s., privilegj që nuk i është dhënë askujt tjetër. Ndërsa, për sa i përket diturisë, gjejmë

shumë tabiinë, veçanërisht muhadramë, të cilët u ngjanin atyre, madje ndonjëherë edhe dalloheshin nga disa sahabë. Kemi përmendur dëshmi të sahabëve për diturinë e tabiinëve, si edhe raste kur sahabët konsultoheshin me ta, kjo ishte më e shfaqur me tabiinët muhadramë. Pra, sahabët dhe tabiinët muhadramë vendosën themelet e medhhebit hanefi, duke formuar mendësinë dhe logjikën e qasjes së tij. Në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet një ndarje apo prerje shkencore e qartë ndërmjet sahabëve dhe tabiinëve muhadramë, për arsien e thjeshtë se një numër i konsideruar i sahabëve dhe tabiinëve muhadramë e pranuan Islamin në të njëjtën kohë, jetuan dhe vepruan në të njëjtën periudhë historike, madje shpesh edhe në të njëjtat vende. Kjo ndarje shkencore është më e lehtë me tabiinët që erdhën apo lindën pas vdekjes së Muhamedit a.s.. Sa i

Sahabët dhe tabiinët muhadramë vendosën themelet e medhhebit hanefi, duke formuar mendësinë dhe logjikën e qasjes së tij.




përket *vlerës së gjeneratës së tabiinëve*, që pasuan sahabët, Muhamedi a.s., i kishte renditur ata si gjeneratën më të mirë pas sahabëve. Prandaj, në mënyrë të natyrshme, gjejmë në mesin e tabiinëve figura që shquheshin për dituri dhe devotshmëri. Ndër tabiinët, nxënësit e sahabëve që formësuan themelet e medhhebit hanefi, duke e ndërtuar atë mbi parime dhe rregulla shkencore, veçojmë:

Seid ibën Fejruzin, i cili ishte një tabiin i shquar dhe besnik i madh. Jetoi në Kufe dhe transmetoi hadithe nga Ibën Abasi, Ibën Omeri¹, Ebu Seid el Hudrij, Ebu Berze el Eslemij, si edhe nga sahabë të tjerë të gjeneratës së tyre. Seid ibën Fejruzi njihet si një dijetar i spikatur, ndër tabiinët më të ditur të brezit të vet. Ai mësoi dhe transmetoi prej shumë sahabësh, duke dhënë një kontribut të çmuar në përhapjen e hadithit dhe ditorisë. Kontribuoi në zhvillimin shkencor të Kufes, në të cilën ndërroi jetë më 83 h.²

2. Seid ibën Xhubejri r.a., ishte ndër tabiinët më të njohur për besnikëri, devotshmëri dhe dije. Ai jetoi në Kufe,³ u dallua për thellësinë në dituri, përkushtimin në adhurim dhe lidhjen e ngushtë me mësimet e sahabëve. Seid ibën Xhubejri është një nga figurat më të njohura të brezit të tabiinëve, i cili ndikoi fuqishëm në formimin e mendimit fetar në shkollën e Kufes dhe në themelimin e traditës shkencore, që më vonë u pasqyrua në

Kur një medhheb përfaqësohet nga dijetarë të një kalibrit të lartë, të lidhur ngushtë me burimin e parë të sunetit, është e pakuptimtë dhe e pajustificuar shkencërisht të thuhet se ai nuk përfaqëson sunetin.

medhhebin hanefi. Ai mësoi dhe transmetoi nga shumë sahabë. Imam Dhehebiu ka numëruar katërmëdhjetë sahabë nga të cilët ka transmetuar, ndër ta: Ibën Umeri, Ibën Abasi, Ebu Hurejra, Ibën ez Zubejri, Enes ibën Maliku, Ebu Seid el Hudrij, Aisheja r.a., dhe të tjerë. Po ashtu, imam Dhehebiu përmend me emra njëqind transmetues, që kanë transmetuar hadithe nga Ibën Xhubejri, dhe atë në vetëm gjashtë koleksionet e njohura të hadithit dhe, nëse i përfshijmë edhe koleksionet e tjera, numri i tyre do të jetë edhe më i madh. Kjo tregon se ai ishte mësues i shumë dijetarëve të shquar.⁴ Hadithet e transmetuara prej tij, nga dijetarë dhe juristë të njohur, të cilët morën ditorinë e tyre drejtpërdrejt nga sahabët, përbëjnë dëshmi të qarta për *fuqinë dhe autenticitetin e haditheve* në ndërtimin e *medhhebit hanefi*. Kur një medhheb përfaqësohet nga dijetarë të një kalibri kaq të lartë, të lidhur ngushtë me burimin e parë të sunetit, është e pakuptimtë dhe e pajustificuar shkencërisht të thuhet se ai nuk përfaqëson sunetin. Një pretendim i tillë nuk është vetëm jo shkencor, por përbën një devijim të rëndë në historinë intelektuale të myslimanëve. Seid ibën Xhubejri, njëri prej themeluesve shpirtëror dhe intelektual të shkollës së Kufes, ishte prej atyre që *sakrifikuan dhe udhëtuan në vende të ndryshme për të arritur dituri*. Ai ishte *lexues dhe njohës i thellë i Kuranit dhe i kiraeteve të tij*. Në muajin



Ramazan, kur udhëhiqte xhematin, një ditë lexonte sipas kiraetit të transmetuar nga *Ibën Mesudi*, ditën tjetër sipas kiraetit të transmetuar nga *Zejd ibën Thabiti*, ndërsa ditën pasuese sipas një leximi tjetër. Kjo tregon për zotësinë e tij të jashtëzakonshme për *Kuranin famëlartë*.⁵ Seid ibën Xhubejri ishte ndër nxënësit më të dashur dhe më të dalluar të *Ibën Abasit r.a.*. Është transmetuar se, kur disa njerëz e pyetnin Ibën Abasin për çështje fetare, ai u thoshte: “A nuk është në mesin tuaj Ibën Xhubejri?”⁶ D.m.th., përderisa e keni Ibën Xhubejrin, nuk keni nevojë të më pyesni mua. Në një rast tjetër, Ibën Abasi i kishte kërkuar atij të jepte *fetva në praninë e tij*, gjë që përbën një vlerësim të lartë dhe një dëshmi të qartë për pozitën e tij shkencore. Nga këto dëshmi kuptohet qartë se saktësia e medhhebit hanefi është mbështetur në bazat e forta të transmetimit dhe të dijes, të dëshmuara nga vetë sahabët më të ditur dhe më të afërt me Pejgamberin a.s.. Imam Ahmed ibën Hanbeli ka thënë: “Kur u vra Ibën Xhubejri, ai ishte ndër më të diturit e kohës së tij, nuk kishte njeri që nuk kishte nevojë për diturinë e tij.” Ai konsiderohej ndër dijetarët që përmblodhën të gjitha fushat e dijes islame dhe u shqua në secilën prej tyre.⁷ Këto dëshmi tregojnë qartë se deklaratimet për figurat e tilla të dijes dhe devotshmërisë, si Ibën Xhubejri, janë dëshmi e fuqishme për seriozitetin dhe profesionalizmin e dijetarëve që hodhën bazat e mendësisë të medhhebit hanefi.

3. Ibrahim ibën Jezid Nehaiu r.a., ishte një nga dijetarët më të shquar të brezit të tabiinëve. Ai konsiderohej koka dhe referenca e dijes, gjeni i rrallë, jurist i jashtëzakonshëm dhe asket i njohur.

Ai adhuronte dhe rikujtonte shpesh Allahun, dhe njihej si “zotëria i tabiinëve” dhe “më i dituri i kohës së tij”. Ishte hafëz i dalluar dhe nuk kishte zakon të shkruante dijen apo hadithet, sepse kishte memorie të jashtëzakonshme. Ai e kishte takuar Aishen r.a., dhe si fëmijë, para moshës madhore, kishte hyrë dhe dëgjuar atë në shtëpinë e saj. Më vonë u bë myfti i Kufes. Ibrahim rridhte nga një familje intelektuale dhe e ditur. Xhaxhai i tij ishte imam Alkameja, me të cilin ishte i pandarë, ndërsa daja i tij ishte imam El Esvedi, të dy muhadramë, pra nga ata që e kishin pranuar Islamin në kohën e Pejgamberit a.s., por pa e takuar atë. Këta ishin mësuesit dhe udhëheqësit e tij, ndër më të shquarit e kohës së tyre. Imam Ibrahim ishte njohës i thellë i fikhut të Ibën Mesudit r.a., gjë që është e natyrshme, pasi mësuesit e tij ishin

Përputhshmëria e jashtëzakonshme e medhhebit me mendimet e sahabëve dhe atyre tabiinëve më të shquar, e cila, sipas dëshmimeve, sillet nga 84% deri në 92%, tregon qartë se medhhebi hanefi është medhheb i sahabëve dhe tabiinëve, një vazhdimësi e logjikshme dhe e saktë e mendimit fetar të brezave të parë të Islamit.

nxënësit më të mirë të Ibën Mesudit. Imami dhe dijetari i hadithit, Shabiu, me rastin e vdekjes së Ibrahimit, kishte thënë: “Nuk ka mbetur askush si Ibrahim.” Ndërsa Imam Ameshi, një tjetër dijetar i madh i hadithit, kishte thënë: “Për çdo hadith që e kam pyetur Ibrahim Nehaiun, jo vetëm që më është përgjigjur, por më ka dhënë edhe informacione të reja, të cilat unë nuk i dija më parë.” Ai shtonte: “Ibrahimi ishte mendjehollë në hadith, kur e pyesja për diçka, ai nuk fliste nga mendja e vet.” Këto dëshmi nga dijetarët më eminent islam dhe të hadithit, tregojnë qartë për fuqinë e njohjes së hadithit nga njëri prej ndërtuesve dhe figurave kryesore të medhhebit hanefi. Si mund të thuhet se hanefitë nuk janë ndjekës të sunetit, kur prijësit e tyre ishin dijetarë të këtij niveli, të cilët njihnin dhe transmetonin hadithet me saktësi të jashtëzakonshme? Kjo është një pohim i pavërtetë dhe i hedhur poshtë edhe nga dijetarët më të shquar të hadithit të asaj kohe, si Imam Shabiu dhe Imam Ameshi. Imam Shabiu, me rastin e vdekjes së Ibrahimit, kishte thënë: “Betohem në Allahun, nuk ka mbetur njeri i ditur si Ibrahim, as në Kufe, as në Basra, as në Sham, dhe as në Hixhaz.” Këto ishin qendrat më të mëdha të dijes islame të kohës, çka e tregon nivelin e lartë të tij. Fjalët nuk mund ta përshkruajnë shkallën e dijes së Imam Ibrahimit.⁸ Ai konsiderohet një nga figurave më me ndikim në ndërtimin dhe përhapjen e medhhebit hanefi. Për ta

dëshmuar këtë, mjafton të përmendim faktin se Imam Muhamed ibën el Hasen Shejbani, dijetari dhe shkruesi i medhhebit hanefi, në librin e tij “*El Athar*”, përmend gjithsej 982 transmetime. Nga këto, 532 janë “maktu’a” (fjalë të tabiinëve), të transmetuara nga 29 tabiinë. Nga këto transmetime, 450 janë vetëm nga Ibrahim Nehaiu, që përbëjnë 84.6% të këtyre transmetimeve.⁹ Kjo tregon qartë se ai ishte figura qendrore dhe referenca kryesore e medhhebit hanefi. Këtë e përforcon edhe dr. Muhamed Kalaxhi, në një punim të tij voluminoz për Ibrahim Nahaiun, i cili u botua në vitin 2007, nga Shtëpia Botuese “*En Nefais*” në Egjipt. Në këtë libër, autori trajton 100 çështje juridike të Imam Ibrahimit dhe i krahason me mendimet e medhhebit hanefi, duke vërtetuar se rreth 86% e tyre përputhen plotësisht me qëndrimet e medhhebit. Imam Ibrahim r.a. ndërroi jetë në vitin 96 h.¹⁰

Përputhshmëria e jashtëzakonshme e medhhebit me mendimet e sahabëve dhe atyre tabiinëve më të shquar, e cila,

sipas dëshmive, sillet nga %84 deri në %92, tregon qartë se *medhhebi hanefi është medhheb i sahabëve dhe tabiinëve*, një vazhdimësi e logjikshme dhe e saktë e mendimit fetar të brezave të parë të Islamit. Prandaj, *ne nuk mund të ndjekim një rrugë tjetër*, përveçse të *kapemi fort pas këtij litari të shëndoshë dhe të pandashëm*, medhhebit hanefi, i cili e paraqet fenë në bazë të *parimeve dhe argumenteve të Sheriatit: Kuranit, Sunetit, ixhmasë (konsensusit) dhe kijasit (analogjisë)*. Kush largohet nga kjo rrugë dhe nga rrugët e tri medhhebeve të tjera, bie në *injurancë* dhe rrezikon të *devijojë ose të rrëshqasë në ekstremizëm*. Një aspekt shumë i rëndësishëm për t'u kuptuar është se *sahabët dhe tabiinët kishin një metodë të veçantë të transmetimit, pranimi dhe interpretimit të haditheve*. Për shembull, *Ibrahim Nehaiu* transmetonte hadithe nga *Ibën Mesudi r.a.*, edhe pse ky kishte ndërruar jetë rreth 15 vite para lindjes së *Ibrahimit* (i cili lindi në vitin 47 h.). *Imam Shabiu* e kishte pyetur: “Si e transmeton hadithin nga *Ibën Mesudi*, kur nuk e ke takuar atë?” *Ibrahimi* i ishte përgjigjur: “Nëse them ky hadith ka ardhur përmes filanit nga *Ibën Mesudi*, dije se e kam dëgjuar vetëm nga ai që e përmenda. Por nëse them ka thënë *Ibën Mesudi*, dije se e kam dëgjuar nga disa persona që më kanë treguar se *Ibën Mesudi* ka thënë kështu.”¹¹ Kjo tregon se hadithet që vijnë *drejtpërdrejt nga sahabët* përmes rrugëve të shumëfishta transmetimi janë më të forta

Konfirmimi i saktësisë së haditheve të transmetuara nga tabiinët muxhtehidë është më i pranueshëm dhe më i besueshëm sesa gjykimet e mëvonshme, të cilat nuk mund të krahasohen me standardet dhe saktësinë e dijetarëve të brezit të parë.

dhe më të sigurta sesa ato që vijnë nga një person i vetëm. Pra, kur një *imam i shquar dhe dijetar i madh* transmeton drejtpërdrejt nga sahabët, *transmetimi i tij është i verifikuar dhe i pranuar nga ana e tij*. Në këtë mënyrë, gjykimi i tyre për saktësinë e haditheve është më i fuqishëm se i kujtdo tjetër, dhe kjo përbën metodologjinë shkencore të dijetarëve hanefi në shekullin e parë dhe të dytë hixhri. Ky koncept dallon nga metoda e hadithologëve të mëvonshëm, që u fokusuan më shumë në zinxhirin e transmetimit, transmetues pas transmetuesi.

Në realitet, konfirmimi i saktësisë së haditheve të transmetuara nga tabiinët muxhtehidë është më i pranueshëm dhe më i besueshëm sesa gjykimet e mëvonshme, të cilat nuk mund të krahasohen me standardet dhe saktësinë e dijetarëve të brezit të parë. Edhe *medhhebi maliki* është ndërtuar mbi një koncept apo logjikë të ngjashme të verifikimit dhe pranimi të haditheve në fushën e jurisprudencës islame, të cilat pranohen për argumentim në fikh.

4. *Amir ibën Sherahil Shabiu*, tabiin i njohur, i cili ka lindur rreth viteve 20–21 h. dhe ka vdekur midis viteve 104–109 h..¹² Ai ka takuar mbi 500 *sahabë*, ndër më të njohurit: *Aliun r.a.*,¹³ *Ebu Hurejrën*, *Ibën Omerin*, *Ibën Abasin* e të tjerë. Ky fakt tregon lidhjen e tij të pandashme me *Sunetin*. Nëse një numër kaq i madh *sahabësh* nuk mjafton për ta



konsideruar dikë të rrënjësuar në mësimet e Sunetit, atëherë kush mund të pretendojë se ka takuar më shumë sahabë dhe ka mësuar më shumë prej tyre për të pasur këtë të drejtë gjykimi? Shabiu ishte *hafëz* i shquar, saqë thoshte: “Nuk kam shkruar kurrë, dhe as nuk kam dëshiruar që dikush të më përsërisë të njëjtin hadith dy herë.” Dijetari i madh *Imam Mekhuli r.a.*, ka thënë: “Nuk kam parë njeri më të ditur për Sunetin dhe trashëgiminë islame sesa Imam Shabiu.” Shabiu për rreth *tetë muaj* ishte shoqëruar i pandashëm i *Ibën Omerit r.a.*, i cili ishte i njohur për kujdesin e veçantë ndaj hadithit. Ky dijetar i shquar, jo vetëm në Kufes, por në gjithë botën islame të asaj kohe, ishte i njohur në të gjitha disiplinat e dijes, veçanërisht në *hadith*. Ai ishte njëri nga *ndërtuesit e medhhebit hanefi*, një figurë e rëndësishme dhe me ndikim të madh në aspektin *shkencor* dhe *juridik* të këtij medhhebi, sidomos në fushën e gjykimit. Kjo tregon *konsekuencën e shëndoshë* me të cilën është bekuar medhhebi hanefi, prandaj me plot të drejtë thërrasim në këtë rrugë. Imam Shabiu ishte gjithashtu njohës i mirë i *matematikës*, çka dëshmon për nivelin e lartë shkencor të dijetarëve të Kufes dhe për gjerësinë e dijes së tij. Ai ishte *asket*, *rikujtues* i shpeshtë i *Allahut* dhe adhures *i përrulur*.

5. Amir bin Ebu Musa el Eshariu r.a., tabiin i nderuar, biri i sahabiut të njohur Ebu Musa el Eshariut r.a.. Ai kishte mësuar dhe kishte takuar shumë sahabë, duke filluar nga

babai i tij, Ibën Omeri, Aisheja r.a., e të tjerë. Ishte gjykatës i Kufes pas Imam Shurejhit,¹⁴ çka tregon për nivelin e lartë të ditorisë dhe besueshmërinë e tij, pasi detyra e gjykatësit në atë kohë u besohej vetëm dijetarëve të zgjedhur, veçanërisht në një periudhë kur në mesin e myslimanëve kishte shumë dijetarë të mëdhenj. Ka ndërruar jetë në vitin 103 hixhri.

6. Sead ibën Ubejd es Sulemij. Imam i shquar i Kufes, transmetues i njohur dhe i besueshëm. Takoi shumë sahabë dhe ishte mësues i shumë transmetuesve dhe dijetarëve të shquar. Ai përfaqëson një hallkë të rëndësishme në zinxhirin e dijes dhe të transmetimit të hadithit.¹⁵

7. Jahja bin Vethab el Esedij, tabiin i njohur, personalitet i

respektuar dhe i besueshëm i Kufes. Ishte lexues i dalluar i Kuranit dhe një nga imamët më të shquar të leximit dhe kirateve. Përveç kësaj, ishte edhe gjuhëtar i njohur. Ka vdekur në vitin 103 h..¹⁶

Këta dijetarë nga radhët e tabiinëve janë vetëm disa prej figurave të mëdha shkencore të kësaj hallke të artë të transmetimit, për të cilët kanë dëshmuar sahabë dhe tabiinë të tjerë. Dëshmia e tyre jo vetëm që është e pranuar, por llogaritet si garanci për saktësinë e transmetimeve dhe të kuptimeve të tyre. Ata ishin dijetarë, gjykatës, imamë, hadithologë, juristë, lexues të Kuranit dhe asketë të rrallë, cilësi që përbëjnë shembullin më të lartë të dijes dhe devotshmërisë. Këto virtyte duhet t'i synojë çdo njeri, dhe kush di t'i vlerësojë ato, duhet të ndjekë gjurmët e tyre. Në asnjë rrethanë, askush nuk ka të drejtë të zhvlerësojë ose të gjykojë për saktësinë, rrugën dhe mendësinë shkencore të sahabëve dhe tabiinëve, e cila është shndërruar në një mendësi medhhebore. Ky privilegj i takon dhe i është dhënë katër medhhebeve, ndër të cilat i pari në rend historik dhe metodologjik është medhhebi hanefi. Çdo rrugë ose përzjerje tjetër jashtë këtyre kornizave përfaqëson një qasje individuale ose grupe të cekët, përballë metodologjive që janë përdorur në medhhebet e njohura të Islamit.

“Nuk kam parë njeri më të ditur për Sunetin dhe trashëgiminë islame sesa Imam Shabiu.”

Imam Mekhuli r.a.,

- 1 Ibën Hiban, Muhamed ibën Hiban, *Eth Thikat*, (Indi, Vizareh el Mearif Ilihukumeh el Alije el Hindijeh, 1973), 4/286.
- 2 Edh Dhehbij, Shemsudin, *Sijer Ealam en Nubela*, (Bejrut, Muesestu err Rrisaleh, 1996), 4/279-280.
- 3 El Ixhlj, *Eth Thikat*, 1/181.
- 4 Edh Dhehbij, Shemsudin, *Tehdhib el Kemal fi Esma err Rrixhal*, (Bejrut, Mesesetu err Rrisaleh, 1992), 20/306.
- 5 Ibën Hakan el Bermekij, Shemsudin Ahmed, *Veffat el Ajan ve Enbaë Ebnaë el Ezman*, (Bejrut, Dar Sadim, 1994), 2/371.
- 6 Edh Dhehbij, *Tehdhib el Kemal fi Esma err Rrixhal*, 10/364.
- 7 Ibën Hakan el Bermekij, *Veffat el Ajan ve Enbaë Ebnaë el Ezman*, 2/372-375.
- 8 Shih: Ibën Es Sead, Muhamed, *Et Tabekat el Kubra*, (Bujrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1990), 6/279-290.
- 9 Shih, Revistën e Fakultetit të Studimeve Islame, *Boletini*, nr. 2, Prishtinë – Kosovë.
- 10 Ibën es Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/291.
- 11 Et Tahavij, Ahmed ibën Muhamed, Sherh Mushkil el Athar, (Bejrut, Muessesetu err Rrisale, 1494 h.) 14/519. Shih në formë të zgjeruar në: Stublla, Muhamed, Menhexh Muhamed ibën el Hasan esh Shejbani fi Kitabih el Huxheh ala Ehl el Medineh – Diraseh el Hadithijeh, (temë e doktoratës, e mbrojtur dhe gjendet në Universitetin e Jordanisë, në bibliotekën e saj) f. 147-148.
- 12 Ibën Hiban, Muhamed ibën Hiban, *Eth Thikat*, (Indi, Vizareh el Mearif Ilihukumeh el Alije el Hindijeh, 1973), 5/185.
- 13 El Buahri, Muhamed ibën Ismail, *Et Terih el Kebir*, (Rijad, en Nashir el Mutemejiz lit Tiba'ah ve et Tevzië, 2019) 7/549.
- 14 Ebu Naser, Ahmed ibën Muhamed, *El Hidajeh ve el Irshad fi Mearifeti Ehl eth Thikah ve es Sedad*, (Bejrut, Dar el Marifeh, 1407 h.) 2/557.
- 15 El Buahri, *Et Terih el Kebir*, 5/48.
- 16 Ebu Shejh el Asbehani, Abdullah, *Tabekat el Muhadithin bi Asbehan ve el Varidine Alejha*, (Bejrut, Muesesetu err-Rrisaleh, 1992), 1/358.

Leximi i Kuranit gjatë namazit duke shikuar në Mus'haf dhe dua gjatë sexhdes

Myfti Ebrahim Desai

Në parim, nuk lejohet që dikush, i cili nuk di sure përmendsh, të shikojë në Kuran dhe të lexojë pjesë nga Kurani gjatë namazit.

A lejohet që të shikohet në Kuran dhe të lexohet një sure e caktuar, që nuk e dimë përmendsh gjersa jemi duke falur namaz nafile (vullnetar)?

A MUND TË BËHET DUA (LUTJE) NË SEXHDE GJATË NAMAZIT FARZ?

Përgjigjja:

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirbërësit!*

Në parim, nuk lejohet që dikush, i cili nuk di sure përmendsh, të shikojë në Kuran dhe të lexojë pjesë nga Kurani gjatë namazit. Nëse dikush, i cili nuk di përmendsh sure nga Kurani, shikon dhe lexon pjesë nga Kurani

gjatë namazit, atëherë namazi i tij është jo valid.

Parimisht, është e lejuar që të bëhet dua (lutje) në sexhde gjatë namazit farz, nëse personi është duke e falur namazin individualisht (dhe jo me xhemat). Ky rregull i nënshtrohet kushteve të poshtëpërmendura:

Duaja duhet të jetë në arabisht;

Duaja duhet të jetë dua nga Suneti.

Është e këshillueshme që në sexhde, të mos thuhet dua përveç tesbihateve të porositura, ngaqë një gjë e tillë është në kundërshtim me Sunetin.

Allahu i Gjithëdijshtëm e di më së miri!

Shqipëroi: Daim Abazi



Edukimi familjar si garancë për formimin e brezave të ardhshëm

Florentina Tërmkolli

Për fat të keq, familja është atakuar në lloj-lloj forme dhe metode. Është synuar shkapërderdhja, prishja dhe deformimi i saj. Ne vitet e fundit, familja pësoi lëkundje të mëdha, nga të cilat shpeshherë hasim edhe në iniciativa të ndryshme dhe të shëmtuara, të cilat kanë për qëllim shkatërrimin e saj që nga themeli.

Gjithsesi është e ditur se familja e shëndoshë është celula, qeliza, bërthama kryesore e një shoqërie të shëndoshë, të suksesshme dhe të mbarë. Nuk mund të kemi breza të shëndoshë dhe breza të mirë nëse nuk posedojmë familje të mira dhe të shëndosha.

Duhet potencuar se nuk do të ketë familje të mira nëse pjesëtarët e asaj familje nuk janë të mirë, me theks të veçantë te grua, e cila është shtylla kryesore e familjes. Nga këtu kuptohet fare mirë se për çfarë arsye luftohet për “lirinë” e gruas, dhe mospërfilljen e asnjë rregulli dhe norme nga ana e saj.

Ata të cilët pretenduan se po punojnë për “lirinë” e gruas, mu të njëjtin janë të cilët mundohen t’i shkatërrojnë familjet e formuara dhe të edukuara mirë.

Nëse ka një institucion që krijon zakone, formon personalitete, transformon mentalitetin, kultivon mekanizmin e ndërgjegjes, nxitë solidaritetin shoqëror, zhvillon empatinë shoqërore, përgatitë gjenerata potenciale për sfidat e ardhshme, parandalon dhe zgjidhë probleme, ajo është familja.¹

Kush më mirë se sa Kurani dhe jeta e Pejgamberit Muhamed a.s. na mëson se familja e shëndoshë formon breza të shëndoshë, të dobishëm për vetën dhe të tjerët, edukon gjenerata, i formon ata dhe i kalit për jetën dhe sfidat e saj.

Nuk gjendet një portretizim më elokuent i ndikimit të familjes në rritjen e fëmijëve të shëndetshëm sesa fjalët e Zotit të Plotfuqishëm: *“Me lejen e Allahut toka e mirë mbinë bimët, e ajo që nuk është kualitative, ajo nuk mbinë vetëm (pak) me vështirësi...”* (El Araf, 58).

Sa e ngjashme është familja me një tokë të begatë e pjellore, që, kur kultivohet me dashuri dhe kujdes, lind fëmijë me prirje të pastra e vlera të mira²



Është e ditur se familja e shëndoshë është celula, qeliza, bërthama kryesore e një shoqërie të shëndoshë, të suksesshme dhe të mbarë.

Ruajta, kujdesi dhe edukimi e familjes janë obligim, d.m.th. detyrë e domosdoshme që kurrë në jetë nuk bënë të anashkalohet.

Allahu i Madhëruar, në Librin e Tij fisnik, thotë: “O ju që keni besuar! Ruani vetën dhe familjet tuaja nga zjarri...” (Tahrim, 6).

Po ashtu, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Çdonjëri nga ju është kujdestar dhe çdonjëri është përgjegjës për atë që është nën kujdesin e tij.”³

Edukata familjare përbëhet nga përbërës të shumtë, e disa nga ta janë: edukata fizike, morale, shpirtërore, estetike, mendore etj.. Edukata është një e pandashme, por për të ofruar kuptimin e këtij termi dhe obligimi madhor për lexuesin është ndarë në këtë formë.

Edukimi i brezave të rinj ishte pjesë e misionit të pejgamberëve të Zotit. Ata u munduan tërë jetën e tyre që ky amanet të vendoset në vendin e vet.

Ibrahimi a.s. ishte një nga pishtarët në këtë fushë. Kurani e përshkruan misionin e tij në

“Çdonjëri nga ju është kujdestar dhe çdonjëri është përgjegjës për atë që është nën kujdesin e tij.”

Muhamedi, a.s.

mënyrë të qartë, ku tha: “Kujto kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e Ai i tha: “Unë po të bej ty prijës të njerëzimit!” Ai tha: “Edhe nga pasardhësit e mi!” Zoti tha: “Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët.” (El Bekare, 124).

Shiko ambicien e Ibrahimit a.s. dhe lartësinë e saj! Ai u lut Zotit të Madhëruar dhe i kërkoi Atij të nxirrte nga bijtë e tij pasardhës që do t'i bindeshin dhe do ta adhuronin Zotin e Lartësuar. Ai nuk u kënaq me kaq; përkundrazi, ambicia e tij ishte të ishte një imam që do të pasohej në mirësi. Ai donte që adhurimi i tij të lidhej me adhurimin e fëmijëve dhe pasardhësve të tij. Kjo sjell shpërblim më të madh dhe një rezultat më të mirë. Sa e madhe ishte ambicia e tij!⁴

Jakubi a.s., edhe në agoninë e vdekjes, deshi të sigurohej se i la pasardhësit e tij njerëz që besuan Krijuesin e tyre, për arsye se kjo është ajo shtylla kryesore dhe mbrojtja më me vlerë që do t'i ruaj gjatë gjithë jetës,⁵ pra besimi në Një Zot.

Kur i hedhim një vështrim kaptinë Llukman, shohim se kjo kaptinë fillon nga besimi duke kaluar te vepra, duke i shoqëruar këto me një edukatë dhe etikë shumë të lartë. E tëra kjo është ajo mburoja ku i ruan fëmijët dhe gjeneratat e reja nga devijimi dhe humnera.

Po ashtu, shohim në të se sa bukur prindi i suksesshëm derdh mundin dhe djersën për ta përgatitur birin e tij që të jetojë me dinjitet, dhe t'i përballoj sfidat e kësaj bote, se si të jetë i qëndrueshëm dhe i paluhatshtëm në besimin dhe bindjen e tij, se çfarë duhet të veprojë, dhe si të veprojë, në mënyrë që të mos thyhet kurrë në jetën e tij.⁶

Brezat e shëndoshë rrjedhin nga familjet e edukuara mirë, mbarë dhe drejtë, për këtë duhet ta ruajmë familjen me tërë qenien tonë.

1 Shih: “Familja kjo çerdhe e sfiduar nga moderniteti”, Labinot Kunushevci, dhe “Edukata Familjare”, Islam Dizdari dhe Bahri Aliu.

2 Shih: www.alukah.net.

3 Buhariu, nr.7138.

4 Shih: www.alukah.net.

5 Shih: El Bekare, 133.

6 Shih: Llukman, 13-19.



Zhvillimet kulturore në Kosovë para viteve '90 dhe kontrolli i regjimit të Tiranës

Xhafer Sadiku

Vitet '60 të shekullit XX përbëjnë një kapitull të rëndësishëm në historinë kulturore dhe arsimore të Kosovës. Ato sollën një gjallërim të dukshëm të jetës intelektuale shqiptare, një zgjerim të botimeve në gjuhën shqipe dhe një ngritje të institucioneve të para shkencore, që më vonë do të shërbenin si themel për krijimin e Universitetit të Prishtinës.

Kjo periudhë shënoi gjithashtu fillimin e afrimit të botës akademike të Kosovës me atë të Shqipërisë. Për herë të parë, pas shumë dekadash ndarjeje, u krijuan ura të vërteta bashkëpunimi arsimor dhe shkencor ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës, që do të luanin një rol vendimtar në zhvillimin e arsimit të lartë shqiptar në hapësirat e ish-Jugosllavisë.

Në vitin 1967, një delegacion i Bashkësisë së shkollave të larta dhe fakulteteve të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Universitetin e Tiranës, duke shënuar nisjen e një etape të re në marrëdhëniet ndëruniversitare ndërshtepare. Vetëm një vit më vonë, më 1968, një grup punonjësish shkencorë nga Tirana morën pjesë në Simpoziumin e organizuar në Prishtinë me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Pikërisht gjatë këtyre kontakteve, u hodhën edhe hapat e parë për bashkëpunimin institucional, që u kurorëzua në vitin 1970 me nënshkrimin e marrëveshjes dhe protokollit të parë ndëruniversitar.

Që nga ajo kohë, protokollin ripërtërihej çdo vit, duke forcuar lidhjet arsimore dhe shkencore midis Prishtinës dhe Tiranës,¹ një proces që do të kishte ndikim të thellë në formimin e brezit të parë të intelektualëve të Kosovës.

ARRITJET SHKENCORE DHE KULTURORE TË KOSOVËS

Në gjysmën e dytë të viteve '60 të shekullit XX, intelektualët shqiptarë të Kosovës u shndërruan në bartës të një procesi të thellë vetëdijesimi kombëtar dhe kulturor. Në një periudhë të ndërlikuar politike, ata artikulluan me guxim tezën se shqiptarët e Kosovës janë pjesë e pandarë e kombit shqiptar - një popull me një histori, një kulturë dhe një gjuhë të përbashkët.



Në vitin 1967, një delegacion i Bashkësisë së shkollave të larta dhe fakulteteve të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Universitetin e Tiranës, duke shënuar nisjen e një etape të re në marrëdhëniet ndëruniversitare ndërshtepare.

Kjo ide u bë boshti i vizionit të tyre shkencor dhe kombëtar, dhe i shtyu ata të trajtonin jo vetëm çështje lokale, por edhe problemet e përgjithshme të shkencës dhe kulturës shqiptare.

Në këtë frymë, në Prishtinë u zhvilluan studime të rëndësishme për historinë e Shqipërisë, për gjuhën letrare shqipe dhe për letërsinë. Në Tiranë, pushteti politik kishte vënë censurë të ashpër mbi letërsinë shqipe dhe zbatohej vetëm rryma e realizmit socialist, ndryshe ndodhte në Prishtinë. Atje nuk kishte një censurë të tillë përkundrazi, botoheshin edhe ajo pjesë e shkrimtarëve shqiptarë të traditës, që në Tiranë ishin ndaluar.

Krahas punës studimore, institucionet kosovare ndërmorën nisma të rëndësishme botuese: u ribotuan vepra shkencore dhe letrare nga autorë të Tiranës, shpesh me cilësi teknike më të lartë, duke e kthyer Prishtinën në një qendër të gjallë të përhapjes së kulturës shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Një tjetër dimension i rëndësishëm ishte hapja e institucioneve shkencore të Kosovës ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar. Në revistat e Prishtinës filluan të botonin albanologë nga Gjermania, Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, ndërsa në simpoziume dhe sesione shkencore ftoheshin studiues të huaj për t'u njohur e specializuar në fushën e studimeve shqiptare. Po kështu, ekupe kërkimore kosovare udhëtonin në arkiva dhe biblioteka evropiane, duke arritur rezultate të çmuara në kërkimet historike dhe gjuhësore.

Në këtë kontekst, Instituti Albanologjik i Prishtinës, u bë institucioni më përfaqësues i kësaj lëvizjeje. Ai vepronte tashmë me vetëdijen e një autoriteti qendror për problemet shqiptare, duke ftuar edhe studiues nga Tirana - veçanërisht në fushën e folklorit dhe etnografisë - me synimin për të botuar revistën *"Folklori dhe etnografia shqiptare"*. Në të njëjtën kohë, u vendosën ura bashkëpunimi me qendra të tjera albanologjike jashtë vendit, si ajo e Palermos, e drejtuar nga Zef Valentini dhe ajo e Mynihut.

Falë kësaj veprimtarie të gjerë, Prishtina nisi të afirmohej si një qendër e barabartë me Tiranën në fushën e kërkimeve shkencore dhe kulturore. Ky zhvillim nuk ishte vetëm një akt shkencor, por edhe një proces identitar me domethënie të thellë politike: ai tregoi se kultura mund të shërbejë si mjet i fuqishëm për ruajtjen e identitetit dhe afirmimin e një populli në rrethana historike të vështira.

Në Tiranë,
pushteti
politik kishte
vënë censurë
të ashpër mbi
letërsinë
shqipe dhe
zbatohej
vetëm rryma e
realizmit
socialist,
ndryshe
ndodhte në
Prishtinë.

Intelektualët dhe studiuesit kosovarë të asaj kohe, përmes punës së tyre të palodhur në fushën e albanologjisë, vendosën themelet e një tradite të re të mendimit shkencor shqiptar, duke e bërë Prishtinën një pol të rëndësishëm të kulturës kombëtare. Megjithatë, arritjet e tyre ngjallën jo rrallë edhe ndjenja xhelozie dhe mosmiratimi në qarqe të caktuara akademike në Tiranë, ku rivaliteti institucional dhe politik shpesh zbehte frymën e bashkëpunimit gjithëkombëtar.

PËRPIEKJET E INSTITUCIONEVE TË TIRANËS PËR MONOPOLIN MBI KULTURËN DHE STUDIMET ALBANOLOGJIKE

Ndryshe nga studiuesit në Prishtinë, që gëzonin një liri akademike më të gjerë dhe kushte më të favorshme pune, ata të Tiranës ndodheshin nën trysinë e izolimit ideologjik dhe të kontrollit të hekurt të Partisë së Punës. Lufta e klasave dhe "vija e masave" i kishin shndërruar institucionet kulturore dhe shkencore në instrumente të partisë, duke i kufizuar mundësitë për zhvillim të lirë të mendimit shkencor.

Në këto rrethana, shumë studiues të Tiranës mbetën pas në zhvillimet bashkëkohore të kulturës dhe shkencës shqiptare. Kriteret ideologjike të vendosura nga partia për krijimtarinë shkencore dhe artistike i pengonin të përqafonin një qasje moderne dhe i detyronin t'u përmbaheshin formulimeve të ngurta marksiste-leniniste.

Për ta ruajtur monopolin mbi studimet albanologjike dhe kulturën kombëtare, disa prej tyre iu drejtuan udhëheqjes së lartë komuniste - madje vetë sekretarit të Komitetit Qendror, Ramiz Alisë, i cili mbulonte fushën e arsimit dhe kulturës. Në raportet e tyre, drejtuesit e institucioneve të Tiranës i ndanin intelektualët e Kosovës në dy kategori: ata që kishin simpati për regjimin e Tiranës dhe që regjimi i konsideronte "forca patriotike e përparimtare", dhe ata që shikoheshin me rezervë dhe duheshin mbajtur nën vëzhgim. Për këtë qëllim, gjatë vizitave të ndërsjella të studiuesve, grupeve kulturore dhe sportive, regjimi i Tiranës aktivizonte informatorë për të kontrolluar idetë dhe veprimtarinë e krijuesve të Prishtinës. Raportet për qëndrimet e tyre, sidomos në vitet '70, janë të shumta.

Në atë kohë, lidhjet ndërmjet institucioneve shkencore të dy anëve ishin tepër të dobëta. Shkëmbimet kufizoheshin në dërgimin e disa botimeve nga Biblioteka Shkencore e Universitetit Shtetëror të Tiranës drejt bibliotekave të

Prishtinës dhe disa studiuesve të atjeshëm. Për shkak të mungesës së kontakteve të drejtpërdrejta, Tirana nuk ishte në gjendje të ndiqte rregullisht zhvillimin e jetës shkencore dhe kulturore në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Veprimtaria shkencore e Prishtinës njihej pjesërisht dhe me shumë vonesë.

Deri në vitin 1969, në Tiranë mbahej heshtje e plotë ndaj prodhimit letrar dhe shkencor të Kosovës. Punimet e studiuesve kosovarë nuk përmendeshin, nuk citoreshin dhe as nuk vlerësoheshin publikisht.² Ky qëndrim ngjalli pakënaqësi të hapur mes studiuesve të Kosovës, të cilët, ndonëse e respektonin mendimin e institucioneve të Tiranës, e ndienin heshtjen e tyre si një formë mospërfilljeje.

Në institucionet shkencore të Tiranës u krijua bindja se kjo situatë duhej ndryshuar përmes një pune më aktive dhe të organizuar, që synonte të ushtronte ndikim të drejtpërdrejtë mbi studiuesit e Kosovës. Sipas dokumenteve të kohës, institucionet shkencore të Tiranës duhej të angazhoheshin për:

- forcimin e frymës dhe përmbajtjes ideologjike të lëvizjes kulturore-shkencore të shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut;

Në vitet '70, elita kulturore dhe shkencore e Tiranës e rriti presionin duke synuar të ushtronte ndikim mbi jetën akademike dhe kulturore të Kosovës.

- mbështetjen e “rrymave përparimtare” dhe pengimin e zhvillimit të pavarur të jetës kulturore kosovare;

- formimin e studiuesve të rinj nën ndikimin e Tiranës, për t'i mbajtur larg “ndikimeve imperialiste”, që vinin nga Gjermania Perëndimore, Italia apo Shtetet e Bashkuara.

Në këtë kuadër, u propozuan një sërë masash për forcimin e marrëdhënieve ndër-institucionale dhe për përzgjedhjen e kujdesshme të studiuesve me të cilët Tirana do të bashkëpunonte. Synimi i fshehtë ishte i qartë: të kontrollohej zhvillimi i mendimit shkencor shqiptar në Kosovë dhe të shmangej çdo tendencë e pavarësimit kulturor.

KONTROLLI I STUDIUESVE KOSOVARË

Në vitet '70, elita kulturore dhe shkencore e Tiranës e rriti presionin duke synuar të ushtronte ndikim mbi jetën akademike dhe kulturore të Kosovës. Në pamje të parë, iniciativat dukeshin se synonin bashkëpunim dhe shkëmbim shkencor, por në thelb kishin një qëllim të qartë politik: kontrollin ideologjik dhe orientimin e zhvillimeve kulturore sipas parimeve të realizmit socialist dhe udhëzimeve të Partisë së Punës së Shqipërisë. Për këtë arsye, Tirana hartoi një sërë masash që do të zbatoheshin menjëherë dhe në plan afatgjatë.

a) Masat e menjëhershme

- *Shpërndarja e botimeve:* Institucionet shkencore të Tiranës dërgonin botime të ndryshme në qendrat akademike, shkollat e larta pedagogjike dhe te studiues të veçantë të Kosovës, të cilët regjimi i konsideronte “patriotë” dhe “përparimtarë”.

- *Recensione dhe promovim ideologjik:* Revistat shkencore të Tiranës publikuan recensione sistematike për punimet dhe botimet e studiuesve kosovarë, duke i inkurajuar forcat që i konsideronin pozitive dhe duke ushtruar ndikim mbi drejtimin e kërkimeve.

- *Dërgimi i artikujve për botim:* Artikuj të Tiranës përfundonin në revistën “Gjurmime albanologjike” të Prishtinës, me përmbajtje që synonte të ndikonte në pikëpamjet e studiuesve lokalë.



· *Korrespondencë e udhëhequr*: Disa studiuës kosovarë, të konsideruar të besueshëm nga Tirana, ngarkoheshin për të dërguar informacione mbi kërkimet shkencore në Kosovë.

· *Pjesëmarrje në diskutimet gjuhësore*: Studiuës të Kosovës inkurajoheshin të merrnin pjesë në diskutimet për “Rregullat e drejtshkrimit”, për “Historinë e Shqipërisë” (vëll. I-II) dhe për tekstin “Dialektologjia shqiptare”, duke u orientuar drejt pikëpamjeve të aprovuara nga Tirana.

· *Ftesa për pushime verore*: 2-3 studiuës kosovarë ftoheshin çdo vit për pushime verore njëmujore në Shqipëri, si formë afrimi dhe seleksionimi ideologjik.

· *Shkëmbim leksionesh*: Studiuës kosovarë ligjëronin mbi të folmen, folklorin dhe etnografinë e Kosovës, ndërsa pedagogë nga Tirana lexonin cikle leksionesh mbi gjuhën, letërsinë, historinë dhe arkeologjinë.

· *Dërgimi i materialeve shkencore*: Bibliotekave dhe institucioneve shkencore të Kosovës u dërgoheshin sasi të mëdha koleksionesh revistash dhe materialesh propagandistike.

b) Masat afatgjata

· *Ekspedita shkencore*: Tirana organizonte ekspedita dialektologjike, leksikologjike, folklorike dhe etnografike, duke ftuar studiuës kosovarë për të marrë pjesë. Megjithatë, ekspeditat udhëhiqeshin nga Tirana dhe nuk bazoheshin në paritet të përbashkët.

· *Materiale arkeologjike*: Muzeumeve dhe instituteve të Kosovës u dërgoheshin kopje të objekteve arkeologjike, sidomos nga kultura ilire dhe periudha e hershme shqiptare, për të afirmuar narrativën historike të aprovuara nga Tirana.

· *Botimi i veprave të studiuësve kosovarë*: Përpjekje bëheshin për të botuar libra dhe punime të veçanta të studiuësve të Kosovës, duke i integruar ato në kuadrin ideologjik të vendosur nga kryeqyteti.

· Në një shkallë më të kufizuar, këto masa shtriheshin edhe mbi studiuës shqiptarë në Maqedoni, kryesisht për të forcuar këmbimin e botimeve dhe jo për kontroll ideologjik të drejtpërdrejtë.³

CENSURA IDEOLOGJIKE MBI LETËRSINË KOSOVARE

Një nga sfidat më të mëdha të asaj kohe ishte vlerësimi i letërsisë artistike kosovare, e cila, për arsye ideologjike, përjashtohej nga historia e letërsisë shqipe dhe nga antologjitë që studioheshin në shkollat e Shqipërisë. Arsyeja ishte e thjeshtë, por e padrejtë: letërsia e Kosovës nuk “përputhej”

Veprat e studiuësve dhe krijuesve të Kosovës, pavarësisht kufizimeve nga Tirana, mbeten një faqe e ndritur e historisë kulturore shqiptare.

me modelin e realizmit socialist, që kërkonte vepra me frymë politike, heronj të punës dhe partinë në qendër të çdo rrëfimi. Në të vërtetë, krijimtaria e autorëve kosovarë kishte një tjetër frymë - më të lirë, më njerëzore, më afër realitetit dhe dhimbjes së popullit që kërkonte të ruante gjuhën e identitetin. Shkrimtarë si Esad Mekuli, Din Mehmeti, Rexhep Qosja, Ali Podrimja, Azem Shkreli e të tjerë, sillnin një zë të ri, më modern dhe më të guximshëm, por që për kritikën zyrtare të Tiranës cilësohej si “nacionalist” apo “i huaj për artin proletar”. Kështu, për dekada të tëra, kjo letërsi e pasur u mbajt larg lexuesit shqiptar.

Në të njëjtën kohë, regjimi i Tiranës hartoi një sërë programesh propagandistike të posaçme për Kosovën dhe për viset e tjera shqiptare, të transmetuara në televizionin e vetëm shtetëror dhe në radion qendrore dhe në ato lokale. Përmes tyre përhapej ideologjia e Partisë së Punës, e cila kërkonte të paraqiste veten si mbrojtëse të interesave kombëtare dhe si zëri udhëheqës i të gjithë shqiptarëve. Por në thelb, gjithçka ishte e politizuar: historia

interpretohej sipas vijës së partisë, arti dhe letërsia shërbenin si mjete propagande, ndërsa censura ndaj shkrimtarëve të Kosovës bëhej gjithnjë e më e fortë. Përkundrazi, mbështeteshin dhe promovoheshin autorët e realizmit socialist nga Tirana, veprat e të cilëve përforconin mesazhin ideologjik të kohës. Në vend të një bashkëpunimi të natyrshëm kulturor mes dy anëve të kombit, u ngrit një mur heshtjeje dhe ndarjeje, ku letërsia shndërrohej në instrument të propagandës dhe humbi për një kohë të gjatë kuptimin e saj më të bukur - lirinë për të thënë të vërtetën.⁴

Veprat e studiuësve dhe krijuesve të Kosovës, pavarësisht kufizimeve nga Tirana, mbeten një faqe e ndritur e historisë kulturore shqiptare. Ata dëshmuar se edhe në kushte të kufizuara, dija dhe përkushtimi mund të jenë forca që i japin një kombi dinjitet, vetëdije dhe vazhdimësi.

Referenca:

1. AQSH, fondi 14APPK KOSOVA, viti 1981, dosja 38.
2. AMPB (AIDSSH), fondi ORV Nr. 125; “Mbi disa çfaqje në radhët e shkrimtarëve dhe artistëve”.
3. AQSH, fondi 14APPK KOSOVA, viti 1969, dosja 1, f. 1-10. Përkujtesë në lidhje me gjallërimin e veprimtarisë shkencore-kulturale në Kosovë dhe me qëndrimin tonë ndaj saj.
4. AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1968, dosja 271, f. 7-16. Mbi disa çështje të kohëve të fundit me shkrimtarët dhe artistët.

Alfabeti “Bashkimi” dhe Kongresi i Manastirit

Dr. Azmir Jusufi

Duke marrë parasysh faktin se Perandoria Osmane ua ndalonte shqiptarëve të shkruanin dhe të shkolloheshin në gjuhën e tyre amtare,¹ kjo nevojë ngjalli ndërgjegjësim dhe përkushtim serioz të të gjitha forcave intelektuale, patriotike, shkencore dhe filologjike, me qëllim që të arrihej formimi i alfabetit shqip dhe botimi i librave dhe arsimimi i popullit, me arsytimin e vetëm, atë të arritjes së përparimit dhe zhvillimit shoqëror.

Për këtë arsye, shoqëria “Bashkimi” u themelua në vitin 1899, duke mbledhur rreth vetes emrat e intelektualëve, patriotëve të famshëm, si: Preng Doçi, Gjergj Fishta, Pashko Bardhi, Dodë Koleci, Ndoc Nikaj etj.²

Kjo shoqëri krijoi një alfabet të bazuar në qëllimin për “t’i bërë shkronjat shqipe latine”³ dhe “përmbushjen e nevojave tona”.⁴ Ky alfabet u quajt alfabeti “Bashkimi”, duke marrë emrin e vetë shoqërisë.

Në atë periudhë, preferohej më shumë të mbështetej në alfabetin latin, kështu që edhe shoqëria “Bashkimi” mbështetej në këtë alfabet, duke pasur si parim që një tingull - një fonemë mund të paraqitet me dy shkronja. Përveç shkronjave të thjeshta, ky alfabet kishte edhe nëntë shkronja të dyfishta, shtatë prej të cilave formoheshin me *h*-në të faringut. Gjithashtu, kishte dy shkronja të dyfishta: *ll* dhe *rr*.⁵

Shoqëria “Bashkimi” u themelua në vitin 1899, duke mbledhur rreth vetes emrat e intelektualëve, patriotëve të famshëm, si: Preng Doçi, Gjergj Fishta, Pashko Bardhi, Dodë Koleci, Ndoc Nikaj etj.



Foto: Shoqëria “Bashkimi”, 1899.

Shoqëria “Bashkimi” dhe alfabeti i saj patën një jehonë, të mbështetur nga shumë organe dhe shkrimtarë që i dëgjonin. Pati mbështetje të veçantë nga Faik Konica dhe organi që ai drejtonte. Revista “Albania” shumë shpejt gjeti një gjuhë të përbashkët në sistemin e shkrimit të kësaj shoqërie, duke respektuar të dy alfabetet. Dhe kjo u arrit në fund të vitit 1904.⁶

Tekstet shkollore dhe revistat në veri të Shqipërisë, me seli në Shkodër, në fund të shekullit XIX, botoheshin në tri alfabete: alfabetin e vjetër (të Jezuitëve), në atë të shoqërisë “Bashkimi” (1899)⁷ nga Preng Doçi dhe në atë të shoqërisë “Agimi” (1901) nga Ndre Mjeda, prandaj u ndje e nevojshme të përshpejtohej sa më shpejt unifikimi i alfabetit.

Shoqëria “Bashkimi”, duke pasur mbështetësit e saj, u njoh si një shoqëri me vlera dhe për këtë arsye u ftua në Kongresin e Manastirit, ku Gjergj Fishta dhe Luigj Gurakuqi u dërguan si delegatë. Gjergj Fishta luajti një rol të veçantë dhe arriti të zgjidhet kryetar i Komisionit për krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Delegatët ia besuan një detyrë të tillë për shkak të erudicionit të tij të thellë, kulturës së gjerë, fuqisë së fjalës, mendjes së mprehtë dhe logjikës së fortë.⁸

Kongresi në Manastir filloi më 14 nëntor 1908 dhe vazhdoi deri më 22 nëntor të po atij viti.⁹ Kongresi u mbajt nga shoqëria “Bashkimi” në shtëpinë e Fehim Zavalanit, ku ndodhej edhe selia e shoqërisë.

Në këtë Kongres morën pjesë gjithsej 40 delegatë. 32 prej tyre kishin të drejtë vote, ndërsa 18 të tjerë jo. Ata përfaqësonin rryma dhe lëvizje të ndryshme të çështjes shqiptare.¹⁰

Në këtë Kongres morën pjesë shqiptarë të të gjitha bashkësive fetare: *myslimanë, katolikë, ortodoksë, protestantë...* njerëz të ditur, të bashkuar për një kauzë të madhe kombëtare. Kishte delegatë nga qytetet e Shqipërisë, të cilët përbënin shumicën, por kishte edhe nga ata që vinin nga larg, nga ShBA-të dhe vende të tjera, ku bashkësitë shqiptare ishin të organizuara në klube dhe shoqata të ndryshme patriotike.¹¹

Mit’hat Frashëri u zgjodh kryetar i Kongresit në Manastir, ndërsa Gjergj Fishta u zgjodh kryetar i Komisionit të Alfabetit, Luigj Gurakuqi u zgjodh sekretar.¹² Anëtarë të tjerë ishin: Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Sotir Peci, Gjergj Qiriaz, Shahin Kolonja etj..

Patriotët dhe intelektualët shqiptarë në atë kohë dhanë zgjidhjen më të madhe të mundshme për gjuhën. Në atë



Foto: Kongresi në Manastir, 14 nëntor 1908.

takim u diskutuan tri alfabete, alfabeti i Stambollit, alfabeti i shoqërisë “Agimi” dhe alfabeti i shoqërisë “Bashkimi”.

Kongresi në Manastir dështoi të miratonte përdorimin e një alfabeti të vetëm. Në këtë kuptim, ai nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen e alfabetit.¹³ Por koha e zgjidhi atë, sepse, alfabeti grek gradualisht u shfuqizua dhe u përdor vetëm alfabeti latin.

Brenda pak vitesh, alfabeti i shoqërisë letrare “Bashkimi” nga Shkodra, i miratuar nga Kongresi në Manastir, u bë shpejt i vetmi alfabet i gjuhës shqipe. Njësimi i alfabetit ishte një hap i rëndësishëm për njësimin e *drejtshkrimit* dhe të *gjuhës letrare shqipe*.

Alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” përbëhej nga 36 shkronja: A a, B b, Ts ts, Ch ch, D d, Dh dh, É é, E e, F f, G g, Gh gh, H h, I i, J j, K k, L l, Ll ll, M m, N n, Gn gn, O o, P p, C c, R r, Rr rr, S s, Sh sh, T t, Th th, U u, V v, Z z, Zh zh, Y y, X x i Xh xh.

1 Mimoza Priku, “Fjalësi diturak në fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”, në: *Fjalori i shoqërisë “Bashkimi” në 100-vjetorin e themelimit të tij*, (Shkodër: 2011) 60.

2 Po aty, 62.

3 Justin Rrota, *Për historinë e alfabetit shqyp*, (Shkodër: 2005), 81.

4 Dom N. Nikaj, *Kujtime të një jetës së kalueme*, (Tiranë: 2003), 174.

5 Tomor Osmani, „Shoqëria “Bashkimi” në 100 - vjetorin e saj“, *Phoenix*, 3(5-6), (Shkodër: 2023), 454.

6 Justin Rrota, *op. cit.*, 80.

7 Fadil Raka, *100 Vjet të Kongresit të Manastirit*, (Prishtinë: 2008), 89.

8 Tomor Osmani, „Shoqëria “Bashkimi” në 100 - vjetorin e saj“, *Phoenix*, 3(5-6), (Shkodër: 2023), 455.

9 Fadil Raka, *op. cit.*, 200.

10 Po aty, 201.

11 Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, (Tiranë: 1987), 93.

12 Ibrahim Hoxha, *Nëpër udhën e shkronjave shqipe*, (Tiranë: 1984), 201.

13 Tomor Osmani, „Kongresi i Manastirit – një krenari e ligjshme e kulturës sonë kombëtare“, shkarkuar nga ueb-faqja: <https://kohajone.com/kultura/kongresi-i-manastirit-nje-krenari-e-ligjshme-e-kultures-sonë-kombëtare/>.

Drama shqiptare “Besa” e Shemsedin Sami bej Frashërit

George W. Gawrych

Në 1847, Shemsedin Sami bej Frashëri (1850-1904), një intelektual i shquar shqiptar, shkroi dramën “Besa jahud Ahde Vefa”. Në hyrjen e saj, Shemsedin Samiu deklaroi qartë arsyet për shkrimin e dramës. Fjala e tij e shkruar hapi një kapitull të ri në teatrin otoman për shqiptarët. Ashtu siç thoshte Shemsedin Samiu: *“Për një kohë të gjatë, kam ëndërruar që të shkruaj një pjesë letrare me qëllim që të përshkruaj disa zakone dhe morale të popullit shqiptar, jo për shkak se jam një prej pjesëtarëve të tij, por për shkak se kam qenë dëshmitar i cilësive patriotike, të cilat ndoshta janë të përshtatshme për skenë, të tilla si: dashuria për vatanin, sakrifica, besnikëria ndaj betimit, dhe përfillja e paktë për jetën.”*¹

Shemsedin Samiu synonte që nëpërmjet dramës së tij t'i jepte publikut një vlerësim të “moraleve dhe zakoneve të shqiptarëve që përbëjnë një pjesë integrale të kombit të madh islamik dhe që janë pjesëtarë të shtetit otoman.”²

Përveç kësaj, autori dëshironte të nxiste zhvillimin e vetëdijes kombëtare shqiptare në periudhën e rritjes së ndjenjave nacionaliste në Ballkan.


Besa është një fjalë shqipe që do të thotë “fjala e nderit”. Subjekti i dramës është si vijon: Zubejri, një malësor fisnik dhe krenar, dhe gruaja e tij Vahide kishin një vajzë të quajtur Merushe, që kishte rënë në dashuri me Rexhepin, kushëririn e saj të parë. Pas zbulimit të dashurisë së ndërsjellë të “dy fëmijëve” të tij, Zubejri pranoi t'i martojë.

Megjithatë, një kthesë tragjike e ngjarjeve i ndodhi çiftit në ditën e tyre të martesës kur Selfo, një shqiptar që jetonte në fshatin fqinjë të Borshit dhe që gjithashtu e dashuronte Merushen, e rrëmbeu vajzën. Në vazhdim, Selfo e vrau Zubejrin, kur babai i saj u përpoq ta ndalonte fizikisht atë gjatë veprimit të tij të pandërgjegjshëm. Por megjithatë, përpara vdekjes së tij, Zubejri arriti ta urdhërojë Vahiden, gruan e tij, që ta shpëtojë Merushen dhe që të hakmerrej ndaj vrasësit të tij, duke i kujtuar asaj se nderi i familjes ishte në rrezik.

Ndërsa ishte nisur për ta realizuar premtimin e saj, Vahidja shpëtoi jetën e një njeriu të panjohur. Ky person – Fetah Aga – qëllloi të jetë babai i Selfos, i cili ishte duke u kthyer në

“Për një kohë të gjatë, kam ëndërruar që të shkruaj një pjesë letrare me qëllim që të përshkruaj disa zakone dhe morale të popullit shqiptar, jo për shkak se jam një prej pjesëtarëve të tij, por për shkak se kam qenë dëshmitar i cilësive patriotike, të cilat ndoshta janë të përshtatshme për skenë”

Shemsedin Samiu



shtëpi, pasi kishte shërbyer në ushtrinë otomane për njëzet vjet. Pa përmendur ndonjë emër, Vahidja ia zbraz pikëllimin e saj Fetahut, i cili menjëherë i dha besën për ta ndihmuar Merushen që t'ia marrë hakun vrasësit të Zubejrit, pa e ditur se kjo nënkuptonte vrasjen e djalit të vetë atij. Më pas, pasi zbuloi pasojën e plotë të premtimit të tij, ndonëse ndjenja prindërore arsyetonte kundër zotimit, Fetahu arriti në përfundimin se ai nuk kishte alternativë tjetër përveçse të sakrifikonte djalë të tij Selfon.

Më pas tragjedia hyri në një dimension tjetër. Fetah Aga, vrasësi i djalit të vet, ia mori jetën vetes si hakmarrje për vdekjen e Selfos. Përpara se të thoshte fjalët e tij të fundit, Fetahu arriti t'i kërkonte nënës së tij, e cila arriti në momentin e duhur në skenën e përgjakur, që ta pranonte Vahiden si motrën e vet, dhe Rexhepin dhe Merushen si fëmijët e saj. Drama përfundoi me këtë pajtim prekës të dy familjeve, sepse drejtësia ishte zbatuar plotësisht sipas traditës shqiptare.³

Shemsedin Samiu e paraqiti besën si një institucion përfaqësues të vlerave dhe moraleve ideale shqiptare.

Shemsedin Samiu e paraqiti besën si një institucion përfaqësues të vlerave dhe moraleve ideale shqiptare.

Në dramën e tij, Shemsedin Samiu diskuton, me një gjuhë shumë emotive, për vatanin apo atdheun si një koncept patriotik. Tradicionalisht, “vatan-i” nënkupton vendlindjen e dikujt, një vend të lokalizuar të tillë si qytet apo fshat. Por, në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, fjala fitoi kuptimin e atdheut, ashtu siç dëshmohet nga mendimet dhe ndjenjat e Fetah Agës në lidhje me temën.

Njëzet vjet! Sa kohë e gjatë! Është [pothuaj] një jetë! Oh! Atdhe, atdhe i shtrenjtë ... Sa herë e kam parë atdheun në ëndrrat e mia ... Tani, më në fund, jam në atdheun tim. Nga ky moment, unë nuk do ta lë atdheun tim. Sa situatë e çuditshme është kur një njeri e lë vendin ku ai u lind dhe ngrihet e shkon në një vend tjetër, në një vend shumë të largët. Por zemra nuk mund ta lerë – ajo nuk ka mundësi. Zemra e njeriut është gjithmonë e lidhur me atdheun e tij. Unë këto njëzet vjet i kalova jashtë atdheut tim.... Njeriu ka një lloj tjetër dashurie për vendin ku ka lindur dhe është rritur dhe për ato vende ku ai ka kaluar fëmijërinë dhe adoleshencën e tij!... Mbi horizontin e atdheut ekziston një bukuri tjetër. Sa herë që njeriu sheh një pjesëz shumë të vogël toke të atdheut, një ngjarje e fëmijërisë së tij i



*vjen në mendje! Kujtimi e atyre ditëve të bukura të rinisë së tij krijon një ndjenjë të gëzuar në zemrën e tij.*⁴

Shemsedin Samiu, si një shqiptar i vetëdijshëm për etnicitetin e tij, u fokusua mbi besën, një institucion shekullor, dhe e paraqiti vatanin e tij të veçantë si vendin territorial të kulturës, të vlerave dhe të besnikërisë shqiptare. Ai u fokusua në vatanin që lidhej me një kavim të veçantë, që në këtë rast ishte populli shqiptar, me cilësitë dhe tiparet e tyre të të qenët shqiptarë. Sipas pikëpamjes së tij, uniteti otoman, sado i madhërishtëm dhe i shenjtë, duhej të lejonte lulëzimin e pluralizmit kulturor brenda komunitet mysliman. Në fund të fundit, drama e tij, synonte të fuqizonte vlerësimin e diversitetit etnik brenda perandorisë.

“*Besa jahud Ahde Vefa*” u la otomanëve përshtypjen e një populli paksa fanatik, pasi mënyra e vdekjes së Selfos dhe Fetahut atyre mund t’u jetë dukur ekstreme. Ashtu siç vuri në dukje një studiues kohët e fundit: “Nëpërmjet sugjestionit të përgjithshëm të dramës S. Frashëri e konfirmon mitin e besës si një normë të ngulitur mbarëkombëtare, së cilës njeriu duhet t’i bindet pavarësisht prej rrethanave.”⁵ Mary Edith Durham, e cila udhëtoi në mënyrë ekstensive midis fiseve veriore në fillim të shekullit të njëzetë, shënonte historinë e një njeriu që kishte vlarë vëllain e tij për shkak të obligimit të besës së tij.⁶ Kryerja e vrasjes për shkak të nderit personal i shtrinte kufijtë normalë të devocionit ekstrem drejt idealeve. Por, Islami e ndalon çdo formë të vetëvrasjes. Megjithatë, veprimet e Fetahut thjesht theksojnë rëndësinë e nderit dhe të besnikërisë ndaj fjalës së dhënë që vlente në shoqërinë shqiptare.

AUTORI

Jeta dhe vepra e Shemsedin Samiut reflektuan, në shumë pikëpamje, kompleksitetet e shoqërisë otomane.⁷ Shemsedin Sami Beu lindi më 1 qershor të vitit 1850 në Frashër, që ndodhet në kaza-në (distriktin) e Përmetit si pjesë e sanxhakut (vendit) të Ergiri-t (Gjirokastrës) në vilajet-in (provincën) e Janja-s (Ioannina/Janina). Ai rridhte nga një familje e shquar myslimane shqiptare me rrënjë të forta bektashiane. Babai i tij, Halit Beu, pohonte një prejardhje të largët nga pronarët e timar-it, nga zona e Beratit, përpara vendosjes në Frashër. Rrënjët familjare të nënës së tij, Emine Hanëmit, shkonin deri te Imrahori Iljas Efendiu, një komandant i famshëm otoman gjatë sundimit të Muratit të II-të (1444-1446).

Jeta dhe vepra
e Shemsedin
Samiut
reflektuan, në
shumë
pikëpamje,
kompleksitetet
e shoqërisë
otomane.

51-1446) dhe Mehmedit të II-të (1444-1446). Kështu familja rridhte nga një prejardhje e privilegjuar e zyrtarëve shtetërorë, ndonëse nga mesi i shekullit nëntëmbëdhjetë, familja u shfaq të ishte me mjete modeste financiare.

Në volumnin e gjashtë të enciklopedisë së tij të botuar vite më vonë, Shemsedin Sami Beu i kushtoi gjysmë faqe Frashërit, qytetit të tij të lindjes, duke iu referuar atij “si një fshat i madh apo një qytet i vogël” me 1.500 banorë. Myslimanët përbënin shumicën e popullsisë, dhe të krishterët përfshinin edhe shqiptarët edhe vllahët. Frashëri kishte një shkollë të veçantë rume (greke) dhe vllahe, tri xhami, një kishë, një teqe bektashiane dhe një teqe saadiane dhe një treg që përbëhej prej njëzet dyqanesh. Në kulmin e tyre, bejlerët e vendit (pronarët e tokave) jetonin kulturën e lartë perandorake dhe mësonin persishten dhe arabishten nga mësuesit privatë. Me shfaqjen e Ali Pashë Tepelenës (1740-1822), një udhëheqës ushtarak vendas në Shqipërinë Jugore në fund të shekullit, Frashëri përjetoi ca trazira ekonomike, dhe një numër bejlerësh u shpërngulën në rajone të tjera për punësim, ndonëse sipas Shemsedin Samiut: “Frashëri (megjithatë) e ruajti nivelin e tij të civilizimit.”⁸

Në fakt, ai ishte vendi ku autori filloi arsimimin e tij me mësues privatë.

Shemsedin Sami i filloi studimet në teqenë vendase bektashiane. Në atë kohë, familja e tij u godit dy herë nga fatkeqësia. Në moshën nëntë vjeçare, në vitin 1859 atij i vdiq babai, dhe nëna e tij vdiq dy vjet më vonë në vitin 1861. Pas vdekjes së nënës, Abdul Bej Frashëri (1839-92), fëmija më i madh, mori përgjegjësinë për familjen dhe e shpërnguli secilin (anëtar të familjes) në kryeqytetin provincial të Janinës. Atje Shemsedinin dhe vëllai i tij më i madh Naimi (1846-1900) u regjistruan në gjimnazin e famshëm grek (shkollë e mesme) Zosimea (Zossimaia), ku të dy vëllezërit morën një arsim modern dhe klasik. Shemsedin Sami studioi greqishten e vjetër dhe moderne, latinishten, frëngjishten dhe italishten. Njëkohësisht, ai mori edhe leksione të persishtes dhe arabishtes nga mësues në një shkollë myslimane lokale. Si një student i shkëlqyer, ai diplomoi brenda shtatë vjetëve (1871), atë që atëherë ishte një program tetëvjeçar. Mësuesit privatë dhe Zosimea, së bashku, e pajisën Shemsedin Samiun me një arsim relativisht të gjerë, në një ambient divers nga pikëpamja religjioze, etnike dhe kulturore. Ai siguroi, përveç kësaj, mjete linguistike që e

lejuan atë të lëvizë intelektualisht dhe emocionalisht nëpër kultura të ndryshme.


Rreth vitit 1872, Shemsedin Samiu u vendos me vëllain e tij, Naimin, në Stamboll, ku të dy u punësuan në burokraci. Ai shpejt u përfshi në përkthimin e romaneve nga frëngjishtja në gjuhën otomane dhe në shkrimin e romaneve dhe tregimeve të shkurtra të vetë atij. Pas një udhëtimi të shkurtër në Tripoli, në Libi, në vitin 1874, Shemsedin Samiu u kthye në Stamboll dhe filloi punën si shkrimtar në një gazetë. Pas një emërimi tjetër të shkurtër, këtë herë në ishullin e Rodit, Shemsedin Samiu u kthye në Stamboll ku ai mbeti deri në fund të jetës së tij. Karriera e tij intelektuale tani lulëzoi në mënyrë të shpejtë.

Me një edukim solid, si themel, të kombinuar me një intelekt të mprehtë dhe kureshtar, Shemsedin Samiu, u shndërrua në një intelektual otomano-shqiptar të dorës së parë. Gjatë gjithë jetës së tij, ai u ndie i afërt me letërsinë dhe kulturën frënge dhe përktheu një numër librash nga frëngjishtja në gjuhën otomane, duke përfshirë edhe Les Misérables. Gjithashtu, Shemsedin Samiu ishte autor i një numri romanesh dhe dramash të vetë atij, që e ndihmuan atë të gjejë (punë) dhe të shërbejë si kryeredaktor i disa gazetave dhe revistave, si edhe të publikojë disa libra, të tillë si: Gratë (Kadinlar), Qytetërimi Islamik (Medenijet-i Islamiye) dhe Njeriu (Insan). Ai gjithashtu kompiloi një fjalor frëngjisht-turqisht (1882) dhe një fjalor turqisht-frëngjisht (1884), një fjalor arabisht (1898), një enciklopedi me gjashtë vëllime Kamus el A'lam (1889-99) dhe një fjalor turqisht me dy vëllime (1898-1901). Një numër dorëshkrimesh të pabotuara që merren me studime të turqishtes mbijetuan pas vdekjes së tij në vitin 1904, në moshën pesëdhjetë e katërvjeçare. Për të gjithë këtë aktivitet, Shemsedin Samiu fitoi një vend të shquar në historinë intelektuale otomane.

Përveç veprave të lartpërmendura dhe botimeve të tjera në gjuhën otomane, Shemsedin Samiu ishte gjithashtu autor i disa veprave në gjuhën shqipe, që përfshinin një pamflet mbi alfabetin, një libër gramatike, një antologji (libër leximi) dhe një traktat politik kontroversial (polemizues). Për kontributet e tij në zhvillimin e letërsisë kombëtare në gjuhën e tij amtare, historianët shqiptarë me të drejtë e kanë vlerësuar Shemsedin Samiun si një nacionalist shqiptar. Në një nivel universal human, Shemsedin Samiu i çmoi dhe admiroi arritjet kulturore dhe intelektuale evropiane, duke kërkuar në të njëjtën kohë dinjitet dhe respekt për trashëgiminë e tij amtare.

PËRFUNDIM

Imazhi i shqiptarëve në shoqërinë otomane përshkonte një spektër të gjerë: nga një popull përgjithësisht besnik me një histori shërbimi dhe sakrifice për perandorinë, deri te një grup etnik i egër dhe rebel. Shemsedin Samiu vendosi ta



shkruajë "*Besa yahud Ahde Vefa*" me qëllim që ta paraqesë popullin shqiptar në një dritë sa më pozitive për publikun otoman. Ai paraqiti një portret mjaft të idealizuar të një populli me atribute fisnike, të tilla si besnikëria ndaj fjalës së dhënë, nderi dhe vetëfljimi.

Në vendosjen e shfaqjes brenda kontekstit të kohës të tij, Shemsedin Samiu paraqet dy vatane. Vatani i përgjithshëm përfaqësonte një identitet dhe lidhje mbinacionale të bashkimit të të gjithë popujve të ndryshëm të perandorisë së bashku nën flamurin e otomanizmit. Vatani i veçantë përfaqësonte atdheun e një populli të bazuar mbi "kombësinë etnike" (kavmijet), në këtë rast Shqipërinë. Në hyrjen e tij, Shemsedin Samiu kishte lënë të kuptohej se nevojitej që letërsia otomane t'i kushtonte më tepër vëmendje kulturave të ndryshme vendase të perandorisë. Ai sigurisht kërkonte një shprehje më të madhe të shqiptarisë nga populli shqiptar.

Përktheu nga anglishtja: Mimoza Sinani

- 1 Şemseddin Sami, *Besa Yahud Ahde Vefa*, 5. Shih gjithashtu George W. Gawrych, "Tolerant Dimensions of Cultural Pluralism in the Ottoman Empire: the Albanian Community, 1800-1912," *International Journal of Middle East Studies* 15 (1983): 524-28.
- 2 Şemseddin Sami, *Besa Yahud Ahde Vefa*, 6.
- 3 Po aty, 17-180.
- 4 Po aty, 128-29.
- 5 Russana Hristova-Beyleri, "Myth and Reality in Albanian Literature," në *Albania and Albanian Identities*, bot., Antonina Zhelyazkova (Sofje, 2000), 158.
- 6 [Mary] Edith Durham, *High Albania* (Londër, 1909), 171.
- 7 Për informacion të përgjithshëm mbi jetën dhe veprat e Shemsedin Samiut, shih Omer Faruk Akun, "Şemseddin Sami," *İslam Ansiklopedisi* vol. 11 (Stamboll, 1970), 411-22; Ağah Sirri Levend, Şemsettin Sami (Ankara, 1969); Hikmet Turhan, Şemsettin Sami Bey ve Hayati ve Eserleri (Stamboll, 1934); Peter Bartl, *Die albanische Muslime zur Zeit der Nationalen Unabhängigkeitsbewegung, 1878-1912* (Weisbaden, 1980), 105-12; Kristo Frashëri, "Şemseddin Sami Frashëri: ideologue du mouvement national albanais," *Studia Albanica* 3 (1966): 95-110; dhe Bilmez Bülent, "Ölümün yüzüncü yilinda Şemsettin Sami Frashëri: paylaşılamayan aydın," *Toplumsal Tarih* 126 (qershor 2004): 38-45.
- 8 Şemseddin Sami, *Kamus el-A'lam: Tarih ve Coğrafya Lugati ve Tabir-i Esahhiye Kaffeyi Esmayi Hassayı Camiidir*, vol. 1-6 (Stamboll, 1306-16 H/1889-99), vol. 5, "Fraşer," 3353.

Kultura islame në Perëndim – mundësitë dhe sfidat

Me rritjen e numrit të myslimanëve në vendet perëndimore, kultura islame nuk është më një vizitor kalimtar, por është bërë pjesë e peizazhit kulturor të larmishëm të këtyre shoqërive. Kjo prani e vazhdueshme është shoqëruar me sfida të mëdha, si islamofobia dhe konflikti i identitetit, por edhe me mundësi premtuese për afrim dhe ndikim pozitiv.

Në thelb të këtij fenomeni të kulturës islame në Perëndim qëndrojnë konceptet thelbësore, si: pluralizmi, toleranca dhe bashkëjetesa, të cilat janë vlera që ndërthuren me thelbin e kulturës islame. Nëpërmjet institucioneve arsimore dhe fetare, platformave të mediave sociale dhe dialogut ndërkulturor, myslimanët tani mund të kontribuojnë në formësimin e një diskursi shoqëror më të kuptueshëm dhe më gjithëpërfshirës.

Si mundet që kultura islame të bëhet një *urë për dialog* dhe jo një barrierë? Dhe si mund të kapërcehen sfidat duke i shndërruar ato në mundësi, për të kontribuar në përhapjen e ndërgjegjësimit mbi vlerën e *diversitetit kulturor* në Perëndim?

HARQE ISLAMIKE NË SPANJË

Kultura islame është një pjesë integrale e identitetit fetar dhe shoqëror të myslimanëve në mbarë botën, një kulturë me rrënjë, që shtrihen në më shumë se 1400 vjet histori dhe trashëgimi qytetëruese. Me rritjen e numrit të myslimanëve në vendet perëndimore si rezultat i emigrimit dhe konvertimit, prania e kulturës islame në Perëndim është bërë një fenomen që meriton studim dhe analizë. Ky artikull synon të eksplorojë ndikimin e kulturës islame në shoqëritë perëndimore, sfidat dhe mundësitë e saj, si dhe mënyrën se si mund të promovohet dialogu ndërkulturor.

Në thelb të kulturës islame në Perëndim qëndrojnë konceptet thelbësore, si: pluralizmi, toleranca dhe bashkëjetesa, të cilat janë vlera që ndërthuren me thelbin e kulturës islame.



PRANIA ISLAME NË PERËNDIM – HISTORIA DHE RRËNJËT

Megjithëse Islami shpesh shihet si një fe e Lindjes së Mesme ose e Azisë, prania e tij në Perëndim nuk është diçka e re. Kjo prani daton që para shumë shekujsh, ku myslimanët kanë kontribuar ndjeshëm në formësimin e disa aspekteve thelbësore të qytetërimit perëndimor. Le të shohim se si filloi kjo marrëdhënie historike dhe cilat ishin pikat kryesore të saj.

Fillimet e Islamit në vendet perëndimore: Prania e Islamit në Perëndim nuk është një fenomen i ri, por daton që në Mesjetë. Gjatë periudhës së çlirimeve islame në shekujt VII dhe VIII, ndikimi i myslimanëve u shtri në Evropë përmes Andaluzisë (Spanjë) dhe Italisë së Jugut. Myslmanët në atë kohë kontribuan në zhvillimin e shkencës, filozofisë dhe arteve, duke lënë gjurmë të dukshme në qytetërimin evropian.

Me kalimin e kohës, kjo prani u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme pas rënies së Andaluzisë në fund të shekullit XV. Megjithatë, Islami u kthye dhe u shfaq dukshëm në Perëndim gjatë shekullit XX për shkak të emigrimit masiv nga vendet islame drejt Evropës dhe Amerikës së Veriut.

Emigracioni dhe përhapja e kulturës islame në Perëndim

Vitet e fundit kanë dëshmuar një rritje të madhe të numrit të myslimanëve në vendet perëndimore si rezultat i faktorëve të shumtë, siç janë: emigrimi ekonomik, strehimi politik dhe martesat e përziera. Sipas një raporti nga Qendra Kërkimore *Pew* (*Pew Research Center*), pritet që numri i myslimanëve në Evropë të arrijë rreth 7.5% të popullsisë deri në vitin 2050. Këto shifra pasqyrojnë një ndryshim të rëndësishëm demografik, që ndikon në strukturën kulturore dhe sociale të këtyre shoqërive.

Kultura islame në Perëndim – përkufizimi dhe ndikimi: Pasi u njohëm me rrënjët historike të Islamit në Perëndim, tani mund të thellohem në kuptimin e kulturës islame dhe atë se si ndikon ajo në shoqëritë perëndimore. Kultura islame nuk është thjesht një koleksion zakonesh dhe traditash, por është një sistem gjithëpërfshirës i karakterizuar nga vlera morale dhe praktika fetare, që mbartin një mesazh universal. Le të shqyrtojmë se si përkufizohet kjo kulturë dhe cilat janë ndikimet e saj pozitive.

Çfarë është kultura islame?

Kultura islame nuk është thjesht një koleksion zakonesh dhe traditash, por është një sistem gjithëpërfshirës, që përfshin vlerat morale, praktikat fetare, artet dhe shkencat. Kjo kulturë bazohet në parimet e Islamit, që bëjnë thirrje për tolerancë, mëshirë dhe drejtësi, të cilat janë vlera që synojnë arritjen e ekuilibrit midis shpirtërores dhe materiale.

Në Perëndim, myslimanët përpiqen ta ruajnë identitetin e tyre kulturor duke praktikuar ritet fetare, siç janë: namazi dhe agjërimi, duke veshur rroba tradicionale dhe duke organizuar ngjarje shoqërore si festat (bajramet) dhe dasmat.

Ndikimi pozitiv i kulturës islame

Kultura islame në Perëndim ka kontribuar në pasurimin e shoqërive perëndimore përmes:

Diversitetit kulturor: Myslmanët kanë shtuar ngjyra të reja të arteve, muzikës dhe ushqimit në skenën kulturore perëndimore.

Kontributeve shkencore: Shumë shkencëtarë myslimanë që jetojnë në Perëndim japin kontribute të rëndësishme në fushat e mjekësisë, inxhinierisë dhe teknologjisë së informacionit.

Forcimit të vlerave njerëzore: Kultura islame në Perëndim bën thirrje për tolerancë dhe bashkëjetesë paqësore, gjë që forcon bashkëjetesën midis kulturave të ndryshme.

Sfidat me të cilat përballet kultura islame në Perëndim

Ndërkohë që kultura islame kontribuon në pasurimin e shoqërive perëndimore, ajo përballet gjithashtu me shumë sfida, që e bëjnë të vështirë për myslimanët ruajtjen e identitetit dhe traditave të tyre. Nga islamofobia deri te mospërputhja me ligjet vendore, ka një sërë pengesash që duhet të kapërcehen. Le t'i shqyrtojmë sfidat më kryesore.

Islamofobia dhe paragjykimi: Pavarësisht përpjekjeve për ta nxitur mirëkuptimin ndërkulturor, myslimanët në Perëndim ende përballet me sfida të mëdha për shkak të islamofobisë (frikës apo armiqësisë ndaj Islamit). Ky paragjykim shfaqet në forma të ndryshme, si nëpërmjet stereotipave negative që përhapen në media, ashtu edhe në sulme raciste ndaj myslimanëve për shkak të pamjes së tyre ose besimeve fetare.

Përshtatja me ligjet lokale: Myslmanët në Perëndim përballet me sfida në pajtimin e besimeve të tyre fetare me ligjet lokale. Për shembull, disa praktika si therja hallall (sipas rregullave islame) ose mbajtja shamisë/hixhabit mund të bien ndesh me ligjet që lidhen me shëndetin publik ose me shprehjen personale.

Humbja e identitetit kulturor: Me rritjen e ndikimit kulturor perëndimor, të rinjtë myslimanë përballet me rrezikun e humbjes së identitetit të tyre kulturor. Disa përpiqen për një integrim të plotë në shoqërinë perëndimore, në kurriz të traditave të tyre islame, ndërsa të tjerë përpiqen t'i ruajnë traditat e tyre, por në një mënyrë që përshtatet me mjedisin e ri.

Mundësitë për forcimin e kulturës islame në Perëndim: Pavarësisht sfidave të mëdha me të cilat përballet kultura islame në Perëndim, ekzistojnë mundësi të mëdha, që mund të shfrytëzohen për ta forcuar dhe rrënjësuar atë. Përmes institucioneve islame, dialogut ndërkulturor dhe përdorimit të teknologjisë, myslimanët mund të kontribuojnë në ndërtimin e shoqërive më të larmishme dhe më të pranueshme. Le t'i shqyrtojmë disa nga këto mundësi.

Roli i institucioneve islame: Institucionet islame, si: xhamitë, shoqatat bamirëse dhe shkollat, luajnë një rol kyç në forcimin e kulturës islame. Përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe edukative, këto institucione mund t'ju ndihmojnë myslimanëve që ta ruajnë identitetin e tyre, dhe



njëkohësisht të paraqesin imazh pozitiv të Islamit për shoqëritë perëndimore.

Dialogu ndërkulturor: Dialogu ndërkulturor konsiderohet një mjet efektiv për ta forcuar mirëkuptimin reciprok. Përmes organizimit të forumeve kulturore, ekspozitave artistike dhe konferencave, myslimanët dhe jomyslimanët mund të njihen më mirë me njëri-tjetrin, gjë që i ul keqkuptimet dhe paragjykimet.

Përdorimi i teknologjisë: Teknologjia moderne ka ofruar mundësi të reja për përhapjen e kulturës islame. Përmes mediave sociale, myslimanët mund të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të paraqesin përmbajtje edukative dhe kulturore që pasqyrojnë vlerat islame në një mënyrë pozitive.

Roli i medias në formësimin e imazhit të Islamit: Media është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në mënyrën se si njerëzit e perceptojnë Islamin dhe myslimanët në Perëndim. Qoftë mbulimi të jetë pozitiv apo negativ, ai luan rol të madh në formësimin e imazhit të përgjithshëm të Islamit. Le të analizojmë se si ndikojnë mediat në këtë aspekt dhe pse ka nevojë për ndryshim.

Mbulimi negativ mediatik: Shpeshherë mediat perëndimore e trajtojnë Islamin nga një këndvështrim negativ, duke u përqendruar te krimet që kryhen nga individë që i përkasin Islamit, pa marrë parasysh veprat pozitive që i kryen shumica dërrmuese e myslimanëve. Ky lloj raportimi i forcon stereotipat dhe çon në rritjen e islamofobisë.

Nevoja për media të balancuar: Për të arritur një balancë në imazhin mediatik të Islamit, mjetet e informimit perëndimor duhet t'i theksojnë arritjet pozitive të myslimanëve dhe ta paraqesin Islamin si fe që thërret në paqe dhe tolerancë. Po ashtu, institucionet islame mund të luajnë një rol në ofrimin e narrativave alternative që i nxjerrin në pah aspektet pozitive të kulturës islame.

PËRFUNDIMI

Kultura islame në Perëndim paraqet një fenomen kompleks, që i ndërthur sfidat dhe mundësitë. Nga njëra anë, myslimanët përballen me vështirësi në ruajtjen e identitetit të tyre kulturor dhe fetar në shoqëri që shpesh nuk i kuptojnë parimet e tyre. Nga ana tjetër, ky mjedis ofron mundësi për ta treguar fytyrën e vërtetë të Islamit si fe që thërret në paqe dhe bashkëjetesë.

Përmes forcimit të dialogut ndërkulturor, përdorimit të teknologjisë dhe mbështetjes së institucioneve islame, myslimanët mund të kontribuojnë në ndërtimin e shoqërive perëndimore më të larmishme dhe më respektuese ndaj kulturave të ndryshme. Po ashtu, përgjegjësia bie edhe mbi shoqëritë perëndimore për të krijuar mjedis mikpritës, që e pranon tjetrin dhe i respekton dallimet e tij.

- Lista e burimeve dhe shënimeve:
- Pew Research Center. (2017). "Europe's Growing Muslim Population."
- Esposito, John L. (2011). What Everyone Needs to Know About Islam . Oxford University Press.
- Ramadan, Tariq. (2004). Western Muslims and the Future of Islam . Oxford University Press.
- BBC News. (2020). "Islamophobia in Europe: A Growing Concern."
- United Nations Alliance of Civilizations. (2019). "Promoting Intercultural Dialogue."

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Burimi: الثقافة الإسلامية في الغرب .. فرص وتحديات

<https://islamonline.net/١٤٠٨٤٥>



Trajtime gjuhësore në “Reflektime Kuranore”

Granit Sadiku

Ajo që e veçon tefsirin “Reflektime kuranore” është përdorimi i njohurive gjuhësore brenda komentimit: analiza e fjalëve, togfjalëshave, morfemave dhe strukturave gramatikore.

DEDIKIM PARATHËNËS

Kur shkollarët e fushës e përshkruajnë si të vështirë komentimin e një teksti, imagjinoni se sa i vështirë mund të jetë komentimi i komentimit të tij. Në këtë rast, duke pasur për bazë një tekst shkencor-fetar, siç është ai i tefsirit (komentimit) të Kuranit famëlartë, arrij të vërej se fjalët janë të mangëta e nganjëherë të pashprehshme, për të treguar se çka në të vërtetë meriton të thuhet për një vepër të tillë madhore. Të jem i qartë, këtë tekst nuk e shkruaj fare si njohës i fushës së tefsirit, e aq më pak si pretendues për të qenë i thirrur në fahun e tij, por e shkruaj thjesht si refleksion, apo komentum mbi një vepër të lexuar dhe të preferuar (sado që shkencore), e cila arrin ta tërheqë lexuesin besimtar dhe ta bëjë për vete. Në tefsiret e tjera, të cilat i kam lexuar nga dëshira për të

ditur më shumë për Kuranin dhe shkencën e komentimit të tij, kam vërejtur se nuk i jepet fokus i veçantë analizës së fjalëve, togfjalëshave dhe fjalive, respektivisht analizës gjuhësore. Ndërsa, qysh në kontaktin e parë me librin vëllimor “*Reflektime Kuranore*” të prof. Adnan Simnicës, kam vërejtur mëtimin e tij për t’i zbatuar edhe njohuritë gjuhësore brenda për brenda tefsirit. Analiza e fjalëve, fjalive, kategorive gramatikore, zbërthimi i morfemave, shtjellimi kuptimor i tyre, më ka bërë që të shkruaj diçka për këtë tefsir, por jo si njohës i tefsirit, mirëpo si njohës i gramatikës së gjuhës shqipe. Dhe ky shkrim nuk denjon aspak t’i japë vlerë një tefsiri, mirëpo guxon të shprehë disa nga sekuencat e parapëlqyera, të cilat mund të jenë udhëzues për lexuesit, dhe pjesë me interes për njohësit e gjuhës dhe gramatikës shqipe.



ANALIZAT GJUHËSORE, MORFEMATIKE DHE SINTAKSORE TE “REFLEKTIME KURANORE”

Në tretmanin gjuhësor që e bën prof. Adnan Simnica, që nga libri i parë – Komenti i sures Err Rad, vërehen një mori qasjesh të ndryshme, nëpërmjet të cilave analizohet aspekti morfematik, apo aspekti sintaksor gjuhësor i një ajeti kuranor. Në këto qasje përfshihen metodat: analiza e fjalës specifike (qoftë nga gjuha origjinale arabe apo edhe përkthimi në shqip), dallimi që përbën kategoria gramatikore e emrit (trajta e shquar dhe e pashquar), logjika e përdorimit të njëjësit dhe shumës në Kuran, specifika e mënyrës pyetëse, esenca gjuhësore e ndarjes së foljes në kohë dhe funksioni i tyre, dhe analizat specifike të pjesëve të ndryshueshme apo të pandryshueshme të ligjëratës.

Analiza specifike gjuhësore, në librin e lartpërmendur, vërehet që në faqet e para kur tefsirologu, prof. Adnan Simnica, na e paraqet një univers gjithëpërfshirës të kuptimit të vetë emrit ‘Allah’. Është fjala për komentimin e ajetit të dytë të sures Err Rad, në të cilën që në fillim e kemi të theksuar emrin ‘Allah’. Në këtë rast, pason shpjegimi logjik se pse Zoti i Lartmadhëruar nuk e përdor thjesht përemrin vetor ‘Ai’, siç ndodh rëndom në shumë ajete të tjera, por e përdor emrin specifik ‘Allah’.

Përdorimi i emrit “Allah”, e jo i përemrit “Ai”, i cili do të ishte në lidhje të ngushtë me emrin “Zot” të ajetit paraprak, ka ndodhur për arsye se emri Allah është i veçantë vetëm për Atë, dhe askush nuk i ngjan, madje as në emër dhe as mënyrë, dhe kjo e dallon nga zotat e rremë (idhujt që i adhurojnë shumë njerëz).¹

Prandaj, sipas logjikës, nënkuptohet se përdorimi i emrit ‘Allah’ ngërthen në vete arsye të shumta, siç janë ato që i rendit autori në libër. Dhe aludohet se emri ‘Allah’ është gjuhësisht poliedrik – shumëfunksional, ndërsa kuptimi i përemrit vetor ‘Ai’ është thjesht shenjim i një autoriteti të lartë.

Të njëjtën metodë e ndjek autori edhe në vëllimin tjetër, ku komentohet surja El Hixhër, në të cilën i kushtohet analizë e veçantë emrit ‘Libër’, dhe arsyet pse në gjuhën e Kuranit ky emër vjen në trajtë të pashquar. Sipas gjuhës së Kuranit, diferencohet trajta e shquar ndaj të pashquarës kur bie fjala për emrin ‘Libër’. Në këtë tefsir sqarohet se, gjuhësisht, kur emri ‘Libër’ vjen në trajtë të pashquar, atëherë është fjala për ndonjë nga librat e tjerë që janë shpallur para Kuranit. Ndërsa, kur shquhet emri ‘Libri’, atëherë shquarsia e tij e determinon se fjala është specifikisht për Kuranin. Pra, një dallim i vogël në kategorinë gramatikore të emrit, në këtë rast, krijon dallim diferencial në kuptimin e vetë emrit ‘Libër’. Ndonëse, çdokush mund ta kuptojë se çka është një libër, dhe pse quhet libër. Por, në këtë rast, dallimi qëndron në aspektin e saktësisë dhe

ekskluzivitetit, ngase kur thuhet ‘Libër’ dihet se është i rëndomtë, ndërsa kur thuhet ‘Libri’ dihet se s’ka një të dytë si ai. Vetëm nga ky dallim gjuhësor, mund të dëshmohet se Kurani është i vetmi Libër qiellor i pandryshuar nga dora e njeriut, ngase është ‘Libri’.

Mirëpo, autori hap edhe një dimension tjetër të veçantë, në lidhje me çështjen se pse Kurani është quajtur ‘Libër’ edhe para se të ishte libër, kushtimisht edhe para se të tubohej në një Mus’haf.

(...)Kurani është quajtur “Libër” para se të shkruhej e tubohej, si sinjal i qartë se do të bëhej libër, kurse Kuran si shenjë që i përshtatet nocionit “Libër”, sepse lexohet dhe studiohet prej besimtarëve.²

Sipas analizës gjuhësore të autorit, në gjuhën e Kuranit është karakteristikë që mungesa e shquarsisë së emrit do të thotë përgjithësim i tij. Siç u tha edhe më lart, dallimi qëndron në faktin se si i drejtohet Zoti i Madhëruar një gjëje. A e veçon atë, apo e përgjithëson! Rast të njëjtë kemi në trajtimin e ajetit të tretë të sures Err Rad, ku merret fjala “çift”. Në rastin e ajetit në fjalë, përdorimi i emrit në trajtë të pashquar “çift”, korrespondon me faktin se Allahu çdo gjë e ka krijuar në çift. Si nga njerëzit, ashtu edhe nga kafshët, e edhe nga llojet e tjera të krijimtarisë së Zotit, dihet se ligji i riprodhimit të diçkaje është çiftëzimi. Po të thuhej “çifti”, atëherë do të kihej parasysh një çift i caktuar dhe i veçuar. Ndërsa, në këtë rast, përdorimi i trajtës së pashquar në këtë emër e përgjithëson atë.³

Rast i njëjtë i kësaj lloj trajtese gjuhësore mbi efektin e pashquarsisë, gjendet edhe në vëllimin që përmban komentimin e sures Fatir. Përgjatë komentimit të ajetit të shtatë të kësaj sureje, duke trajtuar fjalën “dënim”, përshkruhet se drithërimi më i madh që mund ta kaplojë njeriun është pikërisht kjo formë e trajtës së emrit. Trajta e pashquar e fjalës “dënim” e ka kuptimin se dënimi nuk është i njëllë, por i larmishëm.

Analiza specifike gjuhësore, në librin e lartpërmendur, vërehet që në faqet e para kur tefsirologu, prof. Adnan Simnica, na e paraqet një univers gjithëpërfshirës të kuptimit të vetë emrit ‘Allah’.

Dënimet do të jenë të shumta për ata që nuk besojnë, dhe që nuk e besuan Allahun për Zot. Dhe fjala ‘dënim’, ndonëse është në numrin njëjës, prapë asocon në shumësi dënimesh.⁴

Esenca gjuhësore e çdo fjale është një filozofi më vete, një tablo, apo një gamë konceptuale, e cila e fiton kuptimin plotësisht atëherë kur zbërthehet dhe analizohet. E pikërisht për këtë aspekt mund të flasim kur e trajtojmë logjikën e përdorimit të njëjësit dhe të shumës në Kuran.

Në komentimin e ajetit të gjashtëmbëdhjetë të sures Err Rad, analizohet në aspekt morfologjik pyetja retorike: *A janë njësoj errësirat dhe drita?* Domethënë, siç mund të shihet, errësira është në numrin shumës, ndërsa drita është në njëjës. Asociacioni logjik na dërgon menjëherë tek ideja se ky ajet, ashtu si edhe shumë ajete të tjera kuranore, thërret në mendime të thella dhe shmangie nga errësirat, të cilat gjithmonë janë më të shumta dhe më të mëdha se drita. Errësirat janë gënjeshttrat, mashtrimet, devijimet, ndërkaq drita është feja e pastër islame, e cila është rrugë ndriçuese në mesin e errësirave të shumta. Ai që nuk e sheh këtë dritë është i verbër (edhe pse mund t’i ketë sytë në formën më të mirë), ndërsa ai që e sheh është fizikisht dhe shpirtërisht i shëndoshë. Prandaj, këta dy lloj njerëzish nuk mund të jenë kurrë të barabartë mes vete.⁵

Kuptimi i përdorimit të njëjësit dhe shumës mund të variojë edhe në forma të tjera, siç është për shembull në ajetin e tridhjetëdytë të sures Ibrahim, fjala “qiell” vjen në njëjës e jo në shumës. Në komentin e këtij ajeti kuranor, autori ndër të tjera thekson se ekziston dallimi në numër edhe në një kontekst tjetër të diskursit të ajetit, e që është fjala kur diskursi është për krijimin e “qiejve” ose për aspekte të tjera. Kur Zoti i Madhëruar flet për krijesën e Tij, ai zakonisht i referohet fjalës qiell në shumës “qiej”, për të treguar se niveli jonë që arrin deri në qiellin e parë, është vetëm njëri nga shtatë qiejt që Zoti i ka krijuar mbi ne. Ndërsa Toka, apo Planeti, apo Bota, sido që e quajmë, është gjithmonë në njëjës. Meqë në këtë ajet kuranor flitet specifikisht për shiun, atëherë autori shpjegon se fjala në këtë rast është për shtresën e parë të qiellit, për nivelin e reve.

Këtu është përdorur shprehja “qiell” në njëjës dhe jo në shumës, sikurse të krijimi, për arsye se shiu zbret nga retë e mbushura me ujë, të cilat janë mbi Tokë, kurse qiejt përfshijnë

Nga ajo që dihet deri më tash nga komentuesit e Kuranit, duke filluar nga tefsiri për të cilin po flasim, është se format pyetëse të Kuranit nuk janë pyetje të rëndomta që kërkojnë informacion nga subjekti, por janë forma të pyetjes retorike, të cilat nuk kërkojnë përgjigje por e ngrisin vetëdijen.

në tërësi Tokën, e cila mbetet sikurse një pikë e vogël brenda çatisë; pra, me të janë për qëllim retë.⁶

Dhe aspekti i tretë të cilin do ta trajtojmë, është përdorimi i njëjësit dhe shumës për t’i treguar dy kuptime të kundërta, qoftë edhe brenda një ajeti kuranor. Për shembull, ka raste kur e njëjta fjalë, por në numra të ndryshëm, mund të ketë përmbajtje “dënim”, apo “begati”, dy gjëra krejt të kundërta. Rast konkret për këtë është përdorimi i fjalës “erë”. Në komentin e sures Sebe, specifiku në komentin e ajetit të dymbëdhjetë, autori shtjellon nocionin “erë”, që përdoret për të treguar fuqinë që Zoti ia kishte dhënë Sylejmanit, a.s..

Zoti i Madhëruar, kur shprehjen “erë” e ka përdorur në njëjës, e ka për qëllim dënimin nga ajo dhe dënimin me të, *kurse kur e ka përdorur në shumës, e ka për qëllim dobinë dhe mëshirën.*⁷

Secila pjesë e ndryshueshme e ligjëratës ka në kategorinë e saj numrin. Në thelb, numri mund të duket pjesë e rëndomtë, e cila në asnjë mënyrë nuk e ndryshon thelbin e fjalës, p.sh.: gur – gurë, libër – libra, shkronjë – shkronja, njeri – njerëz, etj.. Mirëpo, siç pamë në këto raste, dhe në disa raste të tjera, ndodh që në Kuran të ketë një fjalë, dhe e njëjta fjalë – pa iu ndërruar kuptimi me parashtesa ose prapashtesa – t’i ndërrohet kuptimi vetëm nga ndërimi i numrit. Dhe kjo po që është një nga aspektet më fleksibile të një gjuhe, dhe

një nga mrekullitë prej mrekullive të shumta të Fjalës së Zotit.

Një aspekt me rëndësi, e goxha diskutabil, është përdorimi i pjesëve pyetëse në ajetet kuranore. Disa herë është diskutuar, kritikuar, e vënë në dyshim, përdorimi i shenjave të interpunkcionit brenda tekstit kuranor. Mirëpo, nga ajo që dihet deri më tash nga komentuesit e Kuranit, duke filluar nga tefsiri për të cilin po flasim, është se format pyetëse të Kuranit nuk janë pyetje të rëndomta që kërkojnë informacion nga subjekti, por janë forma të pyetjes retorike, të cilat nuk kërkojnë përgjigje por e ngrisin vetëdijen.

Në komentin e ajetit të nëntë të sures Sebe, trajtohet në aspekt sintaksor fjalia pyetëse: “*Vallë, a nuk e shohin ata se çfarë ka para tyre dhe pas tyre në qiell dhe në Tokë?*”. Autori flet për shprehjen e pjesëzës në gjuhën kuranore, që është “Fa”, e cila në shqip përshtatet në kuadër të pjesës së ajetit “*Vallë, a nuk?*”, e që lidhet me pjesën paraprake të ajetit të tetë para këtij, ku kategorizohet pjesa: “*...ata që nuk besojnë në*

jetën tjetër, do të dënohen dhe janë në humbje të madhe". Mirëpo, me interes për shembullin tonë është shpjegimi vijues, që bën autori ndaj formës pyetëse "a nuk".

...përdorimi i pjesëzës pyetëse në fillim të këtij ajeti shpreh kritikën ndaj tyre dhe përmban edhe mohimin dhe refuzimin që bëjnë ata ndaj përsiatjes në argumentet që thërret Krijuesi.⁸

Forma pyetëse gjejmë edhe në komentet e ajeteve të tjera të sureve të tjera, siç është rasti te surja Ibrahim, në komentin e ajetit të njëzetekatërt. Ky ajet fillon me pjesëzën pyetëse të njëjtë: "Vallë, a nuk e ke parë se si...", dhe kjo formë nuk është një pyetje, sipas komentit të ajetit nga autori, por është një motivim për ta ditur dhe për ta kuptuar këtë shembull qartësisht.⁹ Kjo formë është shprehje edhe e habitës apo çudisë, në aspektin se si mund të mos kuptohet një argument i tillë. Rast të tillë të pyetjes retorike kemi edhe te ajeti i katërmëdhjetë i sures Muhamed, i cili merret shembull vetëm sa për ilustrim: "Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të vet me atë që i zbukurohen punët e veta të këqija dhe i ndjek epshet e veta?" (Muhamed, 14). Përderisa dihet përfundimi i besimtarëve, dhe dihet përfundimi i jobesimtarëve, është e paarsyeshme të konsiderohet se kjo formë pyetëse presupozon kërkimin e informacionit. Përkundrazi, kjo formë pyetëse mohon thelbësisht përnjëjtësimin e një besimtari me një jobesimtar.¹⁰

Kur flasim për kohët e foljes, e dimë se në çdo gjuhë të botës ekziston distinkcioni i qartë mes tyre. Në shqipe kemi kohën e tashme, kohën e shkuar që ka pesë nënkohë (e pakryera, e kryera, e kryera e thjeshtë, më se e kryera, dhe e kryera e tejshkuar), dhe të ardhmen që i ka katër (e ardhmja, e ardhmja e përparme, e ardhmja e së shkuarës, dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës). Në komentin e ajetit të pestë të sures El Hixhër, kemi të bëjmë me togun "...nuk mund as ta shpejtojë, as ta ngadalësojë...". Në këtë rast, foljet "shpejtojë" dhe "ngadalësojë" janë në kohën e tashme. Mirëpo, duke e shikuar kontekstin e ajetit, i cili flet për mëtimin e popujve ta ndryshojnë përcaktimin apo dënimin që iu vjen nga Zoti, atëherë kohës së foljes i jepet edhe një dimension. Në këtë rast, ndonëse koha e foljes është në të tashmen, sipas shpjegimit të tefsirologut, koha përfshin të tashmen dhe të ardhmen. Për arsye se, koha e foljes në këtë rast nuk ka për qëllim të tregojë gjendjen momentale, por të gjeneralizojë çdo kohë dhe çdo popull.


Në këtë trajtë e kemi edhe një rast tjetër, pak a shumë të ngjashëm, i cili është po ashtu në kohën e tashme, mirëpo pa përfshirë kohën e ardhme. Është fjala për të njëjtën sure, në komentin e ajetit të njëmbëdhjetë të saj, ku përdoret fjala "tallje": "A tyre nuk u erdhi asnjë prej të dërguarve, e ata të mos talleshin me të". Në këtë rast:


Tallja dhe përqeshja me pejgamberët a.s., te jobesimtarët ishte diçka e natyrshme për çdo kohë, prandaj edhe përdorimi

i shprehjes "tallje" në gjuhën e Kuranit ka ardhur në kohën e tashme.¹¹

Në shumë folje që përdoren në Kuran mund të gjejmë shembuj të tillë, që dëshmojnë tipizimin e një forme të veçantë të të shprehurit, të vlefshme për çdo kohë.

Karakteristikë e veçantë gjuhësore është forma e përdorimit të përemrave, aspekt të cilin e kemi prekur edhe në fillim të këtij kapitulli shkurtimisht. Përdorimi i përemrit vetor dhe pronor ka rol shumë domethënës në komentimin e një ajeti. Për shembull, pse Zoti i Madhëruar, kur i referohet zbritjes së Kuranit tek ajeti i tretë i sures Jusuf, thotë "Ne" e jo "Unë"? Dhe tjetri rast, në ajetin e katërmëdhjetë të sures Ta Ha, kur flitet për ardhjen e shpalljes së Musait, a.s., në luginën Tuva dhe të folurit e tij me Allahun, Ai drejtohet me përemrin vetor "Unë" dhe jo "Ne". Pse ndodh kjo? Sikundër na shpjegohet nga ky tefsir, dhe nga disa tefsire të tjera, se kur Allahu do që të dëshmojë respektin, dashurinë, e mirënjohjen ndaj krijesave bashkëpunuese në aspekte të caktuara, siç është për shembull zbritja e Kuranit, atëherë drejtohet me përemrin vetor "Ne". Ngase, siç dihet, Xhibrili, a.s., engjëlli i shpalljes, me urdhrin e Zotit e zbriti Kuranin te Muhamedi a.s.. Ndërsa, kur Allahu do që ta shfaqë autoritetin e Tij, Gjithëfuqinë, mundësinë e Tij të pakufishme dhe Njëshmërinë





e Tij, drejtohet me “Unë”, ngase është vetëm një Zot, e përveç Tij s’ka tjetër.

Ky është një dimension prej të shumtëve, të cilët tregojnë për domethënien e përdorimit të përemrave të caktuar. Mirëpo, kemi shumë raste kur Zoti në Kuran i drejtohet subjektit, Pejgamberit të Tij, me një diskurs përkëdhelës: “Përkujto kur Zoti yt...”. Rast të tillë kemi specifikisht te ajeti i njëzetetë i sures El Hixhër. Në komentimin e kësaj sureje dhe të këtij ajeti, autori thekson:

Edhe atribuiimi i emrit të Allahut me përemrin identifikues për Muhamedin a.s., “...kur Zoti yt”, sinjalizon nderin dhe privilegjin ndaj tij, a.s..¹²

Në gramatikë, dihet se përemri pronor “yt” nënkupton vetën e dytë, dhe mund të zëvendësohet në formë tjetër me përemrin vetor “ti”. Mirëpo, në Kuran, ndonëse mund të tingëllojnë krejt ngjashëm, ka dallim esencial. Përderisa përemri pronor “yt” është formë përkëdhelëse, përemri vetor “ti” nuk është e tillë, dhe i drejtohet një subjekti krejt tjetër. Në rastin e parë, e pamë se subjekti ishte i Dërguari i Zotit, ndërsa në rastin e dytë subjekti mund të jetë specifikisht një njeri, apo mund të jenë një grup njerëzish, apo mund të jetë edhe krejt njerëzimi.

Le ta marrim shembull ajetin e katërdhjetëetretë të sures Fatir, në të cilin thuhet: “...Ti vërtet nuk mund të gjesh kurrë ndryshim në ligjin e Allahut; ti nuk mund të gjesh kurrë shndërrim në ligjin e Allahut”. Do të gabonim shumë po ta konsideronim se “ti” i drejtohet Pejgamberit a.s., siç ishte rasti me “yt”. Në këtë rast, përemri “ti” përfshin një audiencë të gjerë, të cilët kanë dyshime në Zotin dhe në ligjet e Tij. Ndonëse është në njëjës, ai kuptohet pra në shumës: “Përemri “ti” nuk nënkupton person të veçantë, por përfshin çdonjërin...”¹³

PËR FUND

U munduam të sjellim disa venerime gjuhësore, të cilat janë me rëndësi të dihen dhe të trajtohen. Këta shembuj, që ishin pak nga shumë e shumë shembuj të tjerë, dëshmojnë për nivelin e një veprë shkencore dhe diturore, e cila përveç dimensionit të saj të tefsirit, ngërthen në vete edhe dimensionin e analizave gjuhësore. Për rëndësinë e gjuhës kemi bërë fjalë, dhe ajo veçse dihet. Prandaj, konsiderojmë se është jetike për një studiues të kësaj fushe të njohë jo vetëm gramatikën e gjuhës origjinale të tekstit të cilin e komenton, por edhe gramatikën e gjuhës në të cilën është përkthyer ai tekst. Madje, njihet një thënie e famshme që qarkullon mes shumë përkthyesish në botë, që është: “Nëse do ta përkthesh një tekst, së pari njihje gjuhën tënde!”

Duke e njohur gjuhën shqipe, dhe duke e pasur Kuranin të përkthyer në këtë gjuhë, ne që së dimë arabishten, së paku arrijmë ta kapim dimensionin thelbësor të tij. Mirëpo, edhe fleksibiliteti i gjuhës shqipe mund të ndikojë në cilësinë e të përkthyerit të Kuranit. E njëjta vlen në këtë rast edhe për komentimin e Kuranit. Në fakt, ka dijetarë eminentë, të cilët edhe vetë përkthimin e Kuranit e konsiderojnë thjesht komentim.

Prof. Adnan Simnica, autor i librit voluminoz “Reflektime Kuranore”, ka dëshmuar që zotëron njohuri të mira gjuhësore. Duke qenë i ndihmuar nga këto njohuri, ai ka arritur të paraqesë një gamë konceptesh të rëndësishme për lexuesit, që duan të mësojnë më shumë për komentimin e Kuranit. Dimensionin gjuhësor është pigmenti kryesor, pa të cilin e tërë piktura do të dukej vetëm si formë, por jo si estetikë. Prandaj, autori e ka vënë në theks të veçantë këtë trajtim. Ky dimension duhet të jetë imanencë e një teksti të tillë. Ngase, vetë esenca e njeriut është gjuha.

Referenca

- KURANI, përkthyer nga Sherif ef. Ahmeti, 1994.
- Reflektime Kuranore, Sureja Err Rad, A publishing, Prishtinë, 2024.
- Reflektime Kuranore, Sureja El Hixhër, A publishing, Prishtinë, 2024.
- Reflektime Kuranore, Sureja Fatir, A publishing, Prishtinë, 2025.
- Reflektime Kuranore, Sureja Sebee, A publishing, Prishtinë, 2025.
- Reflektime Kuranore, Sureja Ibrahim, A publishing, Prishtinë, 2025.
- 1 Adnan Simnica, “Reflektime Kuranore – Sureja Err Rad”, A publishing, Prishtinë, 2024, f. 38.
 - 2 Adnan Simnica, “Reflektime Kuranore – Sureja El Hixhër”, A publishing, Prishtinë, 2024, f. 28.
 - 3 Po aty, Sureja Err Rad, f. 53.
 - 4 Po aty, Sureja Fatir, f. 57.
 - 5 Po aty, Sureja Err Rad, f. 135.
 - 6 Po aty, Sureja Ibrahim, f. 166.
 - 7 Po aty, Sureja Sebee, f. 90.
 - 8 Po aty, Sureja Sebee, f. 69.
 - 9 Po aty, Sureja Ibrahim, f. 133.
 - 10 Po aty, Sureja Fatir, f. 59.
 - 11 Po aty, Sureja El Hixhër, f. 66.
 - 12 Po aty, Sureja El Hixhër, f. 125.
 - 13 Po aty, Sureja Fatir, f. 230.

Vepër studimore për Asim ef. Luzhën

(ALBAN DOBRUNA, ASIM LUZHA, INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”, PRISHTINË, 2025)

Nuridin Ahmeti

Jeta e Asim Luzhës fillon nga fundi i shekullit XIX, ndërsa veprimtaria e tij prej personaliteti historik i përket gjysmës së parë të shekullit XX.


Pas një pune të vazhdueshme nga kur e ka marrë përsipër studiuesi Dobruna për ta realizuar këtë projekt, pas shumë sfidave, themi se ja ka dalë që ta realizojë monografinë për imamin e njohur, veprimtarin e Ulema Mexhlisit, Organizatës së njohur “Xhemijeti” më qendër Shkup, Komitetit Mbrojtja Kombëtare të Kosovës në Shkodër e Luftës Nacional Çlirimtare, Asim ef. Luzhën.

Ky studim monografik, nga studiuesi Dobruna, është konceptuar sipas një renditje kronologjike jetësore e Asim ef. Luzhës, dhe nuk është ndarë në kapituj siç rëndom jemi mësuar t’i shohim një pjesë të studimeve të karakterit të tillë.

Pas parathënies, ku studiuesi Dobruna argumenton punën deri në finalizimin e këtij studimi, tregon për sfidat etj.. Ai shkruan për *originën e familjes së Asim ef. Luzhës*, e cila është nga fshati Luzhë e Malësisë së Gjakovës, rrethina e Tropojës. Sipas të dhënave, Luzhianët ishin vendosur në këtë vend, para afro katër shekujsh, ndërsa familja e Asim ef. Luzhës, me të parin e saj, konkretisht gjyshin e tij Sali Luzha, ishin shpërngulur nga ky vend, para afro dy shekujsh, dhe ishin vendosur në Gjakovë, të detyruar për shkak të rrethanave politike të kohës. Në Gjakovë, familja Luzha, falë angazhimit, shpejt do të bëhej simbol i përkushtimit njerëzor. Në

gjysmën e dytë të shekullit XIX, në Gjakovë u lind edhe babi i Asim ef. Luzhës, myderrizi i njohur Myrteza ef. Luzha, i shkolluar në Stamboll, në shkollat me renome të kohës për dije fetare islame, për t’u kthyer më pastaj në vendlindje. Myrteza ef. Luzha, në popull, në shenjë respekti, njihej si “Haxhi Myderrizi”. Ky personalitet fetar ishte krah i shumë dijetarëve nga fusha e dijes fetare islame që kishte Gjakova aso kohe, si dhe kontribuues në institucione edukuese islame që posedonte

Ky studim monografik, nga studiuesi Dobruna, është konceptuar sipas një renditje kronologjike jetësore e Asim ef. Luzhës, dhe nuk është ndarë në kapituj siç rëndom jemi mësuar t’i shohim një pjesë të studimeve të karakterit të tillë.



Gjakova në këtë periudhë. Në muajin gusht të vitit 1920, ky autoritet i njohur në këtë qytet, vritet nga forcat pushtuese.

Te titulli *lindja dhe shkollimi i Asim ef. Luzhës*, deri më tani, ka qenë e shkruar se ky veprimtar, lindi në Gjakovë, më 29 prill 1889. Mirëpo, nga hulumtimet e studiuesit Dobruna në Arkivin e Kosovës, ai arrin të sigurojë certifikatën e lindjes së Asim ef. Luzhës, të nënshkruar nga ai, ku viti i lindjes është më 29 prill 1896. Asim ef. Luzha, mbaroi shkollat e njohura ruzhdiye, medresenë e madhe në Gjakovë, dhe për një kohë mësimet i vazhdoi në Shkup në Shkollën e Lartë Pedagogjike e njohur si “Dârulmuallimîn”, shkollë kjo e lartë pedagogjike, e hapur në vitin 1882, ku e kishin përfunduar edhe shumë figura të njohura nga Vilajeti i Kosovës. Pas shkollimit të lartcekur, kthehet në vendlindje dhe shërben në disa fshatrat të rrethinës së Gjakovës si imam dhe mësues fetar, derisa me vendimin e Ministrisë së Fesë, nr. 906, të datës 10 shkurt 1926, nga mësues fetar, u emërua imam xhamie. Pavarësisht sfidave që do t’i dilnin si imam dhe autoritet fetar, duke e ngritur zërin kundra padrejtësive që po i bëheshin popullit dhe vendit ku po shërbente Asim ef. Luzha,

“Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, themeluar në maj 1918 në Shkodër nën udhëheqjen e Hoxhë Kadri Prishtinës, kishte degë edhe në Gjakovë. Asim ef. Luzha, u përfshi aktivisht në këtë organizatë, duke denoncuar padrejtësitë ndaj popullit.

studiuesi Dobruna konstaton: “Asim Efendiu dhe familja Luzha, nuk e braktisën Kosovën, madje asnjë hoxhë i Gjakovës, jo vetëm nuk e lëshuan Kosovën, por duke jetuar këtu, në mjerim dhe varfëri, të injoruar dhe në robëri, u shtuan me shumë djem dhe vajza, që i rritën dhe i edukuan dhe i shkolluan me shumë mundime e vështirësi.” Sipas të dhënave të ofruara në këtë studim, Asim ef. Luzha arrin me suksese t’i përballonte sfidat e ndryshme sociale, politike dhe etnike të kohës, me të cilat vazhdimisht përballlej populli shqiptar në këtë periudhë. Disa nga sfidat, të cilat ai do t’i përballonte me sukses janë edhe ndihmesa e organizatave, të cilat i mbronin interesat e popullit shqiptar. Pra, Asim ef. Luzha, i ndihmoi këto organizata në formë të ndryshme, ose edhe duke u bërë pjesë e tyre. Studiuesi Dobruna, e ka trajtuar rolin e Asim ef. Luzhës, në këto organizime. Disa nga këto, me të cilat bashkëpunoi Asim ef. Luzha ose u bë pjesë e tyre ishin:

- *Komiteti Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës*, i themeluar në muajin maj të vitit 1918 me qendër në Shkodër, i cili udhëhiqej nga veprimtari e patrioti Hoxhë Kadri Prishtina. Në Gjakovë ishte themeluar edhe dega e këtij Komiteti. Prandaj, Asim ef. Luzha, pasi kishte edhe njohje familjare me disa nga pjesëtarët e këtij Komiteti, ai do të merrte pjesë aktive në këtë organizatë, duke denoncuar padrejtësitë që po i bëheshin popullit ku po shërbente ai, duke e ndihmuar këtë organizim, me të mira materiale dhe duke i bindur zejtarët e Gjakovës që ta përkrahnin atë etj.

- *Xhemijeti*, kjo parti, siç edhe është e ditur, u formua me qëllim që të mbroheshin interesat qytetare të shqiptarëve të robëruar në Mbretërinë SKS, më 17 dhjetor 1919 në Shkup, në prani të një numri të konsiderueshëm pjesëmarrësish, dhe drejtohej nga Nexhip dhe Ferhat Draga. Asim ef. Luzha, në zgjedhjet që u mbajtën më 1925 e përkrahu për deputet Aqif Blüten. Edhe në këtë organizim, veprimtaria e Asim ef. Luzhës është e dukshme, aktiv si me rastin e Komitetit Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës.

- *Ulema Mexhlisi i Shkupit*, ky institucion ishte themeluar në bazë të ndryshimeve kushtetuese të kohës. Pushteti i atëhershëm kërkonte me metodat e veta ta fuste nën



kthetrat e veta edhe këtë organizim, duke instaluar elemente pro-serbe. Përkitazi me këtë, Asim ef. Luzha, së bashku me intelektual të tjerë shqiptarë, si Ferhat bej Draga, Hasan Shukriu, Kadri Salihu, Zenel Strazimiri etj., duke e parë rrezikun që mund t'i kanosej vendit, përmes këtyre elementeve destruktive, më 1936, kërkuar që Bashkësinë Fetare Islame në Shkup ta udhëhiqnin shqiptarët. Në zgjedhjet e mbajtura më 1937, në udhëheqjen e këtij organizimi do të futen emrat e listës së prirë nga Asim ef. Luzha dhe vëllezërit Draga me shumë patriot të tjerë të kohës. Falë angazhimit të Asim ef. Luzhës me shokë, brenda këtij organizimi, do të futeshin një numër patriotësh shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe mulla Idriz Gjilani. Të gjitha këto janë të sqaruara në detaje nga studiuesi Dobruna në këtë studim.

Përveç organizimeve të lartcekura, Asim ef. Luzhën, e gjejmë edhe në organizimet politike dhe luftarake deri në vrasjen e tij, për të cilat aspekte studiuesi Dobruna ka ofruar informacione të konsiderueshme. Ai dallohet me kontributet në këtë drejtim si:

-*Deputet i Drenicës më 1938.* Në vjeshtën e vitit 1938 në Jugosllavinë e atëhershme u

Megjithatë,
sipas të gjitha
feve
monoteiste
– Judaizmit,
Krishterimit
dhe Islamit –
besimi i parë i
njeriut ka qenë
monoteizmi,
besimi në një
Zot të vetëm.

organizuan zgjedhjet parlamentare. Asim ef. Luzha, me propozimin e veprimtarit mulla Iljas Broja dhe me porosi të veprimtarit Ferat Draga, u propozua për deputet nga kjo zonë. Asim ef. Luzha edhe përkundër sfidave në këtë garë, arrin të fitojë përball dy kundër kandidatëve serbë. Si deputet, së bashku me veprimtarët e tjerë, Asim ef. Luzha, “në parlamentin e Mbretërisë Jugosllave të viteve 1938-1941, ushtruan ndikim në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve”, vë në dukje në mes të tjerash studiuesi Dobruna.


Asim Luzha gjatë Luftës së Dytë Botërore, radhitët në krahun e forcave Nacional Çlirimtare. Roli i këtij veprimtari shihet qartë në mbrojtjen e popullatës shqiptare, e sidomos asaj të Drenicës nga forcat çetnike partizane, veprime këto të cilat do t'i kushtojnë Asim ef. Luzhës edhe me eliminim e tij. Disa nga veprimet në mbrojtje të popullatës shqiptare gjatë kësaj periudhe nga studiuesi Dobruna janë të sqaruara në titullin: *Misioni i Asim Luzhës në Drenicë.*

-*Vrasja e Asim ef. Luzhës.* Studiuesi Dobruna këtë ngjaje e ka trajtuar me plotë të drejtë si titull të veçantë. Asim Ef. Luzha për shkak të qëndrimeve të tij, siç e vë në dukje edhe autori do të eliminohet më 30 janar të vitit 1945. Për këtë vrasje, studiuesi Dobruna ofron tri versione, por ai më i besueshmi mbetet eliminimi i tij, me plumb pas shpine në fshatin Terstenik të Drenicës, ku edhe varroset. Më vonë trupi i tij zhvarroset për obduksion nga pushteti i kohës, dhe hera e fundit e zhvarrimit të tij është kur zhvarroset nga Tersteniku dhe rivarroset në Gjakovë, ku prehet edhe sot trupi i tij.

Duhet potencuar se kjo monografi vjen edhe me rastin e 80-vjetorit të vrasjes së këtij veprimtari.

Studimi është i pajisur me përfundime, burimet e literaturës, të cilat i ka përdorur studiuesi për këtë studim, dhe radhitja është bërë sipas një metodologjie të konceptuar nga studiuesi Dobruna.

Në fund, themi se, ky studim, së bashku me kontributet e tjera shkrimore të botuara deri më sot për këtë personalitet, e plotësojnë mozaikun jetësor të Asim ef. Luzhës.



Pavarësia – guri kilometrik në historinë e shqiptarëve

Nuredin Nazarko

Populli shqiptar, si çdo popull, tjetër ka historinë dhe protagonistët e vet, me të metat dhe virtytet e tyre. Ka personazhe që kanë shkrirë jetën dhe pasurinë për të, ashtu sikundërse ka edhe personazhe që janë shkrirë për interesa meskinë.

Historia e popujve është histori e njeriut në miniaturë. Ngjizje, lindje, rritje, sfida, sëmundje, shërime, energji, ëndrra, vizione, pjekuri, maturi, realizëm, dështime, suksese, gëzime, trishtime, miqësi, hatërmbe-tje, armiqësi, kritika, dobësi, fortësi, vdekje dhe vazhdimësi përmes pasardhësve. Në të gjithë historinë e jetës nuk ka asnjëherë gjendje të kulluar në vazhdimësi. Njeriu është qenie e trazuar, trazim që shfaqet në çdo situatë jetësore ku i duhet të marrë vendime dhe të mbajë përgjegjësi, sidomos në situata kritike. Në thelb, njeriu i takon përpjekja për t'i bërë gjërat mirë.

Historia e popujve ngjyrosset nga karakteret që janë në pozita të marrin vendime, të drejtojnë punët e qeverisjes. Pa diskutim që edhe njerëzit në rendin zbritës të hierarkisë qeverisëse duke mbërritur deri te të qeverisurit, kanë rolin e tyre në historinë e një populli, në jetën e një kombi, sepse drejtuesit qeverisin mbi një popull dhe mbi një komb, që kanë tiparet e veta, karakterin e vet, specifika që nuk i gjen në një popull dhe komb tjetër. Secili popull ka historinë e vet. Nxjerr apo jo mësim prej saj, kjo është çështje thellimi e përsiatje mbi të kaluarën historike, gjë të cilën disa popuj ndoshta e kanë të vështirë ta realizojnë për të korrigjuar dhe përmirësuar vetveten, por jo të pamundur.

Ngjarjet dhe personazhet që lënë gjurmë në historinë e një populli nuk janë të rastësishëm, ashtu sikundërse asnjë njeri nuk është i

rastësishëm në këtë jetë. Jo çdo ngjarje dhe personazh historik është vetëm pozitiv apo vetëm shkëlqen. Edhe ai/ajo është njeri, dhe për rrjedhojë do të shfaqë tiparet dhe karakteristikat e personalitetit me të mirat dhe dobësitë e veta. Vend për kritika ka çdoherë, por personazhet historikë nuk mund të kuptohen dhe vlerësohen sa më drejt nëse nuk merren në konsideratë edhe rrethanat historike në të cilat janë rritur, edukuar dhe kanë vepruar.

Populli shqiptar, si çdo popull, tjetër ka historinë dhe protagonistët e vet, me të metat dhe virtytet e tyre. Ka personazhe që kanë shkrirë jetën dhe pasurinë për të, ashtu sikundërse ka edhe personazhe që janë shkrirë për interesa meskinë. Ka personazhe që janë lartësuar me qëndrimet e tyre, ashtu sikundërse ka dhe personazhe që janë zvetënuar po nga qëndrimet e tyre. As shqiptarët nuk mund t'i shpëtojnë natyrës njerëzore. Ka pasur dhe do të ketë idealistë deri në fund, e do të ketë edhe pragmatistë deri në fund. Për të parët jeta merr vlerë më të madhe kur tejkalon egocentrizmin, kurse për të dytët jeta vlen kur interesat meskinë janë boshti rreth të cilit vërtitet jeta.

Pavarësia nga Perandoria Osmane është një moment kthese në historinë e shqiptarëve. Është një moment dramatik për kohën kur erdhi dhe u realizua, pësjtjellues për vetë shqiptarët të shihnin të humbnin mbrojtjen e deriatëhershme ndaj planeve copëtuese të fqinjëve në adresë të tokave shqiptare, tragjike



për nga pasojat, të cilat edhe në ëndrrën më të keqe nuk i kishin parë, sfidues për qëndrimet që duheshin mbajtur në rrethanat e krijuara (humbja e Perandorisë Osmane në luftën e parë ballkanike). Çaste të vështira të cilat si gjithmonë do të skalitin historinë dhe protagonistët, duke i dhënë vendin që meriton secilit. Në kushtet e sotme, prej katedrave të rehatshme mund ta mprehim majën e lapsit e të çalltisim të shkruajmë mirë apo keq për protagonistët e pavarësisë, por akti i realizuar prej tyre ishte detyrë kombëtare, edhe pse erdhi në një moment tejet të pafavorshëm. Duhet kujtuar që vlera e vendimeve në kohë të vështira nuk është e njëjtë me vlerën e tyre në kohë paqeje. Qëndrimet koherente që synojnë të drejtën në kohë të vështira, janë nga më të vështirat, por tregojnë shumëçka për vlerat dhe personalitetin e njeriut.

Akti i shpalljes së pavarësisë ishte jo vetëm vepër e burrave që u mbledhën për të diskutuar fatet e kombit shqiptar, jo vetëm e atyre që hodhën firmën, por e të gjithë atyre që trasuan këtë rrugë me dije, përpjekje dhe mund për të mbrojtur tokat shqiptare nga planet copëtuese të shteteve ballkanike (Serbi, Greqi, Mali i Zi) me mbështetje dhe nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Shto këtyre rrethanave edhe apatinë xhonturke në krye të Perandorisë Osmane, që nuk vlerësuan me seriozitet rrethanat e krijuara në prag të Luftës së Parë Ballkanike, por me vizonin e tyre për perandorinë larg realitetit dhanë kontribut në shkërmoqjen e paparashikuar të ushtrisë osmane në Rumeli. Në të tilla rrethana, ata që e deshën këtë vend më shumë se xhepin e tyre, më shumë se

jetën e tyre, me zemër të madhe dhe njerëzore vepruan ashtu siç ishte më e mira në përputhje me rrethanat e krijuara.

Një qeverisje arbitrare e çliruar krejtësisht nga themelet e racionalitetit dhe lidhjet me traditën, tashmë nuk kërkonte ta ushtronte pushtetin me drejtësi e urtësi, por me dhunë e presion. Kishim dy rrugë përpara: ose të prisnim goditjen vdekjeprurëse mes rrapëllimës së shembjes së viganit osman, të konsideruar si të destinuar për të marrë fund, e të jepnim shpirt bashkë me të, ose duke e konsideruar kombin si synim themelor, të viheshim në lëvizje për të shpëtuar veten! Është e ditur se feja islame e mbështet rebelimin kundër një qeverie që e shtyn një komb drejt vorbullës së zhdukjes e që është e pafuqishme për ta ndaluar padrejtësinë, si dhe i urdhëron të pushtetshmit që gjenden në krye të atij kombi të udhëheqin lëvizjen e të përpiqen me çdo mënyrë për të mbrojtur jetën e kombit dhe për të shpëtuar pasurinë e tij. Me qëllimin për të kryer këtë urdhër fetar dhe detyrë qytetare, pasi u bëra të qartë, nevojën dhe i ftova, me deputetët e Beratit Ismail Qemal Beun, Aziz Pashë Vrionin, Hasan Bej Prishtinën, deputetin e Gjirokastrës Myfit Bej Libohovën dhe deputetin e Durrësit Esat Pashën, u mbledhëm në shtëpinë time dhe me dorën në Kuran, dhamë besën e lidhëm paktin se do të përpiqeshim me jetën e veten tonë për shpëtimin, për jetën dhe ekzistencën e kombit e të atdheut tonë. (Vlora, Syrja Bej. Shqipëria pasosmane 1912-1920. Shkup: Logos A, 2015, 107-108).

Një kuvend elitar, një qeveri e dalë prej kuvendit (shih: Vlora, Eqrem Bej. *Kujtime 1885-1925*. Tiranë: IDK, 310), një pleqësi e dalë po prej këtij kuvendi, dëshmi e dashurisë për vendin. Shenjues i bashkëpunimit ndërkrainor dhe ndërfetar me qëllim shpëtimin e kombit shqiptar nga planet shoviniste. Në një popull me shumicë të konsiderueshme të besimit islam, institucionet qeverisëse të dala nga Kuvendi i Vlorës kishin në përbërje të tyre edhe shqiptarë të besimit të krishterë, katolikë dhe ortodoksë, duke lënë si testament për ata që vijnë pas se Shqipëria, jo në kufijtë që u vendosën arbitrarisht, është e të gjithë shqiptarëve.

Pavarësia ishte rruga e re e vazhdimit të jetës, edhe pse tragjike për nga pasojat. Pavarësia është një gurthemel i fortë në historinë e shqiptarëve, një gur kilometrik që meriton vëmendje në çdo kohë për të kuptuar vlerën e njerëzve me zemër të madhe dhe kundërvlerën e zemërngushtëve meskinë. Është akt i unitetit përballë sfidave, është akt i bashkëpunimit për të mirën e përgjithshme përtej dallimeve në bindje politike, krahinore apo besime fetare.

Sot e gjithë ditën duhet të përsiatim mbi këtë ngjarje që shënon një kthesë të madhe në historinë e shqiptarëve. Të hulumtojmë mbi gjithë çfarë erdhi më pas si mundësi për të gjetur rrugët e korrigjimeve dhe përpjekjeve për të ecur me drejtësi e mirësi drejt së ardhmes, duke ruajtur vlerat, traditat, virtytet, bashkëpunimin me njëri-tjetrin si një lidhje mbrojtëse ndaj atyre që nuk e duan ngritjen dhe zhvillimin e shqiptarëve.

Krimet dhe masakrat serbe pas shuarjes së kryengritjes së shtatorit 1913

Qerim Lita

“Simbas kallëzimeve të ushtarëve e të oficerëve ndërmjet Kumanovës e Shkupit kanë vra 3.000 shqiptarë e në rrethet e Prishtinës 5.000 shqiptarë. Katundet shqiptare aneve e rrethit janë djegë krejt. Në ballë të asaj fushate krahas ushtrive pushtuese, qëndronte edhe Kisha Ortodokse”.

Me përfundimin e Luftës së Parë Ballkanike dhe pushtimin e më se 2/3 të tokave shqiptare nga ushtritë e aleancës sllavo-ortodokse, përkatësisht asaj serbo-malaziasë-bullgare-greke, në Kosovë dhe në trevat Lindore filloi një fushatë e egër dhe e dhunshme ndaj popullsisë së pambrojtur shqiptare. Gazeta “Përlindja e Shqipniës”, në një numër të saj shkruante se burgjet e Kosovës ishin mbushur me shqiptarë, të cilët torturoheshin më keq se në kohën e inkuizicionit. “Qeveritari i Shkupit, shkruante gazeta, Ceroniçi, një barbar i egër, ka shtënë tmerë në Shqiptarët dhe Bullgarët. I thërret në Qeveri e u thotë që do t’u shkurtojnë këmbët e kryet po të mos bëhen serbë. Gjithë këto veprohen edhe nga Malazestë.” Korrespondenti i luftës i një gazete daneze, nga Shkupi, persekutimet serbe ndaj popullsisë shqiptare në krahinat e Shkupit, Kumanovës e të

Prishtinës i përshkruante si vijon: “Taktika luftarake e serbëve në Maqedoni ka marrë karakterin e një masakrimi të përgjithshëm shumë të tmerrshëm. Ushtria po plotëson një luftë shkatërrimtare shumë barbare. Simbas kallëzimeve të ushtarëve e të oficerëve ndërmjet Kumanovës e Shkupit kanë vra 3.000 shqiptarë e në rrethet e Prishtinës 5.000 shqiptarë. Katundet shqiptare aneve e rrethit janë djegë krejt. Populli po gjurmohet ndër shtëpitë e veta edhe po i vrasin si mijt. Militaristët serb këtë gjueti njerëzish e kallëzojnë me një shkëlqim të jashtëzakonshëm. Konditat e jetës në Shkup janë të tmerrshme...”.

Është e rëndësishme të vihet në dukje fakti se në ballë të asaj fushate krahas ushtrive pushtuese, qëndronte edhe Kisha Ortodokse dhe organizatat e shumta terroriste serbe e malazeze. Komuna e Deçanit, më 5 shkurt 1944, në mënyrë të hollësishme i raportonte



Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë, për mizoritë dhe barbarizmat serbe dhe malazeze në vendbanimet e asaj komune që nga viti 1912 e këndeje. *“Barbarizmat që elementi sllav, thuhej në raport, ka ba në rajonin e kësaj Komune gjatë kohës që mizorija ka sundue këtë vend janë të panjohura e aq të pashembullta saqë nuk ka mundësi të përshkruhen. Grabitjet, vrasjet përbinshat sllav ka kenë gjana të zakonshme. Ndër grabitjet në vendin e parë e xen Kisha e Deçanit e cilla ku ka vue synin e pasurisë shqiptarve ka vue edhe dorë në te, kështu që veprimi i sajë ka kenë gjithmonë në dam të Shqiptarëve...”*

Krimet, masakrat dhe mizoritë e ushtrisë serbo-malazeze, asaj kohe u shtrinë edhe në viset e tjera të pushtuara shqiptare, si në Shkup, Kumanovë, Prishtinë, Sanxhak etj.. Sekretari politik i Prefekturës së Prishtinës, Mahmut Çela, me 5 janar të vitit 1943, i raportonte MPB-së, mbi masakrat që ushtria serbe i kishte kryer gjatë viteve 1912-1913 në fshatrat të rretheve të Kumanovës, Gjilanit, Vitisë, Kamenicës dhe Ferizajt, përkatësisht në: Kabash, Komogllavë, Smirë, Gjylekar, Germovë, Drobesh, Beguncë, Vërban, Kërbliç, Dobërçan, Tërnoc, Gushicë, Gumnishtë, Gadish, Maroc, Dragofcë, Berivojcë, Koretin, Mekresh, Kostadicë, Mogillë, Tërstenë e shumë fshatra të tjera, ku siç bëhet e ditur ishin vra me pushkë apo therur me thikë, mijëra civilë shqiptarë, në mesin e tyre edhe gra dhe fëmijë. Po kështu u veprua edhe në vendbanimet e Suharekës, Prizrenit, Gjakovës etj.. Në katundin Babaj Bokës të Gjakovës, ushtria serbe gjatë vitit 1912 dogji 64 shtëpi dhe fshatarëve ua konfiskoi tërë pasurinë përfshi edhe bagëtinë dhe vrau 9 burra, 2 gra, ndërsa 10 fëmijë i dogji në zjarr për së gjalli. Ky krim i shëmtuar erdhi pasi paraprakisht disa banorë të këtij fshati në krye me Jan Salihun, kishte vra 5-6 ushtarë të një patrulle të ushtrisë serbe, e cila kishte tentuar të futej në fshat me qëllim të plaçkitjes të pasurisë së tyre.

Mizorive dhe barbarizmave serbe dhe atyre bullgare nuk i shpëtoi as popullsia shqiptare e Kërçovës. Në pranverë të vitit 1913, disa grupe komitësh dhe çetnikësh serbë dhe bullgarë, të udhëhequr nga Mihalj Brodi dhe Stanku Dimitru, pasi e rrethuan qytetin morën të gjithë burrat shqiptarë dhe i dërguan në tre vende të caktuara si thertore (dajakhane): “Çiflik” që gjendej në afërsi të shkollës bullgare; “Biçincë – Jurije” si dhe në shkollën fillore në qendër të qytetit. Shumë nga ata janë vrarë me pushkë, një pjesë tjetër janë therur me

“Shqiptarët ma të mirë janë therun, disa me pushkë janë vramun e ma shumë me dru janë rahun prej të cillavet shumica mbas disa kohrash kanë vdekur...”

20 korrik 1942

thikë, ndërsa ka edhe nga ata që kanë vdekur nga të rrahurit me dru. Kryetari i Bashkisë së Kërçovës, në raportin e datës 20 korrik 1942 dërguar Nënprefekturës së Kërçovës, ndër të tjerave shkruante se, tërë kjo situatë kishte zgjatur rreth dy muaj, gjatë së cilës *“... Shqiptarët ma të mirë janë therun, disa me pushkë janë vramun e ma shumë me dru janë rahun prej të cillavet shumica mbas disa kohrash kanë vdekur...., çetnikët-komitët i ngarkojshin me araba dhe i gropojshin rreth qytetit me disa gropa qi ishin pregatitun apostafat për këtë qëllim dhe këta gropa ende sot janë ku pushojnë kockat e këtyre shqiptarve...Kjo ka qenë një jav e zez për të mjerët shqiptarë, sepse thereshin si kundra kasapët kur therin qingjet në thertore.”*

Masakra të tilla dhe të ngjashme, gjatë viteve 1912-1913, u kryen thuajse në tërë hapësirën e pushtuar shqiptare dhe për pasojë mbi 150.000 shqiptarë u detyruan t'i lëshonin vatrat e tyre për t'u vendosur kryesisht në Turqi. Lidhur me këtë, “Përlindja e Shqipëniës”, shkruante se gjendja e shqiptarëve që ishin vendosur në Stamboll ishte: *“Si ska ma keq! Robat copë copë; të pangrënë..., shumë nga ata i kanë mbyllur në xhamijën që quhet e Sirqexhis. Gjindarët dhe policët u-rinë reth e përqark me syngji në pushkë, se mos ikin...”*

Ndërkohë, pas ultimatumit të marrë nga Fuqitë e Mëdha (gusht 1913), që trupat serbe të tërhiqeshin brenda kufijve të përcaktuar në

Konferencën e Londrës, Qeveria serbe, si kundërpërgjigje, shtetasve shqiptarë ua ndaloi shfrytëzimin e tregjeve në Dibër, Prizren dhe Gjakovë. Një vendim i tillë revoltoi tej mase popullsinë lokale, e cila revoltë së shpejti kaloi në një kryengritje të përgjithshme kundër pushtuesit serb. Zyrtarët politik dhe ushtarak serb nga Shkupi, Manastiri, Ohri, Prizreni, raportonin për një lëvizje të madhe që dukej në horizont. Shtytje të madhe lëvizjes i jepnin shqiptarët në krye me Isa Boletinin, Elez Isufin, Bajram Currin etj.. Ky i fundit, në një deklaratë dhënë korrespondentit të “*Alnasische Korrespondenz*”, ua bëri me dije Fuqive të Mëdha, se shqiptarët nuk marrin asnjë barrë përsipër, për “luftërat” që mund të shpërthejnë së shpejti.

“Neve, shprehet Boletini, ju tham qeveritarët të Romës, të Vjenës, të Parizit dhe të Londrës që populli ynë kurrë nuk mund të durojë të copëtohet. Pas trembëdhjetë kryengritjeve të përgjithshme, në të cilat derdhëm kaq gjak për lirinë tonë, na dha më në fund Evropa ç'varjen tonë (pavarësinë tonë – Q.L.). Por gjysmë më të madhe të kombit, duanë t'i ja bëjnë

theror armiqve. Kosova, zëmra e Shqipëniës, po na humbet. Fiset e Hotit e të Grudës, të cilat luftuan kaq trimërisht për çështjen shqiptare, po i japin Malit t'Zi. 34 qytete shqiptare u dhanë në duartë e armiqve tanë. Me gjithë këtë, sërëbët po i vdesin unit malësorët. Ju mbajtën udhët për në Gjakovë, Prizren dhe në të gjitha pazaret e tjera, me të cilat rnojnë, dhe në qoftë se ndonjë merr rugën për në qytet, menjëherë vriten. Na shqiptarët duamë paqe; po duhet të mprojmë veten në qoftë se popullin t'onë e copëtojnë, e vdesin unit dhe e vrasin”.

Kryengritja filloi natën e 18/19 shtatorit 1913 në rrethin e Peshkopisë. Kryeshefi i qarkut të Dibrës, përmes telegrameve të 7 (20) dhe 8 (21) shtatorit, njoftonte se “rreth Peshkopisë po zhvillohen luftime me shqiptarët”. Më 9 (22) shtator, Ministria e Punëve të Brendshme të Mbretërisë serbe, njoftonte se “shqiptarët janë 10 kilometra në afërsi të Dibrës” ndërsa “Peshkopia dhe Zhirovica janë marrë”. Më 20/21 shtator, rreth 6.000 kryengritës kaluan Drinin e Zi dhe u futën në qarkun e Dibrës. Kryengritësit fillimisht çliruan Peshkopinë dhe më pas edhe Dibrën dhe Zhirovicën. Më 26 shtator 1913, Aqif Pashë Elbasani i telegrafonte Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, se forcat shqiptare ishin ndarë në tre krahë: krahu kah Gostivari kishte çliruar Mavrovën dhe shpresohej se deri në mbrëmje ta çlironte edhe Gostivarin; krahu që marshonte për Kërçovë kishte kaluar Loposhin, dhe krahu i

“Nuk kam kohë t’ju shkruaj gjatë, por mund t’ju them që këtu po ndodhin gjëra ngjethëse. Unë jam i tmerruar prej tyre dhe vazhdimisht pyes veten time se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë, sa të kryejnë mizori të tilla.”

Letër e një ushtari serb

tretë, i ishte afruar Strugës. “...Me ndihmën e Perëndisë, shkruante Aqif Pasha, sukseset po vazhdojnë. Të tre krahët e përmendur, lajmërohem se përbëhen prej 12.000 vetësh, dhe po luten e thërasin çdo minut për armë dhe municion...”. “Perlindja e Shqipniës”, më 21 shtator (4 tetor) 1913, përcillte njoftimin e korrespondentit të “*Algemeine Zeitung*” nga Shkodra, ku thuhej se çetat shqiptare të udhëhequra nga Isa Boletini dhe Bajram Curri e mposhtën ushtrinë serbe në Dibër dhe në afërsi të Prizrenit, dhe se në Beograd ishte përhapur lajmi se “Shqiptarët hynë në Tuz duke dëbuar ushtarët malazez që gjendeshin atje”. Tri ditë më vonë, inspektori i policisë serbe nga Shkupi, njoftonte se shqiptarët ishin nisur në dy drejtime: një kolonë nga Elbasani për në Ohër, ndërsa e dyta nga Dibra për në Strugë, dhe se shqiptarët e kishin marrë Mavrovën. Edhe kryeshefi i Qarkut të Prizrenit bënte me dije se shqiptarët nga Shqipëria kishin filluar të kalojnë nga ana e majtë e Drinit të Zi në krahinën e Lumës dhe të grumbullohen në masa më të mëdha të fshatit Ratkajë. Plani i tyre ishte të koncentroheshin për ta sulmuar Prizrenin.

Menjëherë pas sulmit të befasishëm në Dibër dhe më pas edhe në Strugë, Ohër, Prizren, Gjakovë dhe në qendra të tjera, Qeveria serbe vendosi të mobilizojë divizionin e Moravës, përkatësisht, njësitë e saja të këmbësorisë I, II, III dhe XIV. Më 29-30 shtator 1913, filloi kundërofensiva e ushtrisë



dhe e çetave çetnike serbe. Në luftimet disa ditore, ushtria serbe e pajisur me armatim bashkëkohor, arriti t'i thyej forcat kryengritëse fillimisht në frontin e Strugës, Ohrit dhe Dibrës, e më pas edhe të Prizrenit dhe Gjakovës. Forcat ushtarake serbe pasi ripushtuan tokat shqiptare, kryen gjenocid të paparë ndonjëherë mbi popullsinë civile shqiptare. Radničke Novine, më 22 tetor 1913, botoi letrën e një ushtari serb, në të cilën veç të tjerash thuhej: *"Nuk kam kohë t'ju shkruaj gjatë, por mund t'ju them që këtu po ndodhin gjëra ngjethëse. Unë jam i tmerruar prej tyre dhe vazhdimisht pyes veten time se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë, sa të kryejnë mizori të tilla. Është e tmerrshme, unë nuk guxoj t'ju them më shumë, por mund t'ju them se Luma nuk ekziston më. Ka fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë, dyqind shtëpi ku nuk ka ma asnjë burrë, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës asnjë. Ne i grumbulluam ata në grupe nga dyzet deri në pesëdhjetë veta dhe pastaj i shpuam me bajoneta tona..."*

Vrasjet masive të popullsisë civile dhe djegiet e vendbanimeve të tëra ishin të shumta. Sali Hoxhë Vuçitërna, i shkruante Luigj Gurakuqit, për përfundimin e luftës së përgjithshme, dhe se Hysni Curri është kthyer, dhe se *"...Krasniqja, Gashi, Hasi, Bytyçi janë djegë fare. Robni e madhe ash tuj ardhë këtu."* Dokumentet e kohës që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë, hedhin dritë mbi mizoritë, barbarizmat dhe masakrat e kryera nga ana e ushtrisë pushtuese serbe ndaj popullsisë civile shqiptare të fshatrave të: Prizrenit, Gostivarit, Tetovës, Kërçovës, Gjilanit, Pejës, Deçanit, Ferizajt, Prishtinës etj.. Kryetari i komunës së Lubizhdës, më 10 janar 1944, i raportonte MPB-së, për një masakër që ushtria serbe e kishte kryer në vitin 1913 në fshatin Kabash, ku ishin masakruar 72 burra të këtij fshati. Të gjithë ata, janë marrë nga ushtria serbe dhe janë pre me sëpatë te kisha e fshatit. Po atë ditë, komandanti i vullnetarëve serb, Spiro Delloci nga fshati Delloc i komunës së Mushtishtit, dogji për së gjalli bashkëshorten e Ali Hajdarit si dhe Hakën e Muharrem Rexhepit, që të dyja nga fshati Kabash. Në të njëjtën kohë, krimineli Spiro Delloci, masakroi 8 shqiptarë nga fshati Korishë, ndërsa nga ana e ushtrisë serbe, u morën Pren dhe Zef Çeta dhe u masakruan, i pari te kisha e Kabashit, ndërsa i dyti në afërsi të Prizrenit. Nën kryetari i komunës së Banjës, Rexhep Banja, në raportin e 3 nëntorit 1944 dërguar MPB-së, duke i përshkruar krimet dhe masakrat serbo-malazaze ndaj popullsisë shqiptare të atij rrethi gjatë viteve 1912-1913, ndër të tjerave shkruante: *"...Nuk mjaftonte shkelja serbo-malazeze në tokën shqiptare, por edhe tmerr u kish andja të shtirshin nëpër katunde e vaj e zi nëpër familje. Shtëpijat e djegura me sa pasunina kishin asht e kot me e diftue mbassi sdo të mbarofshin kurr, por po shënojmë dëshmorët e rrajonit të Komunës së Banjës, të cilët na lanë me betim një fjalë ta mbajmë e asht: MIKUT FALI ZEMRËN, ARMIKUT SHEKULLUER PLUMIN."*

Masakra të tilla ushtria serbe kreu edhe në fshatrat e Gostivarit, si në: Simnicë, Gjenovicë, Reçan, Vërtok, Raven,

Zdunje, Mirditë, Vrapçisht, Kalisht, Çegran, Qafë, Llakavicë dhe Duf. Në të gjitha këto vendbanime, siç theksohet në dokument, ushtria pushtuese serbe, në bashkëveprim me komitet dhe çetnikët vendor serbë e bullgarë, në pjesën e dytë të muajit tetor 1913, vrau, theri me thikë apo me sëpatë disa qindra shqiptarë civil, në mesin e tyre edhe gra, pleq e fëmijë. *"...Ka qenë muaji i tetorit të vitit 1913, thuhet në dokument, kur prej katundeve Simnicë, Zdunjë, Raven, Vërtok Reçan etj., sillnin burrat shqiptar dhe i thernin pa pikë mëshire duke i hedhun në një gropë qi ndodhet në t'hymen e katundit, duke ardhur prej Gostivari. Të gjithë burrat janë ther me thikë dhe me spata duke i pasun duart e lidhura..."*. Ndër vendbanimet që pësuan më së keqi duhet veçuar Simnicën, ku siç theksohet në dokument, ushtria serbe, pasi dogji tërë fshatin, mori 48 burra dhe dy gra dhe i dërgoi *"...në vëndin e quajtn Vakuf të Banicës dhe këtu i therën të gjithë me thikë bashkë me shqiptarët e tjerë t'ardhun prej katundeve të ndryshme dhe i hodhën në një gropë e cila gjendet edhe sot në vëndin e lart-përmendun..."*

Burimet dhe literatura e shfrytëzuar:

1. "Barbarizmat serbe, greke, malazeze", "Përlindja e Shqipëniës", 28 gusht (10 shtator) 1913.
2. AQSH. F.846.V.1919.D. 35/2. Fl.39.
3. AQSH.F.410.V. 1944. Fl. 3-4.
4. AQSH.F.164.V.1943.Fl.46-55.
5. AQSH.F.410.V.1944.Fl.16.6.
6. Po aty, Fl. 2.
7. ДАРМ.Ф.Општина Кичево 1941-1944, кут. 2, Raport i kryetarit të Bashkësisë së Kërçovës, dërguar Nënprefekturës së Kërçovës mbi krimet dhe mizoritë serbe e bullgare ndaj popullsisë shqiptare të Kërçovës me rrethinë, midis periudhës 1912-1941.
8. AJ.370.22/334-335, Raport i konsullit jugosllav në Stamboll, dërguar ministrit të Jashtëm në Beograd, Vojislav Marinković.
9. "Përlindja e Shqipëniës", 7/20 Dhjetor 1913.
10. ДАРМ.1.18.5.214/414-424.
11. Xheladin Shala, *Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1916-1912*, Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave historike (26), Instituti Albanologjik, Prishtinë 1997, f. 139-140.
12. "Përlindja e Shqipëniës", 21 gusht/3 shtator/1913, f. 3-4.
13. Halim Purellku, *Zona e pushtimit Jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*, Instituti i Historisë, Tiranë 2012, f. 17-19.
14. Po aty.
15. ДАРМ.1.766.27.92/419-422.
16. AQSH.F.145.V.1913.D.II-52.Fl.32.
17. "Përlindja e Shqipëniës", 21 shtator/4 tetor/1913, f. 5.
18. Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës (më tej ASHAK), Arkivi Diplomatik i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme – Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, Реферат о упаду Арнаута, 95/1-4.
19. ДАРМ.1.18.5.214/414-424.
20. Po aty.
21. "Радничке Новине", 22 септембра 1913 год. Београд.
22. ASHAK. A. Diplomatik i SFPJ-së, po aty.
23. AQSH. F. 410. V.1944.D. 58. Fl. 1-3.
24. Po aty. Fl.6.
25. AQSH. F. 412. V. 1944. D. 8, Fl.1-13.
26. Po aty.

Manipulimet ideologjike rreth rrënjëve të shqiptarëve – reflektim i shkurtër

Dr. Agron M. Rexhepi

Ilirët dhe pellazgët ishin shoqëri *pagane*, që besonin në shumë perëndi, njësoj si grekët, romakët dhe popujt e tjerë të botës antike.

HYRJE

Kohët e fundit, në Kosovë dhe trojet shqiptare, janë shfaqur individë dhe lëvizje që, nën petkun e “shqiptarizmit” dhe “kthimit të rrënjët”, tentojnë të krijojnë një narrativë të re mbi identitetin tonë. Këto qasje shpesh synojnë të shkëpusin shqiptarët nga Islami, duke e paraqitur si diçka të huaj dhe duke e barazuar kombëtarizimin vetëm me një fe tjetër. Në të vërtetë, këto janë *manipulime ideologjike*, që nuk kanë bazë as në histori, as në shkencë dhe as në moral.

Tema e rrënjëve të shqiptarëve dhe manipulimeve ideologjike është tepër e gjerë dhe kërkon trajtim të hollësishëm. Ky shkrim paraqet vetëm një reflektim të shkurtër, me qëllimin e vetëm, për të ofruar disa pikëpamje të menjëhershme mbi këtë çështje.

PREJARDHJA ILIRO-PELLAZGE DHE EVOLUCIONI FETAR

Shqiptarët njihen gjerësisht si pasardhës të *ilirëve*, një popull i lashtë ballkanik, që vetë kishte origjinë të hershme *pellazge*. Historianët si Eqrem Çabej dhe Aleks Buda kanë theksuar autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan si një fakt të pakontestueshëm.

Por, duhet theksuar se ilirët dhe pellazgët ishin shoqëri *pagane*, që besonin në shumë perëndi, njësoj si grekët, romakët dhe popujt e tjerë të botës antike. Megjithatë, sipas të gjitha feve monoteiste – Judaizmit, Krishterimit dhe Islamit – besimi i parë i njeriut ka qenë monoteizmi, besimi në një Zot të vetëm.

Në Judaizëm, libri i Zanafillës nis me fjalët: “Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën.” (Zanafilla 1:1).

Në Krishterim, Jezu Krishti, thekson: “Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot.” (Marku 12:29).

Në Islam, Kurani pohon: “Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje, veçse i shpallëm se nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni Mua.” (El Enbija, 25).

Kjo tregon se monoteizmi ishte feja e zanafillës së njerëzimit, ndërsa paganizmi u shfaq si devijim i mëvonshëm, në periudha të caktuara të hershme, kur njerëzit humbnin udhëzimin hyjnor. Në këtë kuptim, politeizmi i ilirëve dhe pellazgëve nuk ishte “origjina” fetare e shqiptarëve, por një *fazë kalimtare e devijuar* që, si gjithë popujt e botës, edhe ata e kapërcyen me ardhjen e feve monoteiste.

KATËR LLOJET E VËLLAZËRISË

Islami i jep kuptim marrëdhënieve njerëzore përmes katër llojeve të vëllazërisë:

Familjare – vëllazëria nga babai dhe nëna,

Kombëtare – vëllazëria e gjakut dhe gjuhës, që na lidh si shqiptarë,

Universale – vëllazëria e gjithë njerëzimit, sepse të gjithë vijnë nga Ademi dhe Havaja: “O njerëz! Ne ju krijuam prej mashkulli e femre dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni mes vete. Më fisniku prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshëm.” (El Huxhurat, 13),

Fetare – vëllazëria që lind nga besimi, e vetmja që është zgjedhje e lirë e njeriut.

Tri të parat janë të përcaktuara nga Allahu pa vullnetin tonë; vetëm vëllazëria fetare është rezultat i zgjedhjes së vetëdijshme.

MANIPULIMET IDEOLOGJIKE MODERNE

Ideologjitë komuniste të shek. XX tentuan ta shndërronin fenë në “armik” dhe kombin në ideologji absolute. Sot, disa qarqe të reja po tentojnë të ringjallin këtë frymë, duke thënë: “Shqiptarizmi është feja jonë”. Në dukje kjo tingëllon patriotike, por në thelb është *ndarëse dhe mashtruese*, ngase:

- Përrjashton Islamin nga historia e shqiptarëve, ndonëse shumica dërrmuese e shqiptarëve janë myslimanë,
- Ngatërron rolin e kombit me rolin e fesë,
- Synon të krijojë një identitet artificial dhe përçarës.

Në realitet, Islami ka qenë shtylla që e ka mbajtur të gjallë gjuhën, kulturën dhe unitetin e shqiptarëve në periudha të vështira historike.

PYETJA TABU: “CILA ËSHTË MË E RËNDËSISHME, KOMBI APO FEJA?”

Kjo pyetje shpesh përdoret nga ideologë ateistë me ‘ngjyra komuniste’ për të krijuar tension. Në fakt, është një pyetje e gabuar.

Kombi është dhuratë nga Allahu, nuk e zgjedhim dot, as gjuhën, as gjakun, as vendin ku lindim.

Rrënjët e shqiptarëve janë të qarta: një popull autokton që ka kaluar nga paganizmi në monoteizëm dhe që e gjeti veten në Islam.

Feja është udhëzim hyjnor, është zgjedhja që i jep kuptim jetës dhe drejtim kombit.

Nuk ka konflikt mes të dyjave: pa fe, kombi humb moralin; pa komb, feja nuk mishërohet në kulturë. Siç thotë Pejgamberi Muhamed a.s.: “*Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë, ku një pjesë e saj e forcon tjetrën.*” (Buhariu dhe Muslim).

Shembuj nga historia shqiptare

Hasan Prishtina, Isa Boletini dhe Hoxhë Kadri Prishtina, së bashku me Abdyl Frashërin, Naim Frashërin, Sami Frashërin, Ymer Prizrenin, Sylejman Vokshin, Hoxhë Tahsinin, Shuaip Spahiun, Aqif Pashë Elbasanin dhe shumë figura të tjera të mëdha me identitet islam, kontribuan fuqishëm për kombin shqiptar.

Harmonia ndërjetare shqiptare, e njohur ndërkombëtarisht, është arritur kryesisht falë kulturës islame të tolerancës.

Islami nuk i ka mohuar rrënjët shqiptare, përkundrazi i ka forcuar ato me vlera morale dhe shpirtërore.

PËRFUNDIMI

Rrënjët e shqiptarëve janë të qarta: një popull autokton që ka kaluar nga paganizmi në monoteizëm dhe që e gjeti veten në Islam.

Tentativat moderne për ta ndarë kombin nga feja janë *manipulime ideologjike*, që rrezikojnë unitetin dhe identitetin tonë. Detyra jonë është ta mbrojmë të vërtetën historike dhe shpirtërore, ta forcojmë vëllazërinë dhe ta ndërtojmë një shoqëri ku kombi dhe feja ecin bashkë, jo ndaras dhe as kundër njëra-tjetrës.

Referenca:

- Kurani Famëllartë, El Bekare (2:195); En Nisa (4:29); El Huxhurat (49:13).
- Sahihu i Buharit dhe Sahihu i Muslimit, kapitujt për vëllazërinë dhe forcën e besimtarit.
- Ibën Kajim el Xheuzijje, *Tuhfat al Maudud bi Ahkam al- Maulud*.
- Çabej, Eqrem (۱۹۸۴). *Studime gjuhësore*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Buda, Aleks (1972). *Shqiptarët dhe Ilirët*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Clayer, Nathalie (2007). *Aux origines du nationalisme albanais*. Paris: Karthala.
- Malcolm, Noel (1998). *Kosovo: A Short History*. London: Macmillan.
- Schmitt, Oliver Jens (2009). *Histori e Shqipërisë*. Tiranë: Toena.



U mbajt Konferenca “*The Role of Muslim Scholars and Intellectuals in Europe – Roli i studiuesve dhe intelektualëve myslimanë në Evropë*”

Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës në bashkëpunim me Qendrën për Studime të Avancuara në Sarajevë, më 3 dhe 4 tetor 2025, organizuan Konferencën Ndërkombëtare me titull: “*The Role of Muslim Scholars and Intellectuals in Europe – Roli i studiuesve dhe intelektualëve myslimanë në Evropë*”.

Në kontekstin bashkëkohor evropian, studiuesit dhe intelektualët myslimanë luajnë një rol vendimtar në formësimin e diskursit fetar, nxitjen e dialogut ndërfaqetor, adresimin e sfidave socio-politike dhe kontributin në debatet akademike dhe publike. Angazhimi i tyre është thelbësor në kundërshtimin e stereotipave, mbrojtjen e drejtësisë sociale dhe sigurimin që mësimet islame të mbeten të rëndësishme për peizazhin e larmishëm dhe në zhvillimin evropian. Duke pasur parasysh dukshmërinë në rritje të myslimanëve në Evropë dhe sfidat me të cilat përballen, kjo Konferencë kishte për synim që të eksplorojë kontributet, përgjegjësitë dhe sfidat e studiuesve dhe intelektualëve myslimanë në shoqëritë evropiane.

Historikisht, intelektualët myslimanë kanë ndikuar në mendimin evropian në fusha të ndryshme, nga filozofia dhe shkenca, deri te teologjia dhe ligji. Sot, ata vazhdojnë të angazhohen me çështje të tilla si identiteti, integriteti dhe pluralizmi fetar. Diskursi mbi Islamin në Evropë shpesh formësohet nga narrativa të jashtme; prandaj, është thelbësore të përfordohen zërat e dijetarëve myslimanë që kontribuojnë në diskutimet akademike, fetare dhe publike në një mënyrë të informuar dhe konstruktive.

Konferenca Ndërkombëtare mbi rolin dhe kontributin e studiuesve myslimanë në Evropë filloi në Prishtinë më 3 tetor 2025. Kjo

Konferencë, siç u theksua në titull, u organizua nga Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Islame dhe Qendrën për Studime të Avancuara në Sarajevë.

Konferenca synoi të promovojë kërkimin shkencor, të nxisë dialogun kulturor dhe të ndërtojë ura bashkëpunimi në Evropë, duke afirmuar njëkohësisht pozicionin e Kosovës si një qendër kryesore akademike dhe kulturore.

HAPJA ZYRTARE DHE FJALIMET KRYESORE

Në fjalën e tij të hapjes, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përshëndeti pjesëmarrësit, duke theksuar rëndësinë e shkencës në Islam dhe rolin e dijetarëve gjatë gjithë historisë në interpretimin e saktë të Kuranit të shenjtë dhe Hadithit.

Në vazhdim, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, prof. asoc. dr. Islam Hasani, në fjalën e tij, vlerësoi se kontributet e dijetarëve myslimanë në shkencë kanë qenë me ndikim të veçantë, e të cilët patën rëndësi edhe në zhvillimin e shkencave shoqërore, e që disa prej tyre veç janë harruar.

Nga ana e tij, dr. Ahmed Alibašić, drejtor i Qendrës për Studime të Avancuara në Sarajevë, u përqendrua në sfidat aktuale me të cilat përballen Evropa, duke e konsideruar



Kosovën një model të suksesshëm në menaxhimin e pluralizmit fetar dhe etnik.

SESIONET E KONFERENCËS

Në ditën e parë, sesionet e Konferencës paraqitën diskutime të gjera intelektuale dhe kulturore që trajtuan sfidat më të spikatura me të cilat përballen vlerat islame në Evropën bashkëkohore, ndikimin e diskursit fetar në ligjet civile perëndimore dhe rolin e arsyes kritike dhe eksperimentale në mendimin islam dhe krahasimin e saj me prodhimin filozofik perëndimor.

Hulumtuesit diskutuan gjithashtu rolin e dijetarëve myslimanë në pasurimin e kulturës evropiane, marrëdhënien midis Islamit dhe qeverisjes demokratike në Ballkan, qasjet metodologjike për promovimin e dialogut ndërfaqet dhe ndërkulturore, si dhe ndikimin e platformave digjitale dhe inteligjencës artificiale në kërkimin islamik në shoqëritë perëndimore.

Dita e dytë e Konferencës ofroi një pasqyrë të pasur intelektuale. Sesionet përfshinë diskutime akademike mbi çështjet e identitetit, integritetit, lidershit fetar dhe arsimit islam në Evropë, së bashku me tema mbi dialogun ndërfaqet dhe ndërkulturore dhe sfidat intelektuale në epokën digjitale. Pjesëmarrësit ofruan një angazhim të jashtëzakonshëm shkencor, duke ofruar njohuri të reja mbi zhvillimin e punës akademike islame në kontekstin evropian.

Gjatë ditës së dytë hulumtuesit shqyrtuan konceptin e identitetit islam në shoqëritë evropiane dhe se si myslimanët mund të jenë pjesë e strukturës së shoqërisë moderne pa humbur identitetin e tyre fetar dhe kulturor. Ndërhyrjet theksuan se Islami, me vlerat e tij të larta njerëzore, është një partner integral në ndërtimin e qytetërimit modern evropian.

Sesionet theksuan rolin jetësor të institucioneve fetare dhe arsimore në formësimin e vetëdijes islame evropiane dhe shqyrtuan shembuj të përvojave të suksesshme në arsim dhe udhëzim, duke theksuar se Bashkësia Islame e Kosovës

përfaqëson një model pionier në konsolidimin e vlerave të moderimit dhe përhapjes së kulturës së bashkëjetesës.

Hulumtuesit trajtuan ndikimin e hapësirës digjitale në mendimin islam dhe bënë thirrje për një prani aktive të institucioneve fetare në këtë fushë përmes një diskursi epistemologjik, që kombinon qëndrueshmërinë në vlera dhe hapjen ndaj mjeteve bashkëkohore.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu përvojat akademike në arsimin islam brenda Evropës, duke theksuar nevojën për të zhvilluar kurrikula dhe për t'i integruar ato me shkencat moderne humane.

Sesionet përfunduan me rekomandime që bënë thirrje për forcimin e bashkëpunimit midis universiteteve islame dhe qendrave kërkimore në Evropë dhe krijimin e rrjeteve të përbashkëta akademike, që kontribuojnë në formulimin e një diskursi të ripërtërirë islam që merret me çështjet bashkëkohore njerëzore pa kompromentuar parimet islame.

Konferenca, në thelbin e saj nuk ishte thjesht një ngjarje akademike, por më tepër një platformë intelektuale që kronikonte përpjekjet e studiuesve dhe mendimtarëve myslimanë në Evropën moderne, duke theksuar kontributet e tyre në konsolidimin e vlerave të dijes dhe komunikimit kulturor, dhe duke promovuar ndërgjegjësimin fetar bazuar në arsye dhe hapje.

Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës mori vlerësime të veçanta si një fanar shkencor që kombinon autenticitetin dhe modernitetin, duke diplomuar breza studiuesish që kombinojnë mendimin dhe ndërgjegjësimin për mesazhin qytetëruar të Islamit. FSI është një nga institucionet akademike më të shquara të specializuara në mendimin islam në Ballkan. Që nga themelimi i tij, ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në trajnimin e brezave të studiuesve, imamëve dhe studiuesve që kanë kontribuar në forcimin e identitetit fetar dhe kulturor të myslimanëve në vend.

Vedat Shabani



MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA PRESIDENTJA E KOSOVËS, ZNJ. VJOSA OSMANI – SADRIU



Më 16 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, është prituri në takim nga presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani – Sadriu.

Gjatë këtij takimi u diskutua për angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në forcimin e pozitës ndër-

kombëtare të shtetit, traditën e tolerancës ndërfetare dhe domosdoshmërinë e vazhdimin të kultivimit të saj.

Presidentja Osmani vlerësoi lart kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në kultivimin e harmonisë ndërfetare, e cila përbën një nga vlerat më të çmuara të shoqërisë kosovare dhe

një model i dallueshëm në rajon. Ajo theksoi se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe bashkësive fetare është thelbësor për një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSMINISTRIN E ARSIMIT TË REPUBLIKËS SË TURQISË, DR. NAZIF YILMAZ

Më 8 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim zëvendësministrin e Arsimit të Republikës së Turqisë, dr. Nazif Yılmaz, i cili po qëndronte për vizitë zyrtare në Kosovë.

Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve fetare dhe arsimore të të dy vendeve, me theks të veçantë në zhvillimin e arsimit islam, modernizimin e programeve mësimore dhe përgatitjen e kuadrove të reja profesionale.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme që Republika e Turqisë dhe Ministria e Arsimit i ofrojnë Bashkësisë Islame të Kosovës, veçanërisht në ngritjen e cilësisë arsimore, në bursat për studentët e medreseve dhe në projektet infrastrukturore që ndihmojnë



zhvillimin e institucioneve fetare në vend.

Nga ana e tij, zëvendësministri Yılmaz vlerësoi marrëdhëniet e mira ndërmjet dy popujve dhe theksoi rolin e rëndësishëm të Bashkësisë Islame në

edukimin moral e shpirtëror të brezave të rinj, duke shprehur gatishmërinë për zgjerimin e bashkëpunimit edhe në fushën e shkëmbimeve akademike dhe trajnimeve të përbashkëta.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËS PËRFAQËSUESIN SPECIAL TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM (PSRSG) TË UNMIK-UT, Z. MILBERT DONGJOON SHIN



Më 1 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendës përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSRSG) të UNMIK-ut, z. Milbert Dongjoon Shin.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë e uroi z. Shin për angazhimin e tij të ri në Kosovë, duke i dëshiruar punë të mbarë

dhe të suksesshme. Ai e njohu mysafirin me rolin dhe veprimtarinë e Bashkësisë Islame të Kosovës në sfera të ndryshme të jetës shoqërore, duke theksuar kontributin e saj në ruajtjen e paqes, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare në vend.

Nga ana e tij, z. Shin shprehu vlerësimin e lartë për punën e BIK-ut

dhe për rolin e saj në promovimin e dialogut dhe mirëkuptimit mes komuniteteve.

Në takim u bisedua gjithashtu për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet BIK-ut dhe UNMIK-ut në fusha me interes të përbashkët.

U MBAJT AKADEMIA SOLEMNE “40-VJET NGA BOTIMI I SHQIPËRUAR I KURANIT FISNIK”



Më 15 tetor 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, më saktësisht Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, organizoi Akademinë Solemnë kushtuar 40-vjetorit të botimit në gjuhën shqipe të Kuranit fisnik.

Ky jubile shënon një moment të veçantë historik për besimtarët myslimanët shqiptarë, pasi botimi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe në vitin 1985 përbën një nga arritjet më të mëdha në fushën e studimeve islame dhe të përhapjes së dijes fetare në gjuhën amtare.

Drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, theksoi se

kjo akademi solemnë është organizuar me qëllim që të vlerësohet kontributi i autorit të përkthimit, Feti Mehdiut.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, duke çmuar lart punën dhe angazhimin e Feti Mehdiut me përkthimin e Kuranit, tha se me një punë të tillë i ka shërbyer Islamit dhe atdheut.

Në anën tjetër, Hysen Matoshi, tha se përkthimi i librave të shenjtë shkon edhe përtej aspektit fetar, për shkak se ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në aspektin e emancipimit dhe formësimit të një shoqërie.

Autori i përkthimit të Kuranit, Feti Mehdiu, tha se ndjehet i lumtur që tash e 40 vjet Kurani në shqip lexohet i plotë dhe nga të gjithë.

Gjatë tubimit u theksua se, edhe pse më herët kishte pasur përpjekje dhe pjesë të përkthyer të Kuranit, përkthimi i plotë nga Feti Mehdiu në vitin 1985, shënoi një kthesë të madhe në historinë e përkthimeve islame në gjuhën shqipe, duke mundësuar që Fjala e Zotit të lexohet dhe kuptohet nga të gjithë besimtarët shqiptarë.

Në fund të Akademisë, u paraqit edhe një ekspozitë me botime të ndryshme të përkthimeve të Kuranit.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË FONDACIONIT MAARIF

Më 17 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Përgjithshëm të Fondacionit Maarif, z. Mehmet Nedim Aslan, me të cilin biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Myftiu Tërnavë vlerësoi lart kontributin e Fondacionit Maarif dhe theksoi rëndësinë e partneritetit të ndërsjellë për zhvillimin e arsimit. Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë për të mbështetur çdo iniciativë të ardhshme, që synon forcimin e bashkëpunimit dhe krijimin e mundësive më të mira arsimore për të rinjtë.

Nga ana e tij, drejtori i Fondacionit Maarif, z. Aslan, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar rëndësinë



e marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet dy institucioneve.

Në përfundim të takimit, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi

ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Fondacionit Maarif, e cila do t'u ofrojë të rinjve mundësi të reja dhe cilësore në arsimim.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË DRAGASHIT DHE KËSHILLIN E BI-SË PËR RAJONIN E GORËS

Më 21 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka zhvilluar një vizitë pune në Këshillin e Bashkësisë Islame të Dragashit dhe në Këshillin e Bashkësisë Islame për Rajonin e Gorës, ku është pritur nga kryetarët e Këshillave, Driton ef. Çengaj, respektivisht nga Munafis ef. Hoxha dhe administrata e tyre.

Gjatë takimeve, u diskutua për ecurinë e punëve në Këshilla, për zhvillimet në jetën fetare, si dhe për sfidat me të cilat përballen në terren gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre.

Myftiu Tërnavë vlerësoi angazhimin e imamëve dhe të strukturave të Bashkësisë Islame në këtë rajon, duke shprehur mirënjohje për përkushtimin dhe punën e tyre në shërbim të xhematit dhe ruajtjes së vlerave islame.

Ai theksoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet Këshillave



lokalë dhe Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në mënyrë që të sigurohet një funksionim sa më i mirë institucional dhe një organizim efikas i jetës fetare.

Myftiu Tërnavë, po ashtu, ofroi mbështetjen e plotë të Kryesisë për projektet dhe iniciativat e këtyre Këshillave, që synojnë përmirësimin e

kushteve të punës dhe lehtësimin e mbarëvajtjes së jetës fetare në Dragash dhe në Rajonin e Gorës.

Në përmbyllje të vizitës, Myftiu u shprehu falënderime për mikpritjen dhe i inkurajoi që të vazhdojnë me përkushtim në misionin e tyre fisnik në shërbim të fesë dhe shoqërisë.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BI-SË



Më 23 tetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka takuar kryetarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, me të cilët ka biseduar për ecurinë e punëve dhe sfidat me të cilat ata po përballen.

Në fillim të takimit, Myftiu Tërnavë, ka falënderuar kryetarët e Këshillave për punën dhe kontributin e vazhdueshëm që po japin në shërbim të besimtarëve dhe institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Gjatë këtij takimi u prezantua puna që është duke u bërë në ndërtimin e 23 xhamive nëpër qytete dhe fshatra të ndryshme të vendit, duke vlerësuar se këto projekte janë dëshmi e përkushtimit institucional për krijimin e kushteve më të mira për besimtarët.

Në takim u fol edhe për përgatitjet për muajin Ramazan, ku Myftiu Tërnavë kërkoj nga Këshillat që të intensifikojnë aktivitetet fetare, humanitare dhe vetëdijësuese në këtë periudhë të rëndësishme për besimtarët myslimanë.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë ka inkurajuar kryetarët e Këshillave që të vazhdojnë me përkushtim dhe përgjegjësi në detyrat e tyre, duke ruajtur unitetin dhe traditën e mirë të bashkëpunimit, tolerancës dhe frymën vëllazërore.

KOMUNIKATË PËR MEDIA



Sqarim lidhur me fushatën denigruese ndaj Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë

Ditëve të fundit, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, është bërë objekt i një fushate denigruese nga disa portale dhe emisione të ashtuquajtura “hulumtuese”, të cilat janë ngritur mbi shpifje, insinuata dhe pretendime krejtësisht të pavërteta.

Shkrimet e para për këtë çështje janë injoruar nga ana jonë, të bindur në të vërtetën që e dimë të gjithë. Megjithatë,

duke e parë se këto publikime po vazhdojnë misionin e tyre dhe kanë kaluar në një fushatë të orkestruar denigruese ndaj Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe familjes së tij, me pretendime të rreme se gjoja një i afërm i Myftiut është i përfshirë në çështje të fajdeve, duke e paraqitur Myftiun si “viktimë” dhe madje duke shprehur një lloj keqardhjeje të shtirur, ndihemi të detyruar që, për hir të së vërtetës dhe për sqarimin e opinionit të gjerë e të besimtarëve tanë, të dalim me këtë komunikatë.

Theksojmë qartë dhe prerazi se në asnjë mënyrë, në asnjë rrethanë dhe asnjëherë, as Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe as ndonjë anëtar i familjes së tij nuk kanë të bëjnë me pretendimet e ngritura ditëve të fundit nga qarqe dhe portale të ndryshme.

Jemi të vetëdijshëm se fushata të tilla kundër Myftiut Tërnavë i konvenojnë shumëkujt dhe shumë qarqeve, për shkak të punës dhe aktivitetit të tij të pandalshëm në të mirë të Bashkësisë

Islame të Kosovës, të komunitetit dhe të vendit.

Nuk habitemi kur segmente të caktuara të shoqërisë angazhohen për ta dëmtuar me shpifje, akuza dhe pretendime të pabazuara, të cilat synojnë të lëndojnë ndjenjat e besimtarëve tanë.

Megjithatë, si edhe më parë, fushata të tilla me qëllime dashakeqe dhe tendencioze ndaj familjes së Myftiut, ndaj vetë Myftiut dhe ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës, do të përfundojnë të turpëruara.

Prandaj, edhe një herë sqarojmë opinionin publik se nga fushata denigruese e ngritur ditëve të fundit nuk ka asgjë të vërtetë në pretendimet e publikuara në disa portale dhe emisione të ashtuquajtura “hulumtuese”.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

Prishtinë, më 25 tetor 2025

U MBAJT CIKLI I TRETË I TRAJNIMIT FETARO-SHKENCOR PËR IMAMË, HATIBË DHE MYEZINË



Më 27 dhe 28 tetor 2025, në Gjakovë u mbajt cikli i tretë i trajnimit fetar-shkencor për imamë, hatibë dhe myezinë të qytetit të Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të Bashkësisë Islame të Kosovës me Ministrinë për Çështje Islame të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Në hapjen e këtij sesioni, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, vlerësoi se trajnimet e tilla janë të rëndësishme për ngritjen dhe përgatitjen profesionale

dhe shpirtërore të imamëve, duke ndihmuar në forcimin e rolit të tyre edukativ dhe shoqëror.

Ndërsa përfaqësuesi i Ambasadës Saudite në Tiranë, z. Xhuluvi el Hexhleh, theksoi se organizimi i trajnimeve të tilla është dëshmi e marrëdhënieve të mira dhe të qëndrueshme ndërmjet institucioneve fetare të dy vendeve, duke shtuar se ato ndihmojnë në thellimin e mirëkuptimit ndërmjet imamëve dhe komunitetit.

Ligjërues në këtë cikël trajnimesh ishte këshilltari në Ministrinë për Çështje Islame të Arabisë Saudite, dr. Abdulmexhid bin Muhamed el Asakir, i cili në ditën e parë trajtoi tema mbi çështjet e besimit islam dhe forcimin e tij.

Në hapje të këtij trajnimi prezent ishte edhe përfaqësuesi i Zyrës së Atasheut për Çështje Fetare pranë Ambasadës Saudite në Sarajevë, z. Muhamed el Avad.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË TRYEZËN “ANGAZHIMI FETAR PËR TË LUFTUAR DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE”

Më 24 tetor 2025, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën “Angazhimi fetar për të luftuar dhunën ndaj grave dhe vajzave”, e cila u organizua nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Në këtë Tryezë morën pjesë përfaqësues të bashkësive të ndryshme fetare nga vendi, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët diskutuan për mënyrat dhe format e angazhimit të institucioneve fetare në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe për mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore.

Në fjalën e tij, kryeimami Sahiti theksoi angazhimin e vazhdueshëm të



Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të institucioneve të saj në parandalimin e këtij fenomeni shqetësues për shoqërinë kosovare. Ai nënvizoi rëndësinë e vetëdijesimit përmes ligjëratave, këshillimeve dhe predikimeve fetare që mbahen nga imamët, pedagogët dhe teologët e institucioneve arsimore të BIK-ut – si në Medrese, ashtu edhe në Fakultetin e Studimeve Islame.

Po ashtu, kryeimami Sahiti vlerësoi rolin e teologeve fetare të angazhuara pranë Departamentit të Gruas të Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilat përmes aktiviteteve të tyre kontribuojnë në fuqizimin e gruas, në mbrojtjen e dinjitetit të saj dhe në parandalimin e çdo forme dhune me bazë gjinore.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PUNIMET E FORUMIT BALLKANIK TË SHOQËRISË CIVILE DHE ORGANIZATAVE HUMANITARE BAMIRËSE



Më 25 dhe 26 tetor 2025, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në punimet e Forumit Ballkanik të Shoqërisë Civile dhe Organizatave Humanitare Bamirëse, i cili u mbajt në Stamboll të Turqisë.

Në kumtesën e tij, në seancën e parë të këtij Forumi, kryeimami Sahiti, nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitutional dhe theksoi se çelësi i suksesit qëndron në hartimin e një strategjie afatgjatë dhe në krijimin e një platforme të përbashkët, ku shoqëria civile dhe organizatat

humanitare, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare me orientim fetar, bashkëveprojnë në koordinim të plotë me institucionet fetare zyrtare të vendeve përkatëse. Ai shtoi se një vizion i qartë dhe përpjekjet e përbashkëta janë thelbësore për t'i shërbyer njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi, për një jetë dhe mirëqenie sa më të mirë.

Forumi Ballkanik ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së organizatave humanitare dhe të shoqërisë civile në vendet e Ballkanit, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre, si dhe ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme me organizata humanitare nga vende të ndryshme të botës. Po ashtu, Forumi synon avancimin e veprimtarisë në fushën e humanizmit dhe të shërbimeve sociale që kanë për qëllim mirëqenien e komunitetit.

U MBAJT AKTIVITETI “DASHURIA NDAJ VETES FILLON ME KUJDESIN PËR SHËNDETIN”

Më 16 tetor 2025, në kuadër të muajit sensibilizues për kancerin e gjirit, Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, organizoi aktivitetin vetëdijësues “Dashuria ndaj vetes fillon me kujdesin për shëndetin”

Udhëheqësja e Departamentit të Gruas, znj. Vaxhide Bunjaku, tha se përmes këtyre aktiviteteve synojnë të jenë pranë atyre grave që kanë nevojë si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo shpirtërore. “Të jemi të kujdesshme ndaj vetvetes, sepse e kemi përgjegjësi dhe amanet nga Zoti xh.sh.. Përmes këtij aktiviteti synojmë të jemi pranë atyre grave, të cilat kanë nevojë për mbështetje materiale, por jo vetëm kaq, t'u dalim në ndihmë edhe nga ana shpirtërore,” – tha ndër të tjera udhëheqësja Bunjaku.

Në këtë ngjarje Ganimete Bytyqi-radiologe, foli mbi rëndësinë e kontrolleve të rregullta, mënyrën e zbu-



limit të hershëm të kancerit të gjirit dhe kujdesin e vazhdueshëm shëndetësor.

Kurse dr. Florentina Tërmkolli, foli nga aspekti fetar për rëndësinë e shëndetit. Ajo tha se: “Islami i dha rëndësi të veçantë shëndetit. Përkushtimi i fesë për shëndetin është i madh, për shkak të lidhjes së tij fillimisht me objektivat e islamit dhe pastaj me praktikimin e këtyre objektiveve në jetë. Dijetarët e mëdhenj, pas objektivit të besimit, menjëherë e vendosën objektivin e

shëndetit, njeriun, jetën e tij dhe shëndetin e tij.”

Ndërkohë Gyltene Derguti-psikologe, trajtoi temën e rëndësisë së mbështetjes emocionale dhe ndihmës psikologjike për gratë që janë në proces të kurimit apo që e kanë kaluar këtë sfidë.

Gjatë këtij aktiviteti u organizua një aksion simbolik për grumbullimin e mjeteve financiare që iu dedikohen të prekurave me kancer të gjirit.

KALOI NË BOTËN E AMSHUESHME IMAMI VETERAN, MULLA JUSUF EFENDI ELEZAJ



Më 14 tetor 2025, kaloi në botën e amshueshme imami veteran mulla Jusuf efendi Elezaj.

Mulla Jusuf efendi Elezaj lindi më 10 prill 1951, në fshatin Staradran, komuna e Istogut. Familja e tij ka origjinë nga fshati Haxhaj i Rugovës, komuna e Pejës. Shkollimin fillor e përfundoi në vendlindje, në Staradran, ndërsa më pas, në vitin 1966,

vijoi studimet në Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, duke qenë pjesë e gjeneratës së gjashtë të saj. Pas përfundimit me sukses të Medresesë, u regjistrua në Universitetin “Al Az’har” në Kajro, Egjipt, në degën e Sheriatit Islam, ku përfundoi studimet me sukses dhe mori titullin myderriz (mësimdhënës i teologjisë islame). Pas kthimit në atdhe, më 18 maj 1985, Mulla Jusufi u emërua imam, hatib dhe mualim në Xhaminë “Hamam” në Pejë.

Më 1 shtator 1986, u transferua në të njëjtën detyrë në Xhaminë e Sofës në Gjakovë, ku shërbeu me përkushtim të madh. Pas fillimit të rindërtimit të kësaj xhamie, u sistemua përkohësisht në Xhaminë e Sefës, ndërsa më vonë shërbeu edhe në Xhaminë e Hadumit dhe Xhaminë e Kuqe në Pejë. Në periudhën 1987–1995, krahas detyrës së imamit, mbajti edhe postin e referentit për Arsim dhe Çështje Fetare në Këshillin e Bashkësisë Islame (KBI) të Gjakovës. Ai shquhej për korrektësi, urtësi dhe përkushtim institucional.

Mulla Jusufi ka ushtruar edhe funksione si:

- Arkëtar i Këshillit të Shoqatës së Ulemave në kuadër të KBI-së së Gjakovës,
- Kryetar i të njëjtës Shoqatë në nivel lokal,
- Delegat në Kuvendin e Shoqatës së Ulemave të Kosovës,
- Anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Ulemave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kontributi gjatë dhe pas luftës

Gjatë periudhës së luftës, Mulla Jusufi vazhdoi veprimtarinë e tij fetare dhe humanitare në Shqipëri. Pas përfundimit të luftës, u rikthye në Gjakovë duke vazhduar detyrën e imamit në Xhaminë “Mulla Jusufi” në lagjen me të njëjtin emër, deri në pensionimin e tij në vitin 2016.

Edhe pas pensionimit, për shkak të mungesës së kuadrove fetare, ai vazhdoi shërbimin në Xhaminë e Lipovecit deri në

vitin 2020, e më pas në Xhaminë e fshatit Mulliq, ku shërbeu deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Më 14 tetor 2025, mulla Jusuf efendi Elezaj ia dorëzoi shpirtin e tij fisnik Krijuesit të Gjithësisë. Varrimi i tij është bërë në varrezat e qytetit në Gjakovë. Në ceremoninë e varrimit morën pjesë përfaqësues nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësues nga Këshillat lokalë të Bashkësisë Islame, familjarë, xhematlinjë, si dhe qytetarë të Gjakovës e më gjerë. Namazin e xhenazes e udhëhoqi shoku i tij i studimeve në Al Az’har, hoxha i nderuar nga Prizreni, Reshat ef. Mexhidi.

“O ti shpirt i qetë! Kthehu te Zoti yt i kënaqur dhe i pranuar. Hyr në mesin e robërve të Mi! Dhe hyr në Xhenetin Tim!” (El Fexhr, 27–30)

E lusim Allahun xh.sh. që hoxhën e nderuar ta marrë në rahmetin e Tij dhe ta shpërblejë me Xhenetin Firdevs. Amin!

Esat Rexha



Lokja

I.

E mbështetur mbi minderin e heshtur,
me kërrabëza që vallëzojnë nëpër duart e lodhura,
ajo e ulur, me kokë përkulur, thur një xhemper për kujtim.
Herë pas here, një psherëtimë e thellë thyen qetësinë,
si një jehonë e dhimbjes së pashuar.

II.

Koha, me pendën e saj të pamëshirshme,
kishte gdhendur gjurmë të thella mbi trupin e saj të tretur.
Çdo rrudhë mbi fytyrën e stërplakur
është një kapitull i pashkruar historie,
dëshmi e ngjarjeve të dhembshme që nuk kanë nevojë për fjalë.

III.

Shikimi i saj mban në vete një mister të heshtur.
Sytë, të njomur nga lotët, por të mbushur me një dritë shprese,
vështrojnë fëmijët e fëmijëve të saj – pasardhësit e gjakut.
Ajo u rrëfen për heronjtë me fjalë të ngrohta,
ua përshkruan historinë, e ngjizur me krenari dhe mall.

IV.

Zemra e saj, si një lis i rrëzuar, vajton në heshtje,
e burgosur mes kujtimesh që nuk pushojnë së trokituri.
Brenda saj, një shpirt i lodhur gjëmon në pafajësi,
ndërkohë që edhe lulet e pranverës, në praninë e saj, sikur lotojnë.

V.

Në vetmi pëshpërit me zë të mbytur:
“Ku u tret lumturia që dikur më ndriti shpirtin?
Pse nuk arrij ta dalloj agimin e premtuar?
Pse nuk mund të derdhet dhembja e thellë që më gërryen
shpirtin?”
Zëri i saj humbet në eterin e pashpresë.


VI.

Por ajo nuk dorëzohet, dhimbjen e shndërron në këngë,
kërrabëzat kryqëzohen si shenjë e një durimi të pashtershëm.
“Po vjen behari,” thotë, “lulet çelin, lumenjtë ecin përpara –
e unë, në vetminë time, vetëm gjëmoj.
Por shpresa – shpresa më mban gjallë; te Zoti është fuqia ime.”

Naim Tërnav

Shkurt, 1999

Prishtinë



Botim i ri: “Hytbe të zgjedhura – 2” nga Isa ef. Tërshani

Pas vëllimit të parë, imami Isa ef. Tërshani sjell për lexuesin librin “Hytbe të zgjedhura – 2”, një përmbledhje me këshilla e ligjërata të frymëzuara nga burimet islame. Vepra trajton tema fetare, familjare e shoqërore me stil të qartë dhe frymë udhëzuese.



DITURIA ISLAME • Nr. 420 NËNTOR 2025